

VENDIM
Nr. 33, datë 29.1.2014

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT EKONOMIK E FISKAL TË SHQIPËRISË PËR
PERIUDHËN 2014 - 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit ekonomik e fiskal të Shqipërisë për periudhën 2014 - 2016, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PROGRAMI EKONOMIK DHE FISKAL 2014 – 2016
JANAR 2014

Hyrje

Që prej vitit 2006, vendet të cilat janë në proces negocimi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, si dhe vendet që kanë konkluduar këtë marrëveshje, por nuk kanë ende statusin e vendit kandidat, pritet që të dorëzojnë një Program Ekonomik dhe Fiskal (PEF) pranë Komisionit Evropian. Vendet potencialisht kandidatë duhet që në mënyrë progresive të zhvillojnë kapacitetet analitike të nevojshme për të marrë pjesë në procedurat multilaterale të mbikëqyrjes së Bashkimit Evropian.

Ky program ka si qëllim kryesor pikërisht përgatitjen e kapaciteteve institucionale dhe analitike të këtyre vendeve për pjesëmarrjen në procedurat e mbikëqyrjes ekonomike dhe monetare të Bashkimit Evropian. Ai shërben, gjithashtu, si një platformë dialogu dhe bashkëpunimi me BE-në në fushën ekonomike dhe fiskale.

Ky dokument paraqet një informacion të qartë të politikave ekonomike dhe prioriteteve afatmesme të vendit në kuadrin e reformave strukturore që parashikohen të zbatohen gjatë periudhës 2014 - 2016, të cilat kanë për qëllim stabilitetin makroekonomik dhe sigurimin e një rritje ekonomike relativisht të lartë e të qëndrueshme, si dhe ngritjen e një kuadri rregullator dhe politikave sektoriale në përputhje me standardet evropiane.

Dokumenti PEF 2014 - 2016 paraqet prioritetet kryesore të institucioneve të shtetit shqiptar në fushën e ekonomisë. Ai është i bazuar dhe në përputhje me ligjin nr. 185, datë 2.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014” dhe me Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2015 - 2017¹. Ky dokument është hartuar nga një grup ndërinstitucional pune me përfaqësues dhe ekspertë nga një sërë institucionesh të shtetit shqiptar.

Në kapitullin e parë paraqitet situata aktuale e zhvillimeve ekonomike, sektorit real e atij monetar. Në kapitullin e dytë paraqitet programi afatmesëm i ekonomisë, i ndarë në tri pjesë, duke trajtuar parashikimet në lidhje me sektorin real, në lidhje me nivelin e inflacionit, në lidhje me sektorin monetar dhe kursin e këmbimit dhe atë të sektorit të jashtëm. Në kapitullin e tretë paraqitet i detajuar kuadri afatmesëm mbi financat publike. Ky kapitull i kushton një vëmendje të veçantë parashikimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën afatmesme, si dhe një trajtim të strategjisë së borxhit publik. Kapitulli 4 paraqet reformat më të rëndësishme strukturore që do të ndërmarrë qeveria e Shqipërisë në fushën e konkurrencës, reformave për thithjen e investimeve të huaja, privatizimit. Gjithashtu, ky program përmban në fund të tij një aneks statistikor mbi një sërë treguesish makroekonomikë, duke mbuluar tri vitet e shkuara dhe tri vitet e ardhshme.

1. Kuadri i përgjithshëm i politikave dhe objektivat

¹ Miratuar nga Këshilli i Ministrave në datën 29.1.2014.

Programi Ekonomik e Fiskal 2013 bazohet në ligjin “Për buxhetin e vitit 2014”², Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2015 – 2017³ dhe në raportin e fundit të politikës monetare. Programi Ekonomik e Fiskal 2014 – 2016 u miratua nga Këshilli i Ministrave, më 29 janar 2014.

Objektivi kryesor i politikave ekonomike në kuadrin afatmesëm, është ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe vazhdimi i reformave strukturore, në mënyrë që të krijohen kushtet e nevojshme që ekonomia të veprojë në shtegun e rritjes potenciale.

Politika fiskale, për periudhën 2014 – 2016, do të jetë e orientuar në një trajektore të konsolidimi fiskal. Ajo synon më së pari vendosjen e financave publike në një trajektore të qëndrueshme, si një prej shtyllave kryesore të rritjes ekonomike dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Hartimi i politikës fiskale për periudhën afatmesme, në vijim është konsultuar ngushtësisht dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe me Bankën Botërore (BB). Ajo është, gjithashtu, në përputhje të plotë me gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian⁴.

Synimi madhor afatmesëm i politikës fiskale është rimëkëmbja e rritjes ekonomike të vendit në nivelet e saj potenciale dhe qëndrueshmëria e saj në kohë.

Objektivi kryesor i kornizës së politikës fiskale për periudhën afatmesme është niveli i deficitit strukturor, i cili siguron qëndrueshmërinë e borxhit publik në periudhën afatmesme dhe afatgjatë dhe minimizimin e efektet negative afatshkurtra mbi rritjen ekonomike. Objektivi kryesor operacional sasior i politikës fiskale në kuadrin makrofiskal aktual është ruajtja e deficitit të përgjithshëm fiskal, për çdo vit, përkatësisht si në vijim:

- deficitin i përgjithshëm fiskal prej 6.7% të PBB-së në vitin 2014;
- deficitin i përgjithshëm fiskal prej 4.8% të PBB-së në vitin 2015;
- deficitin i përgjithshëm fiskal prej 3.4% të PBB-së në vitin 2016.

Ky objektiv sasior i politikës fiskale do të korrigjohet në varësi të ciklit ekonomik. Pra, objektivi i deficitit fiskal do të zgjerohet nëse ekonomia performon më poshtë se sa parashikimi aktual dhe e kundërta.

Duhet të theksohet fakti se brenda këtyre niveleve të deficitit për tri vitet e ardhshme përfshihet pagesa e plotë e të gjitha borxheve të akumuluar të qeverisë ndaj sektorit privat, e cila është një përparësi dhe një nga komponentët kryesorë të politikës fiskale për periudhën afatmesme në vijim.

Investimet publike janë parashikuar të mbahen në një nivel prej të paktën 5 për qind të PBB-së, i cili është një nivel optimal për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Objektivi i politikës monetare është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Objektivi sasior i politikës monetare është arritja e një ndryshimi vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit prej 3%, me një interval tolerance prej +/- 1pp, në periudhën afatmesme.

Politika monetare do të vazhdojë të zbatohet nën një regjim fleksibël të kursit të këmbimit, ku vlera e monedhës vendase (lek) kundrejt monedhave të huaja do të përcaktohet lirisht nga oferta dhe kërkesa e tyre në tregun e këmbimit ndërkombëtar.

Hartimi i politikës monetare dhe asaj fiskale është kryer në harmonizim të plotë me njëra-tjetrën, në synim të një efektiviteti maksimal të tyre në lidhje me arritjen e objektivave respektive.

Zbatimi i reformave kyçe strukturore do të jetë, gjithashtu, një levë kryesore për shfrytëzimin e potencialeve të ekonomisë së vendit. Në këtë drejtim, do të synohet përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ të funksionimit të biznesit dhe të klimës së përgjithshme të biznesit, rritja e konkurrencës së prodhimeve dhe shërbimeve vendase, përmirësimi i mëtejshëm i sektorit financiar, ulja e ekonomisë informale, reformimi i administratës publike, si dhe reformimi në sistemin e pensioneve dhe vijueshmëria e reformave në tregun e punës.

2. Perspektiva ekonomike

2.1 Zhvillimet e fundit ekonomike

Kriza globale ushtroi presion të dukshëm mbi ekonominë shqiptare. Si pasojë e krizës globale,

² Ligji “Për buxhetin e vitit 2013” u miratua nga Parlamenti, më 2.12.2013, nr. ref. 185.

³ Programi Ekonomik e Fiskal 2014 - 2016 u miratua nga Këshilli i Ministrave më 29 janar 2014.

⁴ Progres Raporti për Shqipërinë 2013.

normat e rritjes u ulën ndjeshëm. Rritja reale në vitin 2009, u përgjysmua nga trendi i saj historik, por megjithatë vijoi të ishte pozitive (3.3 për qind e PBB-së), si rezultat i ekspozimit të kufizuar financiar në tregjet ndërkombëtare dhe të një politike fiskale ekspansioniste të iniciuar para krizës. Me lidhje veçanërisht të forta ekonomike e tregtare me Italinë dhe Greqinë, kriza në këto vende u reflektua në uljen e remitancave dhe eksporteve në ekonominë shqiptare, të cilat çuan në një ngadalësim të konsiderueshëm të rritjes ekonomike dhe veçanërisht të të ardhurave buxhetore.

Ekonomia ka vazhduar me një normë të moderuar rritjeje prej 3.8 për qind në vitin 2010 dhe 3.1 në vitin 2011. Në vitin 2012 dhe përgjatë vitit 2013, rritja ekonomike është dobësuar edhe më tej. Norma e rritjes ekonomike u ul në 1.3% më 2012-ën dhe vijoi të ulej ndjeshëm gjatë 2013-ës. Gjatë nëntë muajve të vitit 2013 rritja ekonomike e vlerësuar prej INSTAT-it rezultoi në 0.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kërkesa e brendshme vijon të mbetet mjaft e dobët dhe gjasat për një përsheptim të menjëhershëm të konsumit dhe investimeve private mbeten të pakta. Kërkesa e jashtme ka qenë gjeneratori kryesor i rritjes në dy vitet e fundit, megjithatë, ajo mbetet e kushtëzuar nga zhvillimet e pafavorshme në ekonominë e Eurozonës dhe të një baze jo të diversifikuar eksportuesish, si për sa u takon produkteve, ashtu edhe tregjeve.

Sektori real

Aktiviteti ekonomik u zgjerua edhe përgjatë vitit 2013, por ritmi i rritjes vijoi të ngadalësohet më tej. Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2013, rritja ekonomike kumulative, e vlerësuar paraprakisht nga INSTAT-i, rezultoi 0.4 për qind, një ulje e ndjeshme edhe kundrejt rritjes prej 1.3 për qind të vitit 2012. Ndonëse është thelbësisht pozitive që ekonomia vijon të qëndrojë në terren pozitiv, në të njëjtën kohë, ky ritëm i rritjes është më i ulët i qarkulluar prej vitit 1997.

E gjithë kjo rritje vlerësohet të jetë gjeneruar thuajse tërësisht prej kërkesës së huaj, kryesisht rrjedhojë e rritjes së eksporteve të mallrave me rreth 16 për qind dhe rënies së importeve me rreth 6 për qind. Ndërkohë që kërkesa e brendshme, me gjithë stimulim fiskal të injektuar gjatë gjysmës së parë të vitit (veçanërisht në tremujorin e dytë), vazhdon të mbetet mjaft e dobët. Investimet private vlerësohet të jenë komponenti më i dobët i kërkesës së brendshme (vlerësohet të kenë pasur një kontribut negativ në rritjen ekonomike), por edhe konsumi privat mbetet mjaft i vakët.

Shpërndarja e rritjes ekonomike gjatë nëntë muajve të vitit 2013 paraqitet e ndryshme për sektorët kryesorë të ekonomisë. Sektorët që vlerësohet të kenë shënuar rritje gjatë kësaj periudhe janë ndërtimi, i cili në tremujorin e dytë udhëhoqi rritjen ekonomike, bujqësia dhe industria.

Sektori prodhues (industria, bujqësia dhe ndërtimi) pati rolin kryesor në rritjen ekonomike në gjysmën e parë të këtij viti, në dallim nga zhvillimet e shfaqura në vitin 2012, ku rritja e PBB-së u drejtua kryesisht nga dinamika e sektorit të shërbimeve. Sektori prodhues rezulton të ketë kontribuar me 1 pikë përqindje në zgjerimin vjetor të PBB-së, gjatë nëntë muajve të vitit 2013. Ky kontribut reflektoi kryesisht rigjallërimin e përkohshëm të aktivitetit ndërtues gjatë tremujorit të dytë, i cili u ushqye kryesisht nga stimuli fiskal i injektuar në këtë tremujor. Kontributin më të lartë brenda sektorit prodhues, por edhe prej të gjithë sektorëve të tjerë të aktivitetit ekonomik, e pati bujqësia, e cila gjatë nëntë muajve të parë të vitit u rrit me 2.9 për qind në terma vjetorë, duke kontribuar me 0.7 pikë përqindje në rritjen e përgjithshme gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, në një masë të ulët pozitivisht kontribuoi edhe rritja në prodhimin industrial me rreth 0.3 pikë përqindje.

Tabelë: PBB-ja sipas aktiviteteve prodhuese


Rritja e PBB sipas aktiviteteve prodhuese për nëntë muajtë e parë të vitit 2013

	Rritja (në % 9M'13/9M'12)	Kontributi (në pikë % 9M'13/9M'12)
Bujqësia, blektori, gjuetia dhe pyje ¹	2.9	0.7
Industria	2.6	0.3
Ind. nxjerrëse	18.0	0.4
Ind. përpunuese	-0.9	-0.1
Ndërtimi	0.5	0.1
Shërbimet	-0.8	-0.5
Tregti, Hotele dhe Restorante	-2.2	-0.5
Transporti	-4.1	-0.2
Posta dhe komunikacioni	0.8	0.0
Shërbime të tjera	0.6	0.2
PBB totale	0.4	0.4

Burimi: INSTAT

Në të kundërt, rënia vjetore e vlerës së shtuar të regjistruar nga sektori i shërbimeve u përkthye në një kontribut negativ prej 0.5 pikë përqindjeje në rritjen ekonomike të nëntë muajve të vitit 2013. Tregtia, shërbimet e hotelerisë dhe restorantet, si dhe shërbimet e transportit ishin ato shërbime të cilat rezultuan me rënie gjatë nëntë muajve të vitit, me përkatësisht 2.2 dhe 4.1 për qind në terma vjetorë. Ndërkohë, shërbimet e telekomunikacionit shënuan një rritje marginale të vlerës së shtuar me rreth 0.8 për qind krahasuar me nëntë muajt e vitit 2012 dhe shërbimet e tjera një rritje prej 0.6 për qind.

Grafik: Ecuria tremujore e PBB-së



Burimi: INSTAT

Nga pikëpamja e shpenzimeve, duke u bazuar në indikatorët e disponueshëm indirektë, vlerësohet se gjatë tremujorit të parë të 2013-ës, rritja u mbështet thajse tërësisht nga kërkesa e huaj. Në tremujorin e dytë dhe të tretë, kontributi i kërkesës së huaj ishte disi më i zbehtë në krahasim me të parin. Ndërkohë, kërkesa e brendshme private vlerësohet të ketë dhënë një kontribut negativ në rritjen ekonomike gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2013, si nëpërmjet konsumit, ashtu edhe investimeve private. Kontributi i vlerësuar negativ i kërkesës së brendshme private u kompensua pjesërisht prej komponentit publik të kërkesës agregate të brendshme, veçanërisht, përgjatë tremujorit të dytë. Në tërësi, bazuar në treguesit indirektë të disponueshëm, kërkesa e brendshme (private dhe publike) vlerësohet të ketë pasur një kontribut thajse të papërfillshëm në rritjen ekonomike të nëntë muajve të vitit.

Vlerësojmë se kërkesa e brendshme private dhe, veçanërisht, investimet private, kanë mbetur të dobëta edhe përgjatë tremujorit të fundit të vitit 2013. Ecuria negative e kërkesës së brendshme private reflekton më së tepërmi pasigurinë e lartë që vijon të rrethojë vendimmarrjet e agjentëve ekonomikë, e cila duket se arriti kulmin me afrimin e zgjedhjeve parlamentare, siç pasqyrohet edhe nga indekset e besimit të konsumatorëve dhe bizneseve, të cilët pësuan një rënie gjatë T2-2013 kundrejt një tremujori më parë.

Ecuria negative e kërkesës private të brendshme reflekton, gjithashtu, vijueshmërinë e kushteve të


shtrënguara të financimit me të cilat përballen agentët privatë. Përveç kushteve të tjera, relativisht të shtrënguara prej kohësh nga sistemi bankar për dhënien e kredive drejt agentëve privatë, edhe norma e interesit të kredive, faktori kryesor që përcakton kërkesën për huamarrje, ka mbetur në nivele të larta, me gjithë politikën monetare lehtësuese të ndjekur prej autoritetit monetar me uljen e vijueshme të normës bazë së interesit.

Tregu i punës

Vijueshmëria e gjenerimit të një rritjeje pozitive ekonomike, edhe pse tashmë në ritmet më të ulëta historike, duket se ka shmangur një pjesë të transmetimit të efekteve të forta negative në tregun e punës, e veçanërisht sa i takon punësimin. Referuar statistikave zyrtare të disponueshme duket se presionet negative janë transmetuar më shumë në nivelin e pagave se sa në gjendjen e punësimit në tërësi, pasi niveli i përgjithshëm i pagave reale në ekonomi ka vijuar të ulet disi edhe përgjatë 2013-ës, ndërsa punësimi ka vijuar të ketë rritje të lehtë.

Gjatë tremujorit të parë, të dytë dhe të tretë të vitit 2013, punësimi u rrit respektivisht me 0.3, 0.1 dhe 0.7 për qind, krahasuar me tremujorin e kaluar dhe 1.3, 1.5 dhe 0.6 për qind në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Mesatarisht, rritja e punësimit gjatë nëntë muajve të vitit 2013 ka qenë rreth 1.1 për qind në terma vjetorë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së punësimit në sektorin privat jobujqësor, që u rrit respektivisht me 7.2, 7.7 dhe 5.8 për qind në çdo tremujor në terma vjetorë, ndërsa punësimi në sektorin publik vazhdoi të tkurret me një mesatare vjetore prej 0.4 për qind. Në sektorin e bujqësisë, të dhënat mbi punësimin kanë mbetur të pandryshuara. Norma e papunësisë në tremujorin e tretë të vitit 2013 vijoi të ishte në nivelin 12.8 për qind.

Grafik: Tregues të tregut të punës



Burimi: INSTAT

Sektori monetar e financiar

Mjedisi i përgjithshëm ekonomik dhe financiar ka përcjellë presione të dobëta inflacioniste gjatë dy viteve të fundit. Kërkesa agregate e dobët ka udhëhequr rritjen e ngadalhtë dhe nën potencial të ekonomisë. Hendeku negativ ka penguar rritjen e kostove të punës për njësi dhe ka krijuar një mjedis me presione të ulëta inflacioniste. Këtë e dëshmojnë shifrat e ulëta të inflacionit bazë dhe pritjet inflacioniste në rënie, por të mirankoruara. Nga ana tjetër, inflacioni i importuar është ngadalësuar, duke reflektuar si prirjen rënëse të inflacionit në partnerët tanë tregtarë, ashtu dhe një kurs këmbimi të qëndrueshëm.

Inflacioni vjetor mesatar rezultoi 2% në vitin 2012, duke qëndruar brenda kufijve të tolerancës rreth objektivit të Bankës së Shqipërisë. Inflacioni i çmimeve të konsumit ndoqi një prirje rënëse më 2013-ën, veçanërisht gjatë tremujorit të tretë e të katërt. Norma vjetore e inflacionit ishte 2.5% dhe 2.2% përkatësisht gjatë tremujorit të parë dhe të dytë. Inflacioni vjetor ra në 1.5% në tremujorin e tretë dhe u reduktua më tej në 1% në muajin nëntor. Profili i tij gjatë vitit 2013 u përcaktua më së shumti nga luhatjet e çmimeve të ushqimeve.

Përtej efekteve sezonale, reduktimi i çmimeve të ushqimeve reflektoi si çmimet më të ulëta të importit për mallrat ushqimore të përpunuara dhe të papërpunuara, ashtu dhe rritjen e prodhimit të

brendshëm bujqësor, i cili hyn në treg me çmime më të ulëta sesa ato të importuara. Inflacionet e çmimeve të mallrave të tjera të konsumit dhanë një kontribut të ulët në inflacionin total, duke kompensuar njëra-tjetrën. Veçanërisht, rënia e inflacionit të qirasë dhe të çmimit të karburanteve ka sjellë reduktimin e kontributit të inflacionit pa mallrat ushqimore, në inflacionin total.

Grafik: Kontributi i inflacionit të kategorisë së mallrave ushqimore në inflacionin total



Burimi: INSTAT-i dhe Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, këto zhvillime ishin në linjë me pritshmëritë e Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, madhësia e reduktimit të inflacionit ishte më e konsiderueshme nga sa pritej për shkak të rritjes më të ulët ekonomike dhe të frenimit më të madh të inflacionit të importuar. Zhvillimet e dobëta të deritanishme dhe të pritura në inflacion, nxitën Bankën e Shqipërisë të reduktojë normën bazë të interesit përgjatë 2013-ës. Nga ana tjetër, pritjet inflacioniste mbetën të ankoruara dhe në linjë me stabilitetin e çmimeve.



Për periudhën e ardhshme, Banka e Shqipërisë vlerëson se kjo tablo ekonomike do të mbetet thuajse e pandryshuar. Vijimi i hendekut negativ dhe ekspansioni i ngadaltë monetar do ta mbajnë inflacionin në nivele të ulëta në periudhën e ardhshme.

Ritmet e zgjerimit monetar rezultuan të moderuara gjatë vitit 2013, në linjë me zhvillimet në ekonominë reale, kundërshtinë e lartë të bankave ndaj rrezikut dhe ndërmjetësimin e ulët financiar. Agregati i parasë së gjerë, M3, shënoi një normë vjetore mesatare rritjeje prej 4% në terma vjetorë, me një tendencë ngadalësuese në gjysmën e dytë të vitit. Në muajin tetor, M3 shënoi një rritje me 2.3%. Zgjerimi i parasë së gjerë është mbështetur kryesisht nga përbërësi valutor dhe nevoja e qeverisë për financim, secili me një kontribut prej 1.9 pikë përqindjeje në rritjen e M3 në muajin tetor. Tkurrja e portofolit të kredisë ka ndikuar në reduktimin me 1.1 pikë përqindjeje në zgjerimin monetar. Nga ana tjetër, financimi i brendshëm nga bankat i deficitit buxhetor, si dhe ecuria më e mirë e kredisë në monedhë vendase kanë mbështetur rritjen e qëndrueshme të M2, mesatarisht prej 6% vit mbi vit.

Ecuria e depozitave tregon për një ngadalësim të ritmit të rritjes vjetore. Stoku total i depozitave në fund të muajit tetor rezulton rreth 1.7% më i lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ngadalësimi i ritmeve të rritjes ka reflektuar kryesisht rënien e depozitave në monedhë të huaj, stoku total i të cilave është reduktuar me 3.3%. Pavarësisht politikës monetare lehtësuese dhe përçimit të saj te normat e interesit të depozitave, stoku total i depozitave në lekë është zgjeruar me 6.6% në terma vjetorë.

Zhvillimet monetare janë kushtëzuar në një masë të konsiderueshme nga ngadalësimi gradual i normave të rritjes së kredisë. Në fund të muajit tetor, stoku total i kredisë për ekonominë rezulton rreth 2.2% më i ulët se një vit më parë, ndërsa raporti i kredisë ndaj PBB-së ka pësuar rënie në 40.2%. Portofoli i kredisë për individë, sikurse dhe ai për biznese kanë shënuar rënie në terma vjetorë, përkatësisht me 0.2% dhe 3.8%. Kredia për individë ka performuar më mirë, duke shënuar norma pozitive rritjeje gjatë gjithë periudhës.

Grafik: Ecuria e kreditimit dhe e depozitave



Burimi: Banka e Shqipërisë

Rënia e stokut të kredisë reflekton më së shumti kërkesën e ulët të sektorit privat për financim, si rrjedhojë e dobësimit të aktivitetit ekonomik dhe pasigurive për zhvillimet e ardhshme. Gjithashtu, ecuria e dobët e kredisë reflekton pjesërisht edhe probleme të ofertës, sikurse tregojnë vrojtimet e aktivitetit kreditues dhe kushtet e kreditimit të zbatuara nga bankat. Përqasja tejet kundërshtuese ndaj rrezikut në aktivitetin kreditues është në njëfarë mase, gjithashtu, përgjegjëse për ngadalësimin e kreditimit. Së fundi, zhvillimet në kreditim gjatë këtij viti kanë reflektuar edhe pastrimin e bilanceve të bankave nga kreditë me probleme.

Monedha vendase ka qenë përgjithësisht e qëndrueshme gjatë vitit 2013. Nga janari në nëntor, leku u nënçmua mesatarisht me 0.15% në terma nominalë efektivë. Dinamika e kursit nominal efektiv (NEER) ka reflektuar nënçmimin e lekut kundrejt monedhës euro, të balancuar nga një vlerësim i ndjeshëm i lekut kundrejt dollarit amerikan. Në terma realë, monedha vendase ka qenë, gjithashtu, e qëndrueshme, duke mbetur në nivele të njëjta, si edhe në vitin e kaluar. Gjatë vitit 2013, kurset mesatare të këmbimit kundrejt euros dhe dollarit amerikan ishin përkatësisht 140.3 lekë/euro dhe 106 lekë/dollarë amerikanë. Gjatë periudhës janar – nëntor të këtij viti, leku shfaqti mbiçmim të ndjeshëm kundrejt dollarit amerikan (2.2%) dhe nënçmim të lehtë kundrejt euros (0.93%) krahasuar me një vit më parë. Importet më të pakta gjatë kësaj periudhe, si dhe rritja e vazhdueshme e eksporteve duket të kenë kontribuar në qëndrueshmërinë e lekut kundrejt monedhës evropiane.

Sektori i jashtëm

Korrektimi i deficitit të llogarisë korrente vijoi edhe gjatë vitit 2013, ndonëse me ritme më të moderuara. Hyrjet në llogarinë kapitale e financiare ishin gjerësisht të mjaftueshme për të mbuluar këtë deficit, si pasojë e nivelit të lartë të IHD-ve. Pozicioni neto i llogarisë korrente gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2013 ishte në një deficit prej 713.1 milionë eurosh ose rreth 9.8% në terma të PBB-së nominalë, duke u zvogëluar disi prej nivelit 10.8% të regjistruar gjatë vitit 2012. Ngushtimi i bilancit tregtar ka qenë përcaktuesi kryesor i zhvillimeve në llogarinë korrente gjatë vitit 2012 dhe nëntë muajve të parë të vitit 2013.

Më 2013-ën, tkurrja e deficitit të të ardhurave neto, kryesisht përmes daljeve më të ulëta të të ardhurave nga IHD-të, ka kontribuar pozitivisht në ngushtimin e deficitit të llogarisë korrente. Në anën tjetër, bilanci i llogarisë së shërbimeve është ndikuar në një masë të madhe nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, duke dhënë efekt në tremujorin e tretë të vitit. Kjo besohet të ketë rritur pasigurinë dhe të ketë ndikuar direkt flukset hyrëse në llogarinë e shërbimeve. Për shkak të një rënieje progresive të regjistruar në flukset hyrëse të remitançave, bilanci i transfertave është kontraktuar dhe ka kontribuar negativisht në bilancin e përgjithshëm të llogarisë korrente. Ndonëse përmirësimi i deficitit tregtar rezultoi më i përshpejtuar, vlerësimet më të fundit projektojnë një nivel më të lartë të deficitit të llogarisë korrente krahasuar me pritjet e mëparshme, si pasojë e rishikimit të suficitit të transfertave korrente.

Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare rezultuan në rreth 626.6 milionë euro gjatë nëntë muajve të vitit 2013, përkundrajt 867.3 milionë euro në vitin 2012. Në raport ndaj PBB-së, ato u vlerësuan rreth 8.6% gjatë tre tremujorëve të parë të 2013-ës, krahasuar me rreth 9.2% në vitin 2012. Në vitin 2013, llogaria kapitale shënoi një suficit më të ulët në terma vjetorë. Në anën tjetër, suficit i

llogarisë financiare u rrit me rreth 8.1% në terma vjetorë.

Të ardhurat nga privatizimi, sidomos gjatë tremujorit të dytë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rrjedhën e IHD-ve gjatë vitit 2013. Investimet e huaja neto ishin rreth 690.7 milionë euro, në rritje prej 25.5% në terma vjetorë. Sidoqoftë, nëse përjashtohen arkëtimet nga privatizimet, norma e rritjes së IHD-ve është më shumë se përgjysmuar – në rreth 11.7% në terma vjetorë. Investimet neto të portofolit tregojnë një bilanc negativ, kryesisht nga rritja me rreth 145.9 milionë euro e mjeteve tona të investuara jashtë vendit. Bilanci i investimeve të tjera ka shënuar një vlerë negative prej 13.0 milionë eurosh në terma neto, duke reflektuar rritjen e konsiderueshme të mjeteve të investuara jashtë vendit.

2.2 Skenari makroekonomik afatmesëm

Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e të reformave ekonomiko-strukturore qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili duket si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si: Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Eurostat, Banka Qendrore Evropiane etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, testimit, analizat krahasuese, statike, dinamike, e pasi kryhen një serë testesh konsistence, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme e maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Skenari bazë makroekonomik është ngritur në një konsultim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Sektori real

Gjatë vitit 2013, zhvillimet makroekonomike janë karakterizuar nga një rritje shumë e dobët, inflacion i ulët, me baza relativisht të shëndosha financiare, me një përmirësim në llogarinë korrente dhe me një bilanc pozitiv të pagesave, përkeqësim të pozicionit fiskal dhe me pasiguri të larta të perceptuara prej agjentëve ekonomikë. Kërkesa e brendshme ka vazhduar të jetë nën presion në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i pasigurive për të ardhmen, pozitave të të ardhurave familjare, kushteve relativisht të shtrënguara të kreditimit. Komponenti publik i kërkesës së brendshme agregate ka ndihmuar të balancojë konsumin dhe investimet private që ishin disi të ulëta. Njësoj si në vitin 2012, kërkesa e huaj ka vijuar të gjenerojë pothuajse të gjithë rritjen në vitin 2013. E gjithë kjo rezultoi, që viti 2013 të shënojë nivelin më të ulët të rritjes ekonomike gjatë pesë viteve të fundit nën presionin e krizës globale. Rritja pritet në 0.7% për vitin 2013.

Në të ardhmen, rritja pritet të përshpejtohet disi në vitin 2014, sidomos në pjesën e dytë të vitit. Pasiguritë në lidhje me zgjedhjet elektorale të vitit 2013 priten të veniten, si dhe priten hyrje të kapitalit të huaj nga institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat do të kanalizohen kryesisht në pagesat e borxheve të qeverisë ndaj sektorit privat. Gjithashtu, edhe një përmirësim i mundshëm në ekonominë e Eurozonës rrisin gjasat për një rritje më të lartë në vitin 2014 prej 2.1%.

Hendeku i prodhimit pritet që gradualisht të fillojë të mbyllet duke nisur që nga viti 2015 dhe duke vazhduar në vitet e ardhshme. Rritja pritet të ketë një bazë më të gjerë, pasi pritet që besimi i agjentëve ekonomikë të vijë duke u përmirësuar në përputhje me rimëkëmbjen e aktivitetit ekonomik global dhe, veçanërisht, të Italisë dhe të Greqisë. Familjet dhe bizneset do të fillojnë të përfitojnë nga kushtet monetare stimuluese.

Bilanci i jashtëm i ekonomisë mund të vazhdojë të përmirësohet në vitet e ardhshme. Kjo së bashku me konsolidimin e pozicionit fiskal do të mbështesë forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe kredibilitetit të perceptuar nga agjentët e tjerë të ekonomisë. Kjo do të çojë në prime të ulëta të rrezikut për ekonominë dhe do të kontribuojë në nxitjen e ndërmjetësimit financiar dhe në një hyrje më të qëndrueshme të flukseve të kapitalit të huaj. Gjithashtu, korrigjimi i vijueshëm i disbalancave në sektorin

e jashtëm do të çojë në një përmirësimin të raportit të hendekut ndërmjet kursimeve dhe investimeve në vend.

Pavarësisht pritshmërive për një përsheptim të ritmeve të rritjes dhe ngushtim të hendekut të prodhimit, ekonomia është parashikuar të vazhdojë të operojë nën potencial, si në periudhën afatshkurtër edhe në atë afatmesme, duke lënë të kuptohet për presione të ulëta inflacioniste nga ana e kërkesës.

PBB: Kërkesa agregate

Konsumi final parashikohet të rritet në terma realë me një normë mesatare vjetore prej 1.5% gjatë periudhës afatmesme në vijim (2014 - 2016). Në mënyrë të veçantë, rritja reale e konsumit parashikohet në 0.2% në vitin 2014, duke kontribuar me 0.2 pikë përqindje në rritjen ekonomike për këtë vit. Gjatë vitit 2015 rritja e konsumit parashikohet të përshejtohet në 1.5%, duke kontribuar me rreth 1.3 pp në rritjen reale ekonomike të përgjithshme dhe të rritet me 2.7% në vitin 2016, duke kontribuar me 2.3 pikë përqindje.

Investimet (formimi bruto i kapitalit fiks) gjatë 2014 - 2016 parashikohet të përjetojnë një rritje vjetore mesatare reale prej 1.5%. Në vitin 2014 investimet parashikohet të tkurren me -0.4% në terma realë, duke kontribuar me -0.1 pp në rritjen e PBB-së. Tkurrja është rrjedhojë e nivelit më të ulët të investimeve publike krahasuar me vitin 2013 prej rreth 9.9% më pak, ndërsa investimet private parashikohen të rriten me rreth 2.3% në terma realë. Në vitin 2015 investimet totale parashikohet të rritet me 4.3% duke kontribuar me 1.2 pp. Në vitin 2016 investimet janë parashikuar të rriten me 5.8% me një kontribut prej 1.0 pikë përqindjeje në rritjen reale ekonomike.

Eksporti neto i mallrave dhe i shërbimeve parashikohet të vazhdojë përmirësimin e bilancit të tij neto gjatë periudhës afatmesme. Është parashikuar që për vitin 2014 deficiti i mallrave dhe i shërbimeve të përmirësohet me 12.2% në terma realë, duke kontribuar me 2.0 pikë përqindje në rritjen e PBB-së së parashikuar prej 2.1% për vitin 2014. Përmirësimi i balancës parashikohet të vijojë edhe në vitin 2015 me rreth 5.8% dhe me 2.0% në vitin 2016, duke kontribuar përkatësisht me 0.8 pikë përqindje dhe 0.3 p.p. në rritjen ekonomike për këto dy vite. Përmirësimi i eksporteve neto parashikohet të vijë nga një rritje e qëndrueshme e eksporteve të mallrave dhe të shërbimeve, por edhe nga ulja e importeve të mallrave dhe zëvendësimi i tyre me ato të prodhuara në vend.

Ndryshimet në inventar janë supozuar me një kontribut neutral (zero pp) në kërkesën agregate dhe rritjen reale të PBB-së.

PBB: Oferta agregate

Sipas optikës së ofertës agregate, ecuria e pritshme sipas aktiviteteve ekonomike kryesore paraqitet si vijon.

Prodhimi bujqësor, duke supozuar kushte normale klimaterike, është projektuar të rritet çdo vit me mesatarisht rreth 4.4% për periudhën e ardhshme 2014 - 2016, me një kontribut mesatar në rritjen e PBB-së me rreth 0.9 pp në vit.

Prodhimi industrial, duke përfshirë industrinë nxjerrëse dhe atë të prodhimit, parashikohet të rritet mesatarisht me 6.1% në vit për periudhën afatmesme 2014 - 2016, duke kontribuar mesatarisht me 0.7 pikë përqindje në vit në rritjen e parashikuar të PBB-së për çdo vit.

Ndërtimi, për vitin 2014 parashikohet të vijojë me një rënie, ndonëse më e moderuar se vitet e shkuara, ndërsa parashikohet të kthehet në norma pozitive të rritjes për vitet 2015 dhe 2016. Mesatarisht, ndërtimi parashikohet të rritet në terma realë me 1.5% gjatë vitit 2014 - 2016, duke kontribuar pozitivisht në rritjen e përgjithshme të aktivitetit ekonomik me një mesatare prej 0.1 pp në vit.

Shërbimet janë parashikuar të rriten mesatarisht me 2.7% në vit gjatë periudhës afatmesme 2014 - 2016, duke kontribuar mesatarisht me 1.4 pp në vit në rritjen e përgjithshme ekonomike. Kontributi kryesor pritet të vijë nga shërbimet e tjera: tregti, hotele dhe restorante, gjithashtu, priten të kenë një kontribut në rritje gjatë gjithë horizontit kohor të ardhshëm.

Bazuar në parashikimet e mësipërme të kërkesës dhe ofertës agregate, skenari bazë i paraqitur parashikon një rritje reale të PBB-së prej 2.1% në vitin 2014, 3.3% në vitin 2015 dhe 4.2% në vitin 2016. Në tabelën e mëposhtme paraqiten parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë për periudhën 2014 - 2016.

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
							Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8
Inflacioni (mesatar)	%	3.4	2.3	3.6	3.5	2.0	1.9	2.7	2.8	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	4.7	2.0	2.6	1.8	2.1	1.7	2.3	2.5	2.7	2.8
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	83.9	95.0	103.9	100.9	108.2	106.0	106.0	106.0	106.0	106.0
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	122.8	131.6	137.7	140.5	139.0	140.3	140.0	140.0	140.0	140.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	41.8	41.7	44.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5
Rritja reale e PBB	%	7.5	3.3	3.8	3.1	1.3	0.7	2.1	3.3	4.2	4.5
PBB	Lek miliardë	1,089.3	1,148.1	1,222.5	1,282.3	1,326.0	1,358.0	1,418.0	1,502.0	1,607.0	1,726.0
PBB	USD miliardë	13.0	12.1	11.8	12.7	12.3	12.8	13.4	14.2	15.2	16.3
PBB	Euro miliardë	8.9	8.7	8.9	9.1	9.5	9.7	10.1	10.7	11.5	12.3
PBB për banor	Lek mijë	372.2	396.1	425.9	451.0	470.9	487.2	508.7	538.8	576.5	619.2
PBB për banor	USD	4,436.2	4,170.3	4,097.8	4,470.0	4,353.0	4,596.5	4,798.9	5,083.1	5,438.5	5,841.2
PBB për banor	Euro	3,031.5	3,010.3	3,092.9	3,209.8	3,388.4	3,473.0	3,633.4	3,848.7	4,117.7	4,422.6
PBB për banor	USD-PPP	8,900.7	9,488.4	9,578.6	9,922.3	10,359.9	10,716.9	11,190.5	11,853.4	12,682.0	13,621.1
Norma e papunësisë (vitet 2012/13 sipas Anketës së Forcave të Punës-INSTAT)	%	...	...	...	...	14.4	16.9	16.2	15.5	14.3	12.1
Të ardhurat totale	% të PBB	26.7	26.0	26.6	25.8	24.9	24.0	25.7	26.0	26.5	27.1
Shpenzimet totale	% të PBB	32.3	33.1	29.7	29.3	28.4	30.1	32.2	30.8	29.9	28.4
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-5.5	-7.0	-3.1	-3.6	-3.5	-6.1	-6.5	-4.8	-3.4	-1.3
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-2.7	-3.9	0.3	-0.4	-0.3	-2.9	-3.2	-1.3	0.2	2.3
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	3.1	1.3	2.4	1.9	1.2	-0.5	-1.7	0.3	1.6	3.7
Huamarrje totale neto	% të PBB	4.9	4.6	3.1	3.9	3.2	5.5	6.4	4.8	3.4	1.3
Borxhi Publik Total	% të PBB	54.7	59.5	58.5	60.3	62.5	70.5	72.1	71.7	69.2	65.6
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	51.3	55.5	54.8	56.5	58.4	61.3	65.1	66.3	65.4	62.2
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	3.4	4.0	3.7	3.8	4.1	9.2	7.0	5.4	3.8	3.4
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-15.6	-15.2	-11.5	-13.0	-10.7	-10.0	-8.3	-7.6	-7.3	-8.1
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-26.6	-24.4	-20.8	-23.1	-18.9	-16.5	-14.1	-12.7	-11.8	-12.1
Mallra	% të PBB	-27.4	-26.4	-23.5	-24.6	-21.0	-17.0	-16.8	-15.2	-14.6	-15.4
Eksporte	% të PBB	10.3	8.6	13.2	15.4	16.0	17.8	19.1	20.4	21.9	23.5
Importe	% të PBB	-37.7	-35.0	-36.7	-40.0	-36.9	-34.8	-35.9	-35.6	-36.5	-38.9
Bilanci i pagesave	% të PBB	2.1	-0.3	2.0	-0.3	0.8	0.6	2.2	2.5	2.9	3.0

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, FMN, BB

Politika monetare dhe e kursit të këmbimit dhe inflacioni

Politika monetare dhe e kursit të këmbimit gjatë vitit 2013

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare ekspansioniste në kushtet kur presionet inflacioniste aktuale dhe të pritshme mbeten të dobëta. Banka e Shqipërisë ka ulur në katër raste normën bazë të interesit brenda vitit 2013, duke e çuar atë në nivelin minimal historik prej 3.00%. Me qëllim rritjen e efektivitetit të politikës monetare, ajo ka nisur të përcjellë në publik pritjet për ecurinë e mundshme të kursit të politikës monetare në të ardhmen. Këto pritshmëri mbeten të kushtëzuara nga vlerësimi mbi presionet e kërkesës dhe të ofertës në ekonomi. Megjithatë, Banka e Shqipërisë ka arritur të ankorojë me sukses fundin afatgjatë të kurbës së *yield*-eve dhe të ndikojë uljen e normave afatgjata të interesit. Përgjatë vitit 2013, Banka e Shqipërisë ka vijuar të injektojë likuiditet në sistemin bankar me anë të marrëveshjeve të anasjella të riblerjes me afat 7-ditor dhe 1-mujor. Instrumentet e politikës monetare nuk kanë pësuar ndryshime gjatë kësaj periudhe. Primet për rrezikun e likuiditetit kanë qenë të ulëta dhe normat e interesit në tregun ndërbankar të qëndrueshme.

Pavarësisht lehtësimit të vazhdueshëm të kushteve monetare, standardet e kredidhënies vijojnë të jenë të shtrënguara, ndërkohë që kostoja e kreditimit ka shfaqur vetëm një rënie të lehtë. Efektiviteti i politikës monetare është dobësuar në praninë e pasigurive të larta të agentëve ekonomikë, të reflektuara këto në kërkesën e vogël për financim dhe elasticitetin e ulët ndaj normës së interesit. Mekanizmi i transmisionit vijon të pengohet nga përkeqësimi i cilësisë së aktiveve në bilancet e bankave, gjë që ka rezultuar në shtrëngimin e kushteve të kreditimit. Në të njëjtën kohë, vështirësitë e vazhdueshme me të cilat është përballur sistemi bankar i Eurozonës dhe shtrëngimi i politikave makroprudenciale në vendet e BE-së kanë ndikuar kushtet e kreditimit në Shqipëri, për shkak të përqendrimit të bankave evropiane në sistemin tonë financiar.

Në rrethanat aktuale, Banka e Shqipërisë e vlerëson kërkesën e ulët në ekonomi si rrezikun kryesor që cenon stabilitetin makroekonomik e financiar. Për këtë arsye, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2013, Banka e Shqipërisë e ka plotësuar kuadrin e lehtësimit të politikës monetare me relaksim të disa instrumenteve makroprudenciale, të cilat synojnë të mbështesin rritjen e kredisë. Këto masa:

redukojnë raportet e likuiditetit të detyrueshme për bankat (pavarësisht nisjes nga një bazë e lartë); ulin kërkesat për kapital për kredinë e re akorduar gjatë vitit; krijojnë premisa për ristrukturimin e kredisë; nxisin bankat për të kredituar ekonominë vendase kundrejt alternativës për të investuar në tregjet e huaja financiare; dhe lehtësojnë procedurat për trajtimin e kredive të këqija, nëpërmjet përmirësimit të praktikave për ekzekutimin e kolateralit dhe përqasjen ndaj taksimit të tyre. Banka e Shqipërisë do të vlerësojë me kujdes efektin e politikave makroprudenciale, me qëllim që ato të jenë në linjë me zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të sistemit bankar.

Politika monetare dhe e kursit të këmbimit në periudhën afatmesme

Objektivi parësor i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë mbetet ruajtja e stabilitetit të çmimeve të konsumit, që në terma sasiorë shprehet në një inflacion vjetor prej 3% me një interval tolerance prej +/-1.0 pp, në afat të mesëm. Përgjatë vitit 2013, inflacioni vjetor ka rezultuar pranë vlerës 2% (janar - nëntor), duke qëndruar pranë kufirit të poshtëm të intervalit të tolerancës. Bazuar në: zhvillimet e fundit në inflacion; supozimet për përcaktuesit kryesorë të inflacionit; projeksionet mbi çmimet e lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare; projeksionet tona për vijim të hendekut negativ të prodhimit, inflacioni vjetor gjatë vitit 2014 pritet të luhatet në intervalin 0.4%-3.1%, me një probabilitet prej 90%. Projeksioni qendror për disa tremujorë të mëvonshëm qëndron pranë gjysmës së ulët të intervalit të shënjestruar të Bankës së Shqipërisë. Rreziqet në kahun rënës do të vijnë në të përcaktohen nga presionet e ulëta me burim kërkesën agregate dhe nga presionet e dobëta nga komponentët e inflacionit të importuar. Ky parashikim ka përjashtuar efektet e mundshme nga rritja e çmimeve të rregulluara dhe të akcizës, të përfshira në paketën e re fiskale për vitin 2014. Vlerësime paraprake tregojnë se efekti i përgjithshëm i masave të tilla mund të ketë një ndikim rreth 1 pikë përqindje në inflacionin e IÇK-së. Megjithatë, duke pasur parasysh, ciklin aktual në të cilin ndodhet ekonomia shqiptare, efektet e tyre priten të jenë të përkohshme.

Në të ardhmen, Banka e Shqipërisë do të monitorojë të gjithë informacionin e disponueshëm në zhvillimet ekonomike dhe monetare dhe do të vlerësojë ndikimin e tyre mbi stabilitetin e çmimeve në periudhën afatmesme. Qëndrimi i politikës monetare do të vazhdojë të synojë ruajtjen e lehtësimit të kushteve monetare, në linjë me pritshmëritë për stabilitetin e çmimeve. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të përdorë instrumentet ekzistuese për zbatimin e politikës monetare.

Kuadri i politikës monetare, ndër të tjera, do të vazhdojë të veprojë në regjimin e kursit të lirë të këmbimit. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor janë minimale dhe të paralajmëruara, dhe nuk synojnë të ndikojnë kahun e politikës monetare.

Pa komprometuar angazhimin e saj kryesor për stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë është përpjekur të koordinojë politikat monetare dhe ato makroprudenciale me politikat fiskale dhe ekonomike të vendit. Ne besojmë se një koordinim i tillë është mënyra më e mirë për të siguruar rritje më të lartë dhe luhatshmëri më të ulët në ekonomi. Politika fiskale ekspansioniste dhe pasiguria që rrethoi borxhin publik gjatë vitit 2013 kanë qenë faktorë që kanë përcaktuar ritmin e lehtësimit të politikës monetare gjatë kësaj periudhe. Në përgjithësi, ne besojmë se angazhimi i Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve dhe mbajtja e një regjimi të luhatshëm të kursit të këmbimit, paraqet një ankorë nominale të besueshme për ekonominë. Megjithatë kuadri institucional i politikëbërjes do të mund të përfitonte nga një angazhim i besueshëm për qëndrueshmërinë e borxhit shtetëror.

Në rolin e saj si mbikëqyrëse e sistemit bankar, Banka e Shqipërisë synon të promovojë praktikat bankare më të mira dhe njëkohësisht të rrisë konkurrencën në sistem. Hyrja më e fundit e pjesëmarrësve të rinj në tregun e letrave me vlerë të qeverisë pritet që të ofrojë përfitime në këtë drejtim. Këta ndërmjetës financiarë më të specializuar do t'i shtynë bankat që të fokusojnë vëmendjen e tyre drejt kreditimit. Për më tepër, përmirësimi i rrjetës së sigurisë në sistemin financiar do të inkurajojë bankat që të marrin përsipër më shumë rrezik në aktivitetin e tyre.

Spektori i jashtëm dhe qëndrueshmëria e tij afatmesme

Deficitet e larta të eksporteve neto dhe rënia e remitancave të emigrantëve drejt vendit tonë, kanë ndikuar në thellimin e raportit të deficitit të llogarisë korrente ndaj PBB-së, i cili arriti kulmin e tij në rreth 15.6% në vitin 2008 dhe në 15.3% në vitin 2009. Të dhënat që vijnë nga tri vitet e fundit, tregojnë se ka një përmirësim të lehtë të llogarisë korrente ndaj PBB-së (10.7% në vitin 2012, raporti më i ulët që nga

viti 2007).

Në tërësi, ne kemi parashikuar një tkurrje të deficitit të llogarisë korrente me rreth 4.3% në vitin 2013, të udhëhequr kryesisht nga një rënie e qenësishme e deficitit tregtar, pavarësisht rënies së transfertave korrente neto. Në vitin 2014, pritet që transfertat korrente neto të mbeten kryesisht të pandryshuara dhe suficiti i llogarisë së shërbimeve neto të përjetojë një rritje të përsheptuar. Deficiti i përgjithshëm i llogarisë korrente është parashikuar të ulët çdo vit ku në vitin 2013, deficiti i llogarisë korrente pritet të vlerësohet në rreth 10% ndaj PBB-së nominale dhe në vitin 2014 në rreth 8.3% të PBB-së nominale. Vlerësimet për vitin 2015 dhe 2016 përcaktojnë një deficit të llogarisë korrente në një nivel, përkatësisht 7.6% dhe 7.3% të PBB-së, ku hendeku i prodhimit ngushtohet si pasojë e kontributit më të lartë të eksporteve neto.

Deficiti tregtar pritet të tkurret me 17% në vitin 2013 dhe më pas të zgjerohet lehtë me 3% në vitin 2014. Eksportet e mallrave do të mbeten të bazuara kryesisht në burimet natyrore (naftë bruto) dhe industrinë tekstile (tekstile dhe këpucë), ndërsa importet janë projektuar të rriten lehtësisht në vitin 2014 si pasojë e përmirësimit të lehtë të kërkesës së brendshme për mallra të huaja. Politika të reja, të përqendruara drejt turizmit në vend, si dhe një mjedis më i stabilizuar politikisht dhe ekonomikisht më 2014-ën, priten të ndihmojnë rritjen e flukseve hyrëse neto të bilancit të shërbimeve në vitin pasardhës.

Bilanci i të ardhurave parashikohet të tkurret ndjeshëm në vitin 2013 për shkak të një daljeje të të ardhurave nga IHD-ja. Njëkohësisht, kompensimi neto i punonjësve pritet të zvogëlohet për shkak të një rritjeje të ulët ekonomike në Shqipëri. Në vitin 2014, pritet një përsheptim në riatdhesimin e fitimeve të investimeve të huaja direkte, të cilat gjithsesi do të jenë të kushtëzuara nga reformat dhe zbatimi i paketës së re fiskale të propozuar dhe të rentës minerare.

Si pasojë e rënies së dërgesave të emigrantëve, suficiti i llogarisë së transfertave korrente pritet të ngushtohet me rreth 20% për vitin 2013. Përkeqësimi i gjendjes ekonomike dhe vështirësitë në tregjet e punës në vendet pritëse nga të cilët burojnë dërgesat e emigrantëve, Italia dhe Greqia, ndikuan drejtpërdrejt në rënien e transfertave hyrëse. Këto të fundit parashikohet të shënojnë një rënie vjetore prej rreth 25% gjatë vitit 2013. Prirja rënëse e dërgesave të emigrantëve parashikohet të vazhdojë dhe përgjatë vitit 2014 dhe më pas të shënohet një rritje e lehtë përgjatë vitit 2015 dhe 2016. Si pasojë e faktorëve të lartpërmendur, në terma afatgjatë, dërgesat e emigrantëve pritet të mbeten të ulëta dhe rëndësia e tyre si burim i jashtëm financimi pritet të jetë më pak i rëndësishëm. Të ardhurat prej faktorëve të prodhimit neto parashikohen të jenë në rënie për vitet 2013 dhe 2014.


Gjatë vitit 2013, IHD-të kanë ndjekur një prirje pozitive rritëse, kryesisht si pasojë e privatizimit prej kompanive me kapital të huaj të katër hidrocentraleve të mesme në vend. Në të ardhmen, disa zhvillime të pritura mendohet të ndikojnë mbi ecurinë e IHD-ve në Shqipëri.

Shqipëria është përfshirë së fundmi në projektin TAP, i cili pritet të transportojë gaz natyral dhe naftë prej Azerbajxhanit për në Evropën Perëndimore me anë të një sistemi të integruar infrastrukturor dhe një segment pritet të kalojë përmes Shqipërisë së Jugut. Megjithëse, ky projekt madhor është në fazat e tij të para, ai pritet të kontribuojë në rritjen e IHD-ve, veçanërisht në sektorët e ndërtimit, transportit, komunikimit dhe ndërmjetësimit financiar.

Duke qenë se një pjesë e madhe e stokut të IHD-ve ka hyrë në formë privatizimi dhe është përqendruar në kompani ekzistuese dhe aktive, politika të reja strukturore mund të drejtojnë aktivitetin e ri investues drejt projekteve që parashikojnë ndërtimin nga pika e fillimit të aktivitetit ekonomik në Shqipëri (*green field investment*).

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2013, llogaria e investimeve të tjera neto regjistroi një bilanc negativ prej 13.0 milionë eurosh, pas dy vitesh të njëpasnjëshme me bilanc neto pozitiv. Bilanci negativ i këtij nënzëri të llogarisë financiare u përcaktua prej rritjes së nivelit të mjeteve të investuara jashtë, kryesisht në formën e monedhave dhe depozitave të sektorit bankar të investuara jashtë. Hyrjet financiare borxhkrijuese kanë ndjekur një prirje rënëse që prej vitit 2012 dhe regjistruan një vlerë prej 100.6 milionë eurosh gjatë vitit 2013. Një rritje e huamarrjes së jashtme e propozuar prej qeverisë qendrore pritet të rrisë hyrjet financiare borxhkrijuese në vitet në vazhdim dhe pritet, gjithashtu, të rrisë borxhin e jashtëm bruto të Shqipërisë.

Grafik: Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto ndaj PBB-së




Burimi: Banka e Shqipërisë

Zhvillimet në pozicionin ndërkombëtar neto të investimeve të Shqipërisë vijnë të karakterizohen prej rritjes së moderuar të stokut të mjeteve financiare dhe rritjes së përshpejtuar të stokut të detyrimeve financiare. Stoku i mjeteve financiare jashtë vlerësohet në nivelin 36.5% ndaj PBB-së, rreth 3.6 pikë përqindje më shumë krahasuar me një vit më parë. Stoku i detyrimeve financiare ndaj të huajve arriti nivelin 77.9% ndaj PBB-së, duke u rritur me rreth 8.9 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Pozicioni ndërkombëtar i investimeve neto vlerësohet në përafërsisht -41.4% ndaj PBB-së. Investimet direkte në Shqipëri dhe investimet e tjera në formën e huave përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve, duke u vlerësuar me përkatësisht 42.7 dhe 37.7% ndaj totalit të detyrimeve me jashtë. Në krahun e mjeteve financiare, mjetet e rezervës në valutë (kryesisht bono) përbëjnë rreth 53.7% të totalit të mjeteve financiare jashtë.

Borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë nisi të zgjerohet me një prirje të përshpejtuar gjatë vitit 2008 dhe ka vijuar të ruajë një prirje rritëse. Në tremujorin e tretë të vitit 2013, borxhi i jashtëm bruto vlerësohet në përafërsisht 56.4% ndaj PBB-së. Borxhi afatgjatë mbulon përafërsisht 62% të borxhit të jashtëm total dhe përbëhet kryesisht prej huave afatgjata për qeverinë qendrore dhe sektorë të tjerë. Në anën tjetër, borxhi afatshkurtër vlerësohet në rreth 21% ndaj totalit dhe përfshin kryesisht huamarrjen e jashtme të bankave.

Grafik: Borxhi i jashtëm bruto dhe përbërësit sektorialë ndaj PBB-së (majtas) dhe përbërja e borxhit të jashtëm sipas maturiteteve (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë

Vështrimi i borxhit të jashtëm bruto nga perspektiva e qëndrueshmërisë së tij zbulon dy karakteristika kryesore. Përshpejtimi i ritmit të rritjes së borxhit në vitin 2008 duket të mos jetë shoqëruar paralelisht me rritjen e indikatorëve të aftësisë së riparimit të tij, përkatësisht eksportet dhe rritja e PBB-së. Deri në vitin 2008, eksporti i mallrave dhe i shërbimeve mbulonte tërësisht borxhin e jashtëm bruto

duke sinjalizuar një aftësi optimale ripagimi të vendit me anë të fitimeve nga jashtë. Në vijimësi, prirjet afatgjata të borxhit të jashtëm bruto dhe të eksportit të mallrave e të shërbimeve nisën të divergjojnë duke arritur një diferencial prej 23% ndaj PBB-së në vitin 2013. Në të njëjtën kohë, evoluimi i borxhit të jashtëm bruto karakterizohet nga një luhatshmëri e lartë e rritjes së tij, të cilët kulmojnë në tremujorin e katërt të vitit 2008 dhe të tretë të vitit 2011. Që nga viti 2005 borxhi i jashtëm bruto është rritur me ritme më të përshpejtuara se PBB-ja nominale.

Grafik: Diferenca në rritjen vjetore të borxhit të jashtëm bruto dhe PBB-së nominale (majtas) dhe evoluimi kundrejt eksportit të mallrave e të shërbimeve ndaj PBB-së (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Performanca e kursit real të këmbimit vlerësohet të ketë qenë e kënaqshme përgjatë vitit 2013. Në periudhën janar - nëntor 2013, indeksi i lekut, ponderuar me peshat në tregtinë e jashtme, vlerësohet i qëndrueshëm në terma nominalë, ndërsa luhatjet në terma realë ishin të përmbajtura dhe rreth vlerës ± 3 në terma vjetorë. Mesatarisht, indeksi i deflatuar me çmimet e prodhimit pritet të nënçmohet me rreth 0.2%, ndërsa ai i deflatuar me çmimet e konsumit të mbiçmohet me rreth 0.6% në terma vjetorë. Konkurrueshmëria në terma çmimesh mesatare pritet të qëndrojë në nivelet aktuale për dy vitet në vazhdim, edhe pse ka disa sinjale për mbiçmim gjatë vitit 2015, nëse korrigjohet për çmimet e konsumit.


Në lidhje me konkurrueshmërinë jo në terma çmimesh, përafruar nga konkurrueshmëria teknologjike (përafruar nga shpenzimet në kërkim-zhvillim si përqindje ndaj PBB-së dhe norma e eksporteve të teknologjive të avancuara ndaj totalit të mallrave të përpunuara) dhe roli i IHD-ve, të dhënat tregojnë që Shqipëria ende nuk ka një pozicion epërsie (burimi: Treguesit e BB-së, 2012).

Të dhënat mbi shpenzimet në kërkim-zhvillim si përqindje ndaj PBB-së dhe norma e eksportit të teknologjive të avancuara (si përqindje e totalit të eksportit të mallrave të përpunuara) sugjerojnë se niveli i shpenzimeve në kërkim-zhvillim është më i ulët (rreth 0.2%) në rajon dhe më i ulët krahasuar me Eurozonën (rreth 2.0%). I njëjti rezultat arrihet edhe nëse konsiderojmë si tregues nivelin e eksportit të teknologjive të avancuara ndaj totalit të eksportit të mallrave të përpunuara. Për pasojë, Shqipëria ka nevojë për ndryshime strukturore të mëtejshme në tregun e punës dhe, gjithashtu, në tregun e mallrave, në terma cilësie dhe standardesh, me qëllim përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe përshpejtimin e procesit përafrues me vendet e zhvilluara.

Tregtia e mallrave, përgjatë 10 muajve të vitit 2013, pasqyron vijimësinë e prirjes rritëse të eksporteve, edhe pse me një normë më të ulët krahasuar me vitet 2012 dhe 2011 dhe rënien e përshpejtuar të importeve. Vijimësia e kushteve të vështira makroekonomike, ndër partnerët tanë tregtarë tradicionalë dhe në vendet e rajonit, nxiti eksplorimin e tregjeve të reja nga ana e bizneseve eksportuese. Kjo e fundit u pasqyrua në ndryshimin e eksporteve tona si nga përbërja e mallrave të eksportuara ashtu dhe në terma gjeografikë. Përgjatë vitit 2013, eksporti i mallrave të përfshira në kategorinë “Minerale, naftë dhe energji elektrike” ishte përcaktuesi kryesor i ecurisë pozitive të eksporteve vendase. Si pasojë e rritjes së investimeve të huaja direkte në industrinë nxjerrëse, eksporti i naftës bruto shënoi një rritje progresive në periudhën e konsideruar. Eksporti i energjisë elektrike, gjithashtu, kontribuoi pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të eksporteve, por performanca e saj ka natyrë sezonale. Eksporti i mallrave me karakter rieksportues, duke përfaqësuar historikisht një burim të qëndrueshëm të ardhurash nga eksportet e

udhëhequra nga sektori privat, kontribuoi pozitivisht në eksportet totale. Në të njëjtën kohë, eksportet vendase u zhvendosën drejt destinacioneve të reja dhe u konsoliduan ato të sapokrijuara, si p.sh. me vendet e CEFTA-s. Niveli i konsiderueshëm i eksportit të naftës bruto bëri të mundur hyrjen në tregje të reja si Spanja dhe krijimin e partneriteteve të reja tregtare. Megjithatë, mbështetja në një gamë të ngushtë prodhimesh të eksporteve tona bën që Shqipëria të jetë shumë e ndjeshme ndaj goditjeve të jashtme.

Grafik: Shkalla e hapjes ekonomike, eksportet dhe importet (% ndaj PBB-së, majtas); IHD-neto (% ndaj PBB-së, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT

Treguesi i shkallës së hapjes ekonomike gjatë periudhës 2002 - 2013, arriti nivelin e tij më të lartë në vitin 2011 dhe më pas shënoi rënie të vazhdueshme si pasojë e ngushtimit të importeve. Eksportet mbajtën një prirje rritëse përgjatë gjithë periudhës së konsideruar. Flukset neto të investimeve të huaja direkte shënuan rritje të vazhdueshme përgjatë të gjithë periudhës, pavarësisht rënies së lehtë të shënuar në vitet 2011 dhe 2012. Pjesa më e madhe e IHD-ve është në trajtën e letrave me vlerë të pasurisë dhe fitimeve të riinvestuara.

Sektori financiar

Sektori bankar shqiptar ka ruajtur të njëjtën strukturë dhe stabilitet gjatë vitit 2013, pavarësisht përballjeve me sfida të konsiderueshme të lidhura me mjedisin e dobët ekonomik dhe rigjenerimin e ngadaltë të tregjeve botërore gjatë viteve të fundit, të cilat kanë frenuar përfitueshmërinë dhe kanë rritur rreziqet e kreditimit. Aftësia paguese e sektorit bankar është përmirësuar dhe qëndron dukshëm mbi nivelet minimale të kërkuara të kapitalit, si rezultat i rritjes së kapitalit bazë dhe rënies së aktiveve të ponderuara me rrezik. Rreziku i likuiditetit ishte i moderuar, sektori bankar vazhdoi të shfaqë rritje të depozitave, dhe aktivet likuide në lekë dhe valutë tejkaluan nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregulator.

Për sa i përket rrezikut të tregut, sektori bankar u shfaq relativisht i mbrojtur nga rreziku direkt i lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit dhe normave të interesit. Sektori bankar u paraqit i ekspozuar ndaj ndjeshmërisë së klientëve kundrejt lëvizjeve të pafavorshme të normës së interesit dhe kursit të këmbimit.

Sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, duke përbërë mbi 90% të aktiveve totale të sistemit financiar. Në fund të muajit shtator 2013, sektori bankar përbënte 90.8% të PBB-së.

Duke analizuar bilancin e sektorit bankar shqiptar, vërehet se niveli i aktiveve, nga 1.188 miliardë lekë në fund të 2012-ës, u rrit në 1.235 miliardë në shtator 2013. Rritja e investimeve në letra me vlerë dominoi performancën e aktiveve, ndërkohë që huadhënja shfaqti kontribut në rënie. Në këtë kuadër, volumi i letrave me vlerë i sektorit u ngjiti në 288.4 miliardë lekë, duke treguar rritje me 12.4% krahasuar me fundin e vitit 2012. Arsyeja kryesore për këtë rritje të konsiderueshme të portofolit të investimit të letrave me vlerë ishte vendimi i qeverisë shqiptare për të përqendruar financimin brenda vendit në fillim të vitit, por edhe orientimi i bankave drejt investimeve me rrezik të ulët.

Gjatë së njëjtës periudhë, pesha e huave në totalin e aktiveve ka treguar rënie, ndërkohë që pesha e letrave me vlerë ka vazhduar të rritet. Në përputhje me këtë, pesha e huave në totalin e aktiveve, 48.3% në vitin 2012, ra në 45.6% në shtator 2013. Huat për biznese, të cilat përbëjnë 68.8% të totalit të huave dhe ishin shtysa kryesore e huadhënies gjatë tri viteve të fundit, u tkurrën me 4% në terma vjetorë, nga

1.5% rritje në dhjetor 2012. Huat për individët u rritën me 0.8% në terma vjetorë, nga 0.4% rritje në dhjetor 2012.

Burimet e financimit tregojnë që depozitat ishin kontributi kryesor në mbledhjen e fondeve, duke përbërë 83% të totalit të detyrimeve të sektorit bankar. Depozitat e sektorit bankar vazhduan të rriten, pavarësisht se me një ritëm më të ulët kundrejt dy viteve të mëparshme. Varësia e sektorit bankar nga burimet e jashtme të financimit paraqitet e kufizuar. Nga ana tjetër, bankat vazhdojnë të rrisin aktivet e tyre jashtë, megjithëse me një ritëm më të ulët. Në të kundërt, vërehet një përdorim më i ulët i linjave të kredisë nga bankat mëma.

Kur analizohen treguesit e fortësisë financiare, vihet re se raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit, i cili ishte 17.8% në shtator 2013, është ndjeshëm mbi nivelet minimale të kërkuara, 12%. Qëllimi i fondeve të veta të sektorit bankar shqiptar përbëhen kryesisht nga kapitali bazë, duke ofruar qëndrueshmëri ndaj goditjeve.

Si tregues i rrezikut të kredisë së sektorit, raporti i huave me probleme ndaj portofolit bruto të huave u rrit me 10.5% në vitin 2009, si rezultat i shfaqjes së krizës financiare globale dhe u zgjerua më tej në 24.2% në shtator 2013. Rreziku i kredisë paraqet sfidën kryesore të sistemit bankar. Rritja e ulët ekonomike është faktori kryesor që shpjegon rritjen e rrezikut të kredisë në bilancet e bankave. Pasiguria rreth zhvillimit ekonomik, kushtet e dobëta në tregun e punës, paqëndrueshmëria e të ardhurave dhe remitançave dhe problemet strukturale janë disa nga faktorët që kanë sjellë rënien e cilësisë së kredisë, për individët dhe bizneset. Megjithëse me norma të ndryshme, cilësia e kredive është përkeqësuar për kreditë në lekë dhe në valutë, si dhe për individët dhe bizneset. Sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në rastin e huave në valutë dhe për huat të akorduara bizneseve. Raporti i huave me probleme ndaj portofolit bruto të huave për këto dy kategori u rrit, përkatësisht në 26.2% dhe 28.6% në shtator 2013, nga 24.7% dhe 25.9% në dhjetor 2012. Për sa i përket portofolit të huave në valutë, rreth 90% të tyre janë në euro, pjesa e mbetur në dollar. Stoku i huave në valutë, ku të ardhurat e huamarrësit janë në monedhën vendase, përbën 31.1% të totalit të stokut të kredive dhe 48.8% të stokut të huave në valutë në shtator 2013.

Raporti i pozicionit neto të hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator ishte 4.3% në shtator 2013, çka tregon ndikim të moderuar nga luhatjet në kursin e këmbimit dhe nivele shumë të ulëta rreziku. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj luhatjeve të normës së interesit është kufizuar. Masa e ekspozimit, e matur si diferencë midis aktiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit, është në nivele të menaxhueshme. Pavarësisht kësaj, sektori bankar mbetet i ekspozuar ndaj impaktit që vjen si rezultat i ndjeshmërisë së klientëve ndaj luhatjeve të normës së interesit dhe kursit të këmbimit. Një zhvlerësim i rëndësishëm në kursin e këmbimit, ose një rritje e normës së interesit mund të dëmtojë aftësinë paguese të klientëve, sidomos të atyre nga sektori i biznesit. Kanali kryesor i transmetimit të këtij rreziku përfaqësohet nga huat në valutë kur të ardhurat e klientit janë në monedhën vendase dhe huat e akorduara me normë interesi të ndryshueshme.

Raporti i transaksioneve jashtë bilancit ndaj aktiveve, i cili është rritur gjatë viteve të fundit, ka si qëllim mbrojtjen nga rreziqet financiare.

Tabelë: Tregues të sektorit bankar

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Shtator 2013
Agregatat kryesore								
Aktivët (miliardë lekë)	624.28	742.86	834.14	886.31	990.63	1,120.17	1,187.98	1,235.16
Kredi (miliardë lekë)	197.96	292.46	396.77	449.89	490.87	566.22	577.82	567.61
Depozita (miliardë lekë)	525.53	630.11	645.14	694.26	816.73	924.06	991.67	1,026.93
Numri i bankave	17	17	16	16	16	16	16	16
Numri i punonjësve (mijë)	4,189	5,155	6,493	6,404	6,384	6,714	6,836	6,325*
Tregues të performancës								
Rezultati neto (miliardë lekë)	7.45	10.57	7.34	3.54	6.72	0.71	3.77	(1.28)

Kthimi nga aktivet (%)	1.36	1.57	0.91	0.42	0.72	0.07	0.33	(0.14)
Kthimi nga kapitali (%)	20.17	20.74	11.35	4.58	7.58	0.76	3.78	(1.67)
Kredi / totali i aktiveve (%)	31.71	39.37	47.57	50.76	49.55	50.55	48.64	45.95
Tregues të rrezikut								
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (%)	18.07	17.08	17.23	16.17	15.40	15.56	16.17	17.76
Pozicioni valuator në bilanc (miliardë lekë)	2.02	0.78	2.52	3.12	4.53	3.72	1.99	3.33
Pozicioni i përgjithshëm valuator (miliardë lekë)	2.02	0.78	2.52	3.16	4.53	3.88	4.14	4.94
Kredi me probleme / kredi bruto (%)	3.05	3.36	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	24.22
Portofoli i letrave me vlerë / aktive (%)	14.73	17.95	19.99	20.05	21.27	21.80	21.61	23.35
Transaksione jashtë bilancit / totali i aktivitet (%)	42.28	54.84	89.08	94.04	88.74	102.98	107.59	114.64

Burimi: Banka e Shqipërisë *Të dhëna paraprake sipas Shoqatës Shqiptare të Bankave

Fitimi i sistemit bankar ka treguar vlera pozitive dhe të kënaqshme gjatë muajve të fundit të vitit 2012, dhe ka vazhduar në të njëjtën rrjedhë edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2013. Pavarësisht kësaj, cilësia e portofolit të kredisë ka vijuar të përqeshohet dhe një pjesë e rëndësishme e fitimit operativ të sektorit ka shkuar për krijimin e fondeve të nevojshme rezervë për mbrojtjen nga rreziku të kredisë, duke gërryer vazhdimisht fitimin në sistemin bankar.

RoA dhe RoE, tregues përfitueshmërie, shfaqën vlera negative në shtator 2013, përkatësisht me -0.14 dhe -1.7%, si pasojë e rënies së rezultatit neto. Sistemi bankar filloi të tregonte vlera të ulëta për këta tregues në muajin maj 2013.

Përfitueshmëria e bankave si kthim nga kapitali aksioner u përqeshua gjatë këtij viti. Megjithatë, ndryshimi në RoE gjatë 2013-ës, u shkaktua thuajse ekskluzivisht nga rënia e marzhit të fitimit, pasi aktivet e ponderuara me rrezik dhe leva financiare patën impakt të parëndësishëm në rënie e përfitueshmërisë nga viti i kaluar. I njëjti zhvillim evidentohet për RoA, tregues që shfaq rënie të konsiderueshme nga viti i kaluar.

Analiza “Stress Test”

Nëpërmjet provës së rezistencës ose analizës “Stress-Test” me vështrim nga e ardhmja, vlerësohet stabiliteti i sistemit financiar dhe mjaftueshmëria e kapitalit në sektorin bankar për një periudhë kohore deri në fund të vitit 2014. Prova e rezistencës vlerëson ndikimin e situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar, duke përjashtuar mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Kjo analizë fokusohet në vlerësimin kryesisht të rrezikut të kredisë dhe ndikimin përkatës në kapitalizimin e bankave dhe përmban tre skenarë: skenarin bazë dhe dy versione të skenarëve të rënduar. Skenari bazë bazohet në parashikimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë, mbështetur kryesisht në ecurinë e tyre historike. Skenarët e rënduar të analizës supozojnë një situatë të “stresuar” me një probabilitet të ulët ndodhjeje. Ato janë mbështetur në dy goditje të mundshme në ekonominë shqiptare:

- Stopimi i kreditimit (rritje vjetore 0%), duke supozuar njëkohësisht dhe rritje të normave të interesit të tregut dhe rënie të të ardhurave neto nga interesi me 5% në terma vjetorë (skenari i rënduar R1);

- Stopimi i kreditimit (rritje vjetore 0%), nënçmim i monedhës vendase me 20%, rritje e normave të interesit dhe rënie e të ardhurave neto nga interesi me 10% (skenar i rënduar R2).

Rezultatet e ushtrimit tregojnë se në të gjithë skenarët, grupet e bankave mbeten të mirëkapitalizuara me përjashtim të fundit të vitit 2014, ku bankat e mesme bien poshtë nivelit 12%.

Ky rezultat është i pritshëm në kushtet kur edhe niveli fillestar i normës së kapitalit në shtator 2013 për bankat e mesme është më i ulët se për grupet e tjera bankare. Për sa u përket bankave të mëdha, materializimi i skenarit R1 do të zvogëlonte disi normën e mjaftueshmërisë së kapitalit për periudhën deri në fund të 2014-ës, ndërkohë që shtimi i goditjes së kursit të këmbimit do të reflektohej në një tkurrje të mëtejshme të tij, duke vijuar të mbetet në nivele mbi 17%. Goditjet e skenarëve R1 dhe R2 kanë një efekt më të ndjeshëm në uljen e kapitalizimit të bankave të vogla, mesatarisht me 8 pikë përqindje në rastin e

skenarit R1 dhe 9 pikë përqindje në rastin e skenarit R2 krahasuar me vlerat e shtatorit 2013. Për sa i përket nevojës për shtim të kapitalit rregullator, në rastin e skenarit R1 totali për sistemin vlerësohet në nivelin 2.1 mld lekë dhe në rastin e skenarit R2, në nivelin 7.03 mld lekë. Në periudhën janar - shtator 2013 sistemi e ka shtuar kapitalin me 11.5 mld lekë.

Në lidhje me vlerësimin e rrezikut të tregut, është vlerësuar ekspozimi i bankave të sektorit bankar ndaj rrezikut sovran të investimit në letra me vlerë të borxhit publik të huaj, si dhe në letra të borxhit tregtar. Skenari i rrezikut përmbledh goditje në formën e një marzhi reduktues (*haircut*) ndaj vlerës së investimeve në letra me vlerë të huaja mbi vlerën e tregut të raportuar nga bankat. Rezultatet e ushtrimit tregojnë se ekspozimi është i ndjeshëm për titujt e borxhit tregtar privat, ndërsa ekspozimi në titujt e borxhit sovran është më i kufizuar.

Për vlerësimin e përcjelljes së rrezikut në sektorin bankar shqiptar nëpërmjet efektit zinxhir (*contagion risk*), është ndërtuar edhe prova e rezistencës në lidhje me ekspozimin e sektorit bankar ndaj grupeve bankare zotëruese. Rezultatet e ushtrimit sugjerojnë se ky ekspozim vijon të mbetet i konsiderueshëm, sidomos për disa banka të veçanta.

Shoqëritë e sigurimit

Karakteristika kryesore e sektorit të sigurimeve në Shqipëri është pesha e ulët që ai zë prej 1.59% në totalin e aktiveve të sistemit financiar, si rezultat i dominimit të sektorit bankar (rreth 92% e totalit të aktiveve të sistemit financiar). Aktualisht, 12 kompani sigurimi (nga të cilat 9 kompani sigurimi të jojetës dhe 3 kompani sigurimi të jetës), 1 kompani risigurimi dhe 8 brokera sigurimi janë aktivë në tregun e sigurimeve. Tregu vijon të dominohet nga sigurimi i jojetës me një peshë prej 88.1% të totalit të vëllimit të primeve. Sigurimi i jetës zë rreth 11.6% dhe risigurimi 0.3%. Për sa i përket strukturës së primeve, sigurimi vullnetar për primet e shkruara bruto dominon me 54%, ndjekur nga sigurimi i detyrueshëm me 46%. Të ardhurat nga primet për periudhën janar - tetor 2013 ishin rreth 6,619 milionë lekë, ose 10.51% më pak se e njëjta periudhë një vit më parë. Gjatë kësaj periudhe, totali i detyrimeve të paguara ishte 2,323 milionë lekë ose 1.88% më shumë se e njëjta periudhë një vit më parë.

Zhvillimet në tregun e fondeve të investimit

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2013, në Shqipëri operonin dy fonde investimi: Fondi i investimit “Raiffeisen Prestige” (në monedhën vendase) dhe ai i “Raiffeisen Invest Euro”. Sipas analizës së të dhënave për zhvillimet në fondet e investimit deri më 30 shtator 2013, vlera neto e aktiveve të tyre arrin në 40.85 miliardë lekë, duke regjistruar një rritje prej 155.2% në krahasim me muajin dhjetor 2012. Ky treg dominohet nga investimet në letrat me vlerë të qeverisë, të cilat përfaqësojnë 74.23% të aktiveve të fondeve. Aktualisht, aktivet e fondeve të investimit përfaqësojnë rreth 3% të PBB-së dhe të totalit të aktiveve të sistemit financiar.

Fondet e pensionit

Në shtator 2013, në Shqipëri operojnë tri fonde pensionesh private vullnetare: Raiffeisen Invest, Sigal-Life Uniqa Group Austria dhe Sicred. Analiza e të dhënave paraqet rritje të aktivitetit të fondeve të pensionit me 41.4% pasi aktivet arritën nivelin 400.95 milionë lekë. Numri i anëtarëve të fondeve të pensionit u rrit me 7.8% krahasuar me fundin e vitit 2012. Fondet e pensionit përfaqësojnë një peshë të vogël në PBB-në e vendit dhe njëkohësisht në totalin e aktiveve të sistemit financiar prej vetëm 0.03%.

2.3 Skenarët alternativë dhe risku

Risqet për nga kahu negativ e pozitiv, që rrethojnë skenarin bazë të kuadrit makroekonomik e fiskal, vlerësohet të jenë të balancuara. Skenari bazë vlerësohet të ketë një nivel relativisht të lartë materializimi në tërësinë e tij.

Megjithatë, parashikimi i skenarëve alternativë, të cilët bazohen mbi supozimet e materializimit të një pjese të arsyeshme të risqeve të ndryshme që rrethojnë skenarin bazë, përbën një komponent të rëndësishëm të planifikimit të financave publike. Me synim rritjen e cilësisë së planifikimit, për të pasur një menaxhim sa më eficient të fondeve publike në çdo situatë, e cila ka një probabilitet të caktuar të ndodhë, më poshtë paraqiten shkurtimisht dy skenarë alternativë të atij bazë. Konkretisht është ndërtuar një skenar “pesimist” dhe një skenar “optimist”.

Secili prej skenarëve alternativë supozon materializimin e një seti risqesh negative (në rastin e

skenarit “pesimist”) ose pozitive (në rastin e skenarit “optimist”). Kjo bashkësi risqesh supozon devijimin nga parashikimet respektive të skenarit bazë të disa treguesve kryesorë makroekonomikë, si: kreditimi i ekonomisë, ecuria e ekonomisë së Eurozonës me efektet derivate në eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, remitanca flukse të ndryshme të kapitalit të huaj dhe kursit të këmbimit, masa e rezultantes së impakteve dhe ritmi i efektivitetit të politikave strukturore të planifikuara për periudhën afatmesme në vijim etj. Rezultantja tërësore e të gjitha këtyre risqeve, qoftë në kahun negativ apo pozitiv, është kuantifikuar dhe paraqitet në termat e një variabli të vetëm, rritjes reale ekonomike. Pra, skenarët alternativë të paraqitur më poshtë, ndryshojnë nga ai bazë prej devijimit të supozuar të rritjes reale ekonomike për secilin vit të periudhës 2014 – 2016 prej parashikimit pikësor në skenarin bazë. Mbi bazën e një rritje ekonomike të ndryshme, të supozuar nga ai bazë, në secilin prej skenarëve alternativë janë parë efektet derivate në të ardhurat e buxhetit të shtetit. Në skenarin “pesimist”, përveç supozimit të rritjes ekonomike (një rritje më e ulët se sa te skenari bazë), është supozuar, gjithashtu, një elasticitet më i fortë i zërave kryesorë të të ardhurave. Pra, për një rritje më të ulët ekonomike është supozuar se eficienta e mbledhjes së të ardhurave prej disa prej taksave më kryesore, e shprehur kjo si raport ndaj PBB-së, do të jetë më e ulët se sa në skenarin bazë. Ndërsa në skenarin “optimist”, kjo është mbajtur e njëjtë me skenarin bazë.

Në linjë me trajektoren e përcaktuar të politikës fiskale kundrejt ecurive të mundshme të ciklit të ekonomisë, e konsultuar ngushtësisht edhe me FMN-në e BB-në, siç shpjegohet në seksion e parë të këtij programi (shih faqen 4), për çdo skenar është ndryshuar respektivisht edhe niveli i targetuar i deficitit të përgjithshëm fiskal. Respektivisht, parashikohet një relaksim i deficitit fiskal të targetuar në rastin e skenarit “pesimist” dhe një konsolidim më i fortë në rastin e skenarit “optimist”.

Në vijim, jepen ndryshimet e supozuara të secilit prej skenarëve alternativë kundrejt në krahasim me atë bazë, përcaktohet ndryshimi i burimeve totale të buxhetit të shtetit për secilin rast dhe paraqitet mënyra e planifikuar e adresimit të ndryshimeve në secilin skenar kundrejt atij bazë.

Skenari “pesimist”

Në skenarin “pësimist” është supozuar një rritje reale prej 0.4% në vitin 2014, nga 2.1% e supozuar nga skenarin bazë, ndërsa për vitet 2015 dhe 2016 është supozuar një rritje prej 1.1% dhe 2.4%, nga respektivisht 3.3% dhe 4.2% në skenarin bazë.

Ndryshimi negativ i derivuar në burimet e përgjithshme të buxhetit, mesatarisht prej rreth 8 miliardë lekësh më pak për çdo vit 2014 - 2016, mund të adresohet plotësisht me anë të kontigjencave të planifikuara në skenarin bazë.

Skenari “optimist”

Në skenarin “optimist” është supozuar një rritje reale prej 3.5% në vitin 2014, nga 2.1% e supozuar nga skenarin bazë, ndërsa për vitet 2015 dhe 2016 është supozuar një rritje prej 4.5% dhe 5.2%, nga respektivisht 3.3% dhe 4.2% në skenarin bazë.

Ndryshimi pozitiv i derivuar në burimet e përgjithshme të buxhetit, mesatarisht prej rreth 4 miliardë lekë më tepër për çdo vit 2014 - 2016 do të alokohet në shpenzimet kapitale në pjesën më të madhe të tij.

3. Balanca e qeverisë së përgjithshme dhe borxhi

3.1 Strategjia e politikave dhe objektivat afatmesëm

Politika fiskale për periudhën 2014 - 2016 do të jetë e orientuar në një trajektore të konsolidimit fiskal. Ajo synon më së pari vendosjen e financave publike në një trajektore të qëndrueshme, si një prej shtyllave kryesore të rritjes ekonomike dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. Hartimi i politikës fiskale për periudhën afatmesme në vijim është konsultuar ngushtësisht dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe me Bankën Botërore (BB). Ajo është, gjithashtu, në përputhje të plotë me gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian⁵.

Synimi madhor afatmesëm i politikës fiskale është rimëkëmbja e rritjes ekonomike të vendit në nivelet e saj potenciale dhe qëndrueshmëria e saj në kohë.

Objekti kryesor i kornizës së politikës fiskale për periudhën afatmesme, është niveli i deficitit

⁵ Progres Raporti për Shqipërinë 2013

strukturor, i cili siguron qëndrueshmërinë e borxhit publik në periudhën afatmesme dhe afatgjatë dhe minimizon e efektet negative afatshkurtra mbi rritjen ekonomike. Objektivi kryesor operacional sasior i politikës fiskale në kuadrin makrofiskal aktual është ruajtja e deficitit të përgjithshëm fiskal, për çdo vit, përkatësisht si në vijim:

- deficitin i përgjithshëm fiskal prej 6.7% të PBB-së në vitin 2014;
- deficitin i përgjithshëm fiskal prej 4.8% të PBB-së në vitin 2015;
- deficitin i përgjithshëm fiskal prej 3.4% të PBB-së në vitin 2016.

Ky objektivi sasior i politikës fiskale do të korrigjohet në varësi të ciklit ekonomik. Pra, objektivi i deficitit fiskal do të zgjerohet nëse ekonomia performon më poshtë se sa parashikimi aktual dhe e kundërta.

Duhet të theksohet fakti se brenda këtyre niveleve të deficitit për tri vitet e ardhshme përfshihet pagesa e plotë e të gjitha borxheve të akumuluar të qeverisë ndaj sektorit privat, e cila është një përparësi dhe një nga komponentët kryesorë të politikës fiskale për periudhën afatmesme në vijim.

Investimet publike janë parashikuar të mbahen në një nivel prej të paktën 5 për qind të PBB-së, i cili është një nivel optimal për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

3.2 Implementimi i buxhetit më 2013-ën

Analiza e të ardhurave për vitin 2013

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 11-mujore arritën në 292.2 miliardë lekë, 0.2 për qind më shumë se parashikimi për periudhën dhe -3.1 për qind më pak se një vit më parë.

- Të ardhurat nga tatimet dhe doganat ishin në nivelin 202.6 miliardë lekë, ose rreth 2.3 miliardë lekë më shumë nga parashikimi për periudhën dhe -4.5 për qind më pak krahasuar me 11- mujorin e një viti më parë ose me 9.5 miliardë lekë në vlerë absolute;

- Të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 10 miliardë lekë nga 9.2 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë dhe me rënie vjetore prej -0.1 për qind;

- Të ardhurat nga fondet speciale arritën 54.9 miliardë lekë, në linjë me parashikimin dhe rritjen vjetore 4.2 për qind;

- Të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 4.3 miliardë lekë me rënie vjetore -10.4 për qind;

- Të ardhurat jotatimore kanë qenë për këtë periudhë rreth 20.2 miliardë lekë me rënie të ndjeshme të parashikimit prej rreth -7.4 për qind dhe me rënie vjetore -7.2 për qind.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar është një nga zërat më problematikë për periudhën, me ulje të të ardhurave të mbledhura për periudhën -7.3 për qind mbi baza vjetore, duke qenë në nivelin 99.3 miliardë lekë, pothuajse në nivelin e vitit 2009.

Të ardhurat e mbledhura nga importet ishin në nivelin 77.9 miliardë lekë TVSH nga 78.9 miliardë të parashikuar. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 78.5 për qind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 6.4 miliardë lekë më pak, ose -7.5 për qind. Të ardhurat nga TVSH-ja në doganë janë ndikuar nga ecuria e importeve për periudhën. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave rezulton se janë importuar për 11-mujorin rreth 6.4 për qind më pak në vlerë se e njëjta periudhë e një viti më parë; nga totali i importeve, importet e taksuara kanë qenë 7,6 për qind më pak se një vit më parë (si vlerë në lekë).

Të ardhurat e mbledhura mbi furnizimet e brendshme janë 21.5 miliardë lekë TVSH për periudhën janar - nëntor, me rënie vjetore në nivelin -6.3 për qind. Rimbursimi i TVSH-së për periudhën 11-mujore nga tatimet ka arritur 7.2 miliardë lekë me një rritje vjetore prej 11.1 për qind. Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re ndryshim i peshës specifike të TVSH-së ndaj totalit, nga 23.9% në 27.1 për qind në 11-mujorin e vitit 2013.

Tabelë: Ecuria e të ardhurave sipas zërave për 11-mujorin në vite, 2009-2013

Nr.	E M E R T I M I	11M-09	11M-10	11M-11	11M-12	11M-13
	TOTALI TE ARDHURAVE	268,031	293,277	295,677	301,551	292,166
I.	Të ardhura nga ndihmat	2,517	2,777	2,601	4,805	4,303
II.	Të ardhura tatimore	245,962	261,137	272,394	274,966	267,644
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	189,742	201,486	210,103	212,152	202,637
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	99,893	103,242	106,631	107,141	99,335
2	Tatimi mbi Fitimin	15,797	15,925	18,043	15,183	13,561
3	Akcizat	30,538	34,833	36,014	33,133	33,167
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	24,222	24,211	24,800	24,993	26,008
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	12,184	16,830	18,406	26,155	25,497
6	Taksa Doganore	7,107	6,445	6,209	5,547	5,069
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	11,106	10,621	10,776	10,103	10,091
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	1,398	1,795	1,767	2,393	2,286
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2,349	2,256	2,500	2,054	1,914
3	Taksa Lokale	7,359	6,570	6,509	5,656	5,891
II.3	Të ardhurat nga fondet speciale	45,114	49,030	51,515	52,711	54,916
1	Sigurimi Shoqëror	40,021	41,170	44,311	45,168	46,660
2	Sigurimi Shëndetsor	5,092	5,933	5,741	6,372	6,694
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve		1,927	1,463	1,171	1,562
III.	Të ardhura Jotatimore	19,552	29,363	20,682	21,780	20,219
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	3,741	4,486	5,410	4,193	4,508
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	8,652	12,937	9,494	9,111	9,414
3	Dividenti	3,468	578	836	426	928
4	Tarifat sherbimeve	3,692	2,749	3,134	3,430	2,920
5	Të tjera		8,613	1,808	4,620	2,449

Burimi: Ministria e Financave

Akcizat

Të ardhurat gjithsej nga akciza për periudhën janar - nëntor arritën në rreth 33.2 miliardë lekë; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012, të ardhurat nga kjo taksë kanë një ndryshim fare të lehtë në masën 0.1 për qind. Akciza administrohet dhe mbledhet tërësisht nga administrata doganore.

Në tabelën në vijim paraqitet situata e importit sipas grup-mallrave kryesore dhe krahasimi me 11-mujorin e një viti më parë, në të cilën vërehet rënie e importeve për mallrat kryesore, përveç karburanteve që paraqiten me rritje të lehtë kundrejt një viti më parë prej 2 për qind.

Tabelë: Importi i mallrave kryesore të akcizës

Emërtimi	Karburant (tonë)	Birrë (000 litra)	Cigare (tonë)	Kafe (tonë)
11-mujori 2012	391,878	28,109	3,305	6,674
11-mujori 2013	400,439	25,231	3,129	6,283
Përqindje (%)	2%	-10%	-5%	-6%

Burimi: DPD

Për sa u takon të ardhurave nga akciza sipas grup-mallrave kryesore, vërehet në këtë periudhë: rënie e ndjeshme e të ardhurave nga akciza mbi cigaret, kafën dhe birrën, e cila ka ndikuar në ecurinë e përgjithshme të kësaj takse për periudhën në fjalë. Të ardhurat për karburantet paraqiten me rritje shumë të lehtë 0.1%. Theksojmë se nuk ka pasur ndryshime në nivelet e akcizës për produktet kryesore (pije alkoolike, cigare dhe karburante), gjatë 2012-2013. Lidhur me mallrat e tjera përmendim ndryshimin e

akcizës së kafes së pjekur, në fund të vitit 2012, në ulje nga 140 në 60 lekë dhe heqjen e akcizës së kafes së papjekur. Në aspektin administrativ të akcizës, theksojmë hyrjen në fuqi më 1 tetor të ligjit të ri për akcizat, që ndryshon strukturën e administrimit dhe mbledhjes së kësaj takse, si dhe rregullat e reja për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 26 miliardë lekë për periudhën janar - nëntor, ose 4.1 për qind më shumë se 11-mujorin e një viti më parë. Për një ilustrim më të qartë të ecurisë së këtij tatimi, në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të ardhurat sipas burimeve kryesore të të ardhurave individuale (milionë lekë) për periudhën 9-mujore.

Tabelë: TAP sipas burimit të të ardhurave

Emërtimi	11 M 2012 (mln)	11 M 2013 (mln)	Në%
Tatim mbi të ardhurat personale	24993	26008	+4.1
Paga të sektorit publik	8150	8480	+4.0
Paga të sektorit privat	8463	7644	-9.7
Të ardhura nga interesat	3250	3471	+6.8
Të ardhura nga dividendi	1345	2154	+60.1
Të ardhura nga shitja e pasurisë së paluajtshme	277	514	+136.8
Tatim mbi të ardhurat personale të BV	135	172	+27.4
Të tjera	3373	3573	+5.9

Burimi: DPT

Të ardhurat në total nga tatimi mbi pagat janë afërsisht në të njëjtin nivel me një vit më parë, por brenda këtij grupi të ardhurat nga pagat në sektorin publik rezultojnë me rreth 4 për qind rritje, ndërsa ato nga sektori privat me rreth 9.7 për qind rënie në baza vjetore. Në ecurinë e të ardhurave nga ky grup (veçanërisht për sektorin privat) ka ndikuar shfuqizimi i pagave referuese dhe rritja e pragut të përjashtimit nga TAP nga 10,000 në 30,000 lekë, duke filluar nga muaji qershor 2013.

Efektin pozitiv në të ardhurat nga TAP mbi baza vjetore e kanë dhënë zërat: të ardhurat nga dividendi (për këtë zë ka pasur rritje të ndjeshme për periudhën janar - nëntor 2013 të së njëjtës periudhë të një viti më parë), të ardhurat nga interesat dhe të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme (rikujtojmë se gjatë 2012-ës nuk pati thuajse fare të hyra nga ky zë për shkak të procesit të rivlerësimit nga individët të pasurive të paluajtshme).

Subjektet e biznesit të vogël që kanë qarkullim vjetor 2-8 milionë lekë kanë paguar të ardhura personale në shumën 172 milionë lekë për 11-mujorin janar - nëntor 2013 nga 135 milionë të vitit të kaluar ose +27 për qind më shumë.

Tatimet mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 11-mujorin 2013 arritën në rreth 13.6 miliardë lekë nga 15.2 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rënie -10.7 për qind, dhe -1.3% më pak se parashikimi i periudhës janar - nëntor 2013.

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 1.9 miliardë lekë, me rënie vjetore prej -6.8 për qind.

Taksimi i pasurisë

Këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat dhe mbi tokën bujqësore. Për 11-mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 2.3 miliardë lekë rreth -4.5 për qind më të ulëta se një vit më parë.

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera në total për periudhën janë 25.5 miliardë lekë me rënie vjetore prej -2.5 për qind.

Për sa u takon taksave kryesore të këtij grupi vërejmë se: renta minerare në total ka pësuar rritje të të ardhurave 20 për qind mbi baza vjetore (është rritur renta e mbledhur në Doganë me rreth 36%, ndërsa kemi ulje të rentës që mbledhin tatimet me rreth 44 për qind); nga taksa e karbonit janë mbledhur -18.8 për qind më pak të ardhura se një vit më parë; të ardhurat e mbledhura nga mjetet e përdorura të transportit kanë pësuar rënie me rreth -18.8 për qind, duke reflektuar përgjysmimin e kësaj takse në muajin maj të vitit 2013; nga taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin janë mbledhur për këtë 11-

mujor rreth 5.3 miliardë lekë nga 3.8 miliardë të një viti më parë, me rritje 40 për qind në baza vjetore. Rënie të ndjeshme kanë pësuar dhe të ardhurat nga kazinotë dhe lojërat e fatit, me ulje 17.5 për qind krahasuar me 11-mujorin e një viti më parë.

Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar - nëntor janë rreth 5 miliardë lekë, 2.1 për qind më shumë se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 478 milionë lekë ose -8.6 për qind. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, taksa mesatare doganore për periudhën ka qenë 1.38 për qind nga 1.4 për qind e një viti më parë për të njëjtën periudhë.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar - nëntor arritën në 10 miliardë lekë nga 9.2 miliardë lekë të planifikuara, ndërsa kundrejt 11-mujorit të vitit 2012 të ardhurat janë ulur me -12 milionë lekë (rreth -0.1 për qind më pak). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogël dhe taksat mbi pasurinë të cilat përmenden më sipër) kanë mbledhur rreth 5.9 miliardë lekë nga 5.1 miliardë lekë të parashikuar, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar këto taksa kanë pësuar një rritje prej 4.2 për qind.


Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat nga fondet speciale për periudhën janar - nëntor 2013 arritën në 54.9 miliardë lekë, me një rritje prej 4.2 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë dhe në linjë me parashikimin për periudhën. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20.5 për qind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë. Nga totali i fondeve speciale, rreth 53.3 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 1.6 miliardë lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 46.7 miliardë lekë, me rritje vjetore 3.3 për qind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 6.7 miliardë lekë, 5.1 për qind më shumë se 11-mujori i një viti më parë.

Analiza e shpenzimeve buxhetore 2013 (janar - nëntor)

Sipas të dhënave të thesarit nga Ministria e Financave, shpenzimet totale të buxhetit në fund të nëntorit të vitit 2013, arritën në rreth 352.6 miliardë lekë nga 364.2 miliardë lekë të objektivit të përcaktuar për këtë periudhë, ose rreth 96.8 për qind të parashikimit të periudhës me një mosrealizim prej rreth 11.6 miliardë lekësh. Krahasuar me planin vjetor të vitit 2013, këto shpenzime u realizuan rreth 87 për qind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012, shpenzimet buxhetore janë rreth 15.8 miliardë lekë më të larta ose rreth 4.7 për qind më shumë.



Shpenzimet korrente në fund të nëntorit 2013 kanë arritur nivelin 295.5 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 90 për qind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012 këto shpenzime rezultuan 13.8 miliardë më të larta ose rreth 4.9 për qind më shumë.

Brenda shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit, të cilat përfaqësojnë rreth 22.0 për qind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar - nëntor 2013, janë realizuar pothuajse në të njëjtin nivel të parashikimit të periudhës. Këto shpenzime, kundrejt planit vjetor në fund të nëntorit 2013, u realizuan në rreth 92.7 për qind të tij, ndërsa në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2012,

shpenzimet e personelit janë rreth 1.8 miliardë më të larta, ose rreth 2.9 për qind më shumë. Shpenzimet për paga janë rreth 1.7 për qind mbi nivelin e planifikuar të periudhës, ndërsa shpenzimet për sigurime shoqërore janë pothuajse në të njëjtin nivel, duke qenë respektivisht shpenzimet për paga 101.7 për qind dhe shpenzimet për sigurime shoqërore në rreth 98.9 për qind.

Shpenzimet për pagesat e interesit, që përfaqësojnë rreth 13.3 për qind të totalit të shpenzimeve korrente, rezultojnë me një kursim prej rreth 0.9 miliardë lekë, nga të cilat 0.5 miliardë lekë në interesat e brendshme dhe rreth 0.4 miliardë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për interesa janë realizuar në rreth 87.7 për qind, ndërsa krahasuar me vitin 2012, ato janë rreth 1.2 miliardë më të larta ose 3.1 për qind më shumë.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar - nëntor 2013 janë realizuar në rreth 28.8 miliardë lekë, duke qenë rreth 0.5 miliardë më të ulëta se sa niveli i planifikuar.

Shpenzimet për subvencione në fund të periudhës janar - nëntor 2013 ishin rreth 1.4 miliardë lekë ose rreth 82 milionë lekë më pak se sa parashikimi.

Shpenzimet për fondet speciale gjatë periudhës janar - nëntor 2013 rezultuan rreth 1.1 miliardë më pak ose 0.9 për qind më të ulëta se sa parashikimi i periudhës. Krahasuar me planin vjetor, shpenzimet u realizuan në rreth 89.7 për qind, nga të cilat sigurimet shoqërore u realizuan në rreth 91.8 për qind të planit vjetor, shpenzimet për sigurimin shëndetësor në rreth 87.9 për qind, ndërsa shpenzimet për fondin e kompensimit të pronave u realizuan në rreth 83.2 për qind. Krahasuar me vitin 2012, shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 5.2 miliardë lekë më të larta ose rreth 6.5 për qind më shumë, sigurimet shëndetësore janë 1.2 miliardë lekë më të larta ose rreth 4.7 për qind më shumë. Ndërsa fondi i kompensimit të pronave rreth 381 milionë më shumë.

Shpenzimet e pushtetit vendor përfaqësojnë rreth 8.8 për qind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar - nëntor 2013 ato arritën në nivelin 26.1 miliardë lekë, pothuajse në nivelin e planifikuar të periudhës. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime ishin rreth 91.2 për qind të tij, ndërsa krahasuar me vitin 2012 këto shpenzime janë rreth 1.4 miliardë më të larta ose rreth 5.8 për qind më shumë.

Shpenzimet për papunësinë u realizuan në rreth 90.5 për qind të parashikimit të periudhës ose rreth 78.9 për qind të planit vjetor. Në të njëjtën kohë, ky nivel është rreth 176 milionë më pak se sa e njëjta periudhë e vitit 2012 ose rreth 19.3 më e ulët.

Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar - nëntor 2013 rezultoi në rreth 200 milionë më tepër ose rreth 1.2 për qind mbi parashikimin e periudhës (ose rreth 97.8 për qind të planit vjetor). Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012, ky shpenzim ishte rreth 1.3 miliardë më i lartë ose 8.5 për qind më shumë.

Shpenzimet kapitale në fund të nëntorit 2013 u realizuan në rreth 76.9 për qind të planit vjetor. Shpenzimet me financime të brendshme u realizuan rreth 89.9 për qind, ndërsa shpenzimet për investime me financim të huaj u realizuan në rreth 65.6 për qind të planit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012, investimet e brendshme ishin rreth 7 miliardë më të larta ose rreth 29.1 për qind më shumë, ndërsa financimet e huaja ishin rreth 3 miliardë më të ulëta ose rreth 10.3 për qind më pak. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të nëntorit 2013 ishin rreth 7.5 për qind më shumë ose rreth 4 miliardë lekë më të larta se sa e njëjta periudhë e vitit 2012. Struktura e shpenzimeve kapitale, e realizuar gjatë periudhës janar - nëntor 2013 është rreth 54.1 për qind investimet e brendshme dhe 45.8 për qind financimet e huaja.

3.3 Perspektiva buxhetore afatmesme

Të ardhurat dhe politika tatimore

Parashikimi i të ardhurave në buxhetin e konsoliduar

Në parashikimin e të ardhurave për buxhetin e shtetit, të miratuara për vitin 2014, janë mbajtur në konsideratë vlerësimet për ecurinë e ekonomisë, të ardhurat e pritshme nga miradministrimi dhe efektet e paketës fiskale për vitin 2014, siç janë analizuar më lart.

Totali i të ardhurave për 2014-ën është planifikuar në nivelin e 364.7 miliardë lekë, me një rritje prej 11.9 për qind kundrejt të ardhurave të buxhetit të rishikuar për vitin 2013, ose në nivelin 25.7 për qind të PBB-së, nga ku:

- Të ardhurat nga tatimet e doganat parashikohet të jenë 260.5 miliardë lekë, me një rritje prej 16.2 për qind krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2013 ose rreth 18.4 për qind të PBB-së;

- Të ardhurat nga fondet speciale, ku përfshihen kontributet e sigurimeve shoqërore e

shëndetësore dhe të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve, parashikohen në 63.8 miliardë lekë, me një rritje prej 7.0 për qind krahasuar me buxhetin e rishikuar për vitin 2013 ose rreth 4.5 për qind e PBB-së;

- Parashikimi për të ardhurat nga pushteti lokal për vitin 2014 është 10.7 miliardë lekë, me një rritje prej 8.6 për qind kundrejt buxhetit të rishikuar për vitin 2013 ose 0.8 për qind e PBB-së;

- Të ardhurat jotatimore parashikohen në masën 21.1 miliardë lekë ose 1.5% të PBB-së;

- Të ardhurat nga ndihmat parashikohen rreth 8.5 miliardë lekë ose 0.6 për qind e PBB-së.

Sipas zërave parashikimi për 2014-ën është si vijon.

Të ardhurat nga TVSH-ja

Të ardhurat në total nga TVSH-ja parashikohen në nivelin 118.4 miliardë lekë, me rritje 8.5 për qind kundrejt buxhetit të rishikuar për vitin 2013, ose rreth 8.3 për qind të shprehura si raport ndaj PBB-së. Parashikimi për TVSH-në bazohet në pritshmërinë e aktivitetit ekonomik për sektorë të veçantë të ekonomisë, në parashikimet e nivelit nominal të importeve, në prirjen historike të koeficientit të elasticitetit të këtyre të ardhurave ndaj nivelit nominal të importeve të mallrave, si dhe në pritshmëritë lidhur me përmirësimin administrativ në mbledhjen e kësaj takse. Efekt në të ardhurat e pritshme do të ushtrojnë dhe politikat tatimore, të analizuara në detaje më lart.

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin

Të ardhurat në total për tatim-fitimin janë parashikuar në 23 miliardë për vitin 2014, nga 15 mld lekë të pritshme për vitin 2013. Në raport me PBB-në, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin arrijnë në rreth 1.6 për qind. Parashikimi për këtë zë është bazuar në parashikimin për rritjen e bazës së tatueshme e lidhur kryesisht me ecurinë e aktivitetit ekonomik, si dhe të përmirësimeve të pritshme në aspektin administrativ. Efekti i ndryshimit të normës tatimore (siç analizohet më lart) është rreth 7 miliardë lekë për vitin 2014.

Të ardhurat nga akciza

Të ardhurat që parashikohet të mblidhen nga akciza për vitin 2014, janë rreth 48.4 miliardë lekë, me rritje vjetore 29.5 për qind kundrejt buxhetit të rishikuar për vitin 2013, ose në nivelin 3.4 për qind të PBB-së. Efektin dominues në rritjen e të ardhurave e ka rritja e nivelit të taksimit për disa nga mallrat kryesore me akcizë në Republikën e Shqipërisë, si: cigaret, duhani me të dredhur, pijet alkoolike dhe birra.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Nga tatimi mbi të ardhurat personale, parashikohet një nivel të ardhurash prej 28.5 miliardë lekësh ose 0.3 për qind më shumë se vlera e buxhetit të rishikuar për vitin 2013. Në raport me PBB-në, të ardhurat arrijnë në rreth 2.0 për qind. Të ardhurat do të ndikohen kryesisht nga reformimi i taksimit mbi pagat, nga tatim i sheshtë në tatim progresiv, siç shpjegohet më lart. Efekti në të ardhura i reformës tatimore për TAP-in vlerësohet në 1.5 miliardë më pak në terma vjetorë.

Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera

Të ardhurat nga taksat nacionale për vitin 2014 parashikohet të jenë rreth 36.4 miliardë lekë, me rritje 26.9 për qind ndaj buxhetit të rishikuar për vitin 2013 (ose 2.6 për qind e PBB-së). Parashikimet për të ardhurat nga kjo taksë janë bazuar në parashikimet e rritjes së aktivitetit ekonomik, parashikimet për ecurinë e eksporteve, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte të ardhurat nga renta minerare, trendi historik i rritjes së tyre dhe pritshmëria për përmirësimin administrativ në mbledhjen e saj. Efekt do të ushtrojë rritja e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, e vlerësuar në rreth 5.5 miliardë lekë shtesë për vitin e ardhshëm.

Të ardhurat nga taksa doganore

Për vitin 2014 parashikohet të mblidhen nga taksa doganore rreth 5.9 miliardë lekë, me një rritje prej 5.7 për qind krahasuar me buxhetin e rishikuar 2013. Pjesa më e madhe e efekteve negative të reduktimit të tarifave, për shkak të zbatimit të tarifave preferenciale nga reduktimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me vendet e rajonit (CEFTA), me Turqinë dhe me vendet e Bashkimit Evropian, janë ezauruar, edhe pse do të vijnë me ritme më të zbutura, kështu që ecuria e të ardhurave nga taksa doganore për vitin në vijim lidhet kryesisht me ecurinë e importeve të taksuara.

Të ardhurat nga fondet speciale

Të ardhurat nga fondet speciale për vitin 2014 parashikohen në rreth 63.8 miliardë lekë, me një rritje prej 6.5 për qind krahasuar me shifrën e buxhetit të rishikuar për vitin 2013. Prej këtyre, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të parashikuara për vitin 2014 janë në nivelin 62.5 miliardë lekë ose rreth 7 për qind më shumë se buxheti i rishikuar për vitin 2013, ndërsa rreth 1.6 miliardë lekë pritet të arkëtohen prej pagesave të legalizimit të pronave në fondin e të ardhurave për kompensimin në vlerë të pronarëve. Parashikimi i të ardhurave nga kontributet për vitin 2014 bazohet në parashikimet për rritjen e aktivitetit ekonomik, të punësimit, të nivelit të pagave, në uljen e vazhdueshme të informalitetit në tregun e punës dhe në efektin e pritshëm të heqjes së nivelit tavan për llogaritjen e kontributeve shëndetësore.

Të ardhurat nga pushteti vendor

Të ardhurat nga pushteti vendor për vitin 2014 pritet të arrijnë nivelin 10.7 miliardë lekë me një rritje prej 8.6 për qind ndaj buxhetit të rishikuar për vitin 2013, duke arritur nivelin 0.8 për qind të PBB-së. Parashikimi për këtë grup taksash është bazuar në parashikimin për rritjen ekonomike nominale, si dhe në përmirësimin e pritshëm administrativ në mbledhjen e të ardhurave, kryesisht lidhur me tatimet mbi pasurinë. Politikatat tatimore që prekin këtë grup taksash pritet të kenë një efekt buxhetor neto prej 300 milionë lekësh.

Të ardhurat jotatimore

Parashikimi i të ardhurave jotatimore për vitin 2014 është 21.1 miliardë lekë ose 12.3 për qind më pak se në buxhetin e rishikuar për vitin 2013. Këtu bie në sy një rënie e nivelit të fitimit që transferohet nga Banka e Shqipërisë në buxhetin e shtetit, e cila historikisht ka qenë në nivelin rreth 5 miliardë lekë dhe për vitin 2014 parashikohet në nivelin 1.5 miliardë lekë.

Të ardhurat nga ndihmat

Parashikimi i të ardhurave nga ndihmat për vitin 2014 është 8.5 miliardë lekë, bazuar në informacionet për projektet, të cilat pritet të financohen nga donatorët gjatë vitit 2014.

Të ardhurat e pritshme për tri vitet 2015 - 2017 janë bazuar në buxhetin e miratuar për vitin 2014, kuadrin makrofiskal 2015 - 2017 dhe metodologjinë tashmë standarde të kryerjes së këtyre parashikimeve, në katër indikatorët kryesorë:

1. Ndikimi i treguesve makroekonomikë;
2. Politikatat tatimore;
3. Përmirësimet administrative në mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore;
4. Elementet specifike sipas zërave të të ardhurave, sjellja, ndërvlerësia dhe korrelimi tipik i tyre me variablat ekonomikë.

Bazuar në buxhetin e miratuar për vitin 2014, si dhe kuadrin makroekonomik e fiskal të miratuar për periudhën 2015 - 2017, të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar për tri vitet 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet 390.8 miliardë lekë për vitin 2015; 426 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 467.1 miliardë lekë për vitin 2017, me rritje vjetore prej respektivisht 7.2%, 9% dhe 9.6%, ndërsa në raport me PBB-në të ardhurat do të jenë respektivisht 26% më 2015-ën, 26.5% në vitin 2016 dhe në nivelin prej 27.1% të PBB-së në vitin 2017.

Ecuria e të ardhurave nga tatimet dhe doganat si zëri kryesor i të ardhurave të buxhetit të shtetit, për periudhën 2015 - 2017 parashikohet që të ketë një rritje vjetore prej 9.4% në vitin 2015; 9.2% në vitin 2016 dhe një rritje prej 10% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 19%, 19.4% dhe 19.8% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Ecuria e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 129 miliardë lekë për vitin 2015; 141 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 155.4 miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 9% në vitin 2015; 9.3% në vitin 2016 dhe një rritje prej 10.1% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Mes të tjerave, për vitin 2015, në vlerësim janë përfshirë efektet e pritshme të politikave të vazhdueshme të shfuqizimit të përjashtimeve nga ky tatim që bien ndesh me legjislacionin komunitar. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 8.6%, 8.8% dhe 9% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Ecuria e të ardhurave nga tatimi mbi fitimin për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 24.7 miliardë lekë për vitin 2015; 26.9 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 28.7

miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 7.5% në vitin 2015; 8.7% në vitin 2016 dhe një rritje prej 6.8% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 1.6%, 1.7% dhe 1.7% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Ecuria e të ardhurave nga akcizat për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 53.2 miliardë lekë për vitin 2015; 59.5 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 68 miliardë lekë për vitin 2017, me një rritje vjetore prej 10% në vitin 2015; 11.9% në vitin 2016 dhe një rritje prej 14.4% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në vlerësimin e të ardhurave për këtë periudhë për akcizën, janë përfshirë efektet e rritjes së miratuar të akcizës mbi produktet e duhanit për tri vitet në fjalë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 3.5%, 3.7% dhe 3.9% të PBB-së për të tria vitet 2015-2017.

Ecuria e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 32 miliardë lekë për vitin 2015; 35 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 38.3 miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 12.2% në vitin 2015; 9.3% në vitin 2016 dhe një rritje prej 9.6% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 2.1%, 2.2% dhe 2.2% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Ecuria e të ardhurave nga taksat nacionale për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 39.5 miliardë lekë për vitin 2015; 41.6 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 44 miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 8.7% në vitin 2015; 5.2% në vitin 2016 dhe një rritje prej 6% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në, ato parashikohen të jenë në nivelin prej 2.6%, 2.6% dhe 2.6% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Ecuria e të ardhurave nga taksat doganore për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 6.4 miliardë lekë për vitin 2015; 7 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 7.6 miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 8.7% në vitin 2015; 9% në vitin 2016 dhe një rritje prej 9.3% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 0.4%, 0.4% dhe 0.4% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Ecuria e të ardhurave nga pushteti lokal për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 11.5 miliardë lekë për vitin 2015; 12.6 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 13.8 miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 7.9% në vitin 2015; 9.2% në vitin 2016 dhe një rritje prej 9.5% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 0.8%, 0.8% dhe 0.8% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Ecuria e të ardhurave nga fondet speciale për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 65.7 miliardë lekë për vitin 2015; 72.2 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 79.5 miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 2.9% në vitin 2015; 9.8% në vitin 2016 dhe një rritje prej 10.1% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 4.4%, 4.5% dhe 4.6% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Në tabelat e mëposhtme paraqiten projeksionet e të ardhurave të buxhetit të shtetit për periudhën afatmesme në vijim.

Tabelë: Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar
Në milionë lekë

Nr.	EMËRTIMI	2013	2014	2015	2016	2017
		Buxheti A.Normativ Dhjetor	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI I TË ARDHURAVE	325,918	364,704	390,824	426,062	467,116
I.	Ndihmat	7,880	8,500	7,500	7,600	7,700
II.	Të ardhura tatimore	293,910	335,038	362,124	395,762	435,418
II.1	Nga tatimet dhe doganat	224,105	260,517	284,880	311,013	342,170
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	109,092	118,382	129,008	141,069	155,359
1.1	Nga tatimet		26,251	29,323	32,249	35,777
1.2	Nga doganat		92,131	99,685	108,820	119,583
2	Tatimi mbi fitimin	15,016	23,007	24,739	26,884	28,704

3	Akcizat	37,349	48,365	53,215	59,539	68,085
3.1	Nga tatimet		0	0	0	0
3.2	Nga doganat		48,365	53,215	59,539	68,085
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	28,412	28,503	31,983	34,951	38,295
5	Taksa nacionale dhe të tjera	28,655	36,357	39,520	41,577	44,084
5.1	Nga tatimet		27,032	29,384	30,528	32,007
5.2	Nga doganat		9,325	10,137	11,049	12,076
6	Taksa doganore	5,582	5,903	6,415	6,993	7,643
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	9,827	10,673	11,519	12,582	13,781
1	Taksa lokale	5,616	5,931	6,388	6,962	7,610
2	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	2,407	3,542	3,815	4,158	4,545
3	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël	1,803	1,200	1,316	1,461	1,626
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	59,979	63,848	65,725	72,167	79,466
1	Sigurimi shoqëror	51,069	53,929	55,547	61,101	67,395
2	Sigurimi shëndetësor	7,310	8,619	8,878	9,766	10,772
3	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,600	1,300	1,300	1,300	1,300
III.	Të ardhura jotatimore	24,128	21,166	21,200	22,700	23,998
1	Transferimi fitimi nga Banka e Shqipërisë	5,200	1,500	2,000	2,800	3,200
2	Të ardhura nga institucionet buxhetore	11,728	13,366	13,767	14,180	14,605
2.1	Të ardhura nga sistemi i arsimit të lartë	3,000	3,500	3,800	4,000	4,200
2.2	Të ardhura jotatimore të pushtetit vendor	2,300	2,500	2,600	2,700	2,800
2.3	Të tjera të ardhura nga inst. buxh. për qev. qendrore	6,428				
3	Dividenti	1,500	600	600	600	600
4	Tarifat shërbimeve	2,900	2,900	2,987	3,077	3,169
5	Të tjera	2,800	2,800	1,846	2,043	2,424
5.1	Shitja e H.Dajtit/Hidro Lana-Bregasit	0				
5.2	Shitja e licencave 3G	0				
5.3	Jashtë limitit	1,400	1,700	1,760	1,820	1,880
5.4	Të tjera (të rastësishme)	1,400				

Burimi: Ministria e Financave

Ecuria e të ardhurave jotatimore për periudhën 2015 - 2017 në vlerë janë parashikuar përkatësisht në nivelet: 21.2 miliardë lekë për vitin 2015; 22.7 miliardë lekë për vitin 2016 dhe 24 miliardë lekë për vitin 2017 me një rritje vjetore prej 0.2% në vitin 2015; 7.1% në vitin 2016 dhe një rritje prej 5.7% në vitin 2017 kundrejt një viti më parë. Në raport me PBB-në ato parashikohen të jenë në nivelin prej 1.4%, 1.4% dhe 1.4% të PBB-së për të tria vitet 2015 - 2017.

Tabelë: Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar ne% të PBB-së

Nr.	EMËRTIMI	2013	2014	2015	2016	2017
		Buxheti A.Normativ Dhjetor	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	24.0	25.7	26.0	26.5	27.1
I.	Ndihmat	0.6	0.6	0.5	0.5	0.4
II.	Të ardhura tatimore	21.6	23.6	24.1	24.6	25.2
II.1	Nga tatimet dhe doganat	16.5	18.4	19.0	19.4	19.8
1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	8.0	8.3	8.6	8.8	9.0
1.1	Nga tatimet	0.0	1.9	2.0	2.0	2.1
1.2	Nga doganat	0.0	6.5	6.6	6.8	6.9
2	Tatimi mbi fitimin	1.1	1.6	1.6	1.7	1.7
3	Akcizat	2.8	3.4	3.5	3.7	3.9
3.1	Nga tatimet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
3.2	Nga doganat	0.0	3.4	3.5	3.7	3.9
4	Tatimi mbi të ardhurat personale	2.1	2.0	2.1	2.2	2.2
5	Taksa nacionale dhe të tjera	2.1	2.6	2.6	2.6	2.6
5.1	Nga tatimet	0.0	1.9	2.0	1.9	1.9

5.2	Nga doganat	0.0	0.7	0.7	0.7	0.7
6	Taksa doganore	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	0.7	0.8	0.8	0.8	0.8
1	Taksa lokale	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
2	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3
3	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	4.4	4.5	4.4	4.5	4.6
1	Sigurimi shoqëror	3.8	3.8	3.7	3.8	3.9
2	Sigurimi shëndetësor	0.5	0.6	0.6	0.6	0.6
3	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Të ardhura jotatimore	1.8	1.5	1.4	1.4	1.4
1	Transferimi fitimi nga Banka e Shqipërisë	0.4	0.1	0.1	0.2	0.2
2	Të ardhura nga institucionet buxhetore	0.9	0.9	0.9	0.9	0.8
2.1	Të ardhura nga sistemi i arsimit të lartë	0.2	0.2	0.3	0.2	0.2
2.2	Të ardhura jotatimore të pushtetit vendor	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
2.3	Të tjera të ardhura nga inst. buxh. për qev. qendrore	0.5	0.0	0.0	0.0	0.0
3	Dividenti	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Tarifat shërbimeve	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
5	Të tjera	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1
5.1	Shitja e h. dajtit/hidro Lana-Bregasit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
5.2	Shitja e licencave 3 g	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
5.3	Jashtë limitit	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
5.4	Të tjera (të rastësishme)	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0

Burimi: Ministria e Financave

Paketa e re fiskale

Paketa fiskale e vitit 2014 solli ndryshime të rëndësishme në politikën e taksave si për taksimin indirekt, ashtu dhe për tatimet e drejtpërdrejta. Efekti i ndryshimeve në tatime vlerësohet të jetë rreth 21 miliardë lekë shtesë në buxhetin e vitit 2014.

Tatimi mbi vlerën e shtuar

Barnat dhe sistemi shëndetësor. Përfshihen nga TVSH-ja furnizimi i barnave dhe i shërbimeve shëndetësore, me efekt nga data 1 prill 2014, nga 10% që aplikohet aktualisht për këto furnizime. Në vijim të politikave në mbështetje të sektorit të shëndetësisë, ky ndryshim synon reduktimin e koston për përdoruesit e sistemit të shërbimit shëndetësor dhe barnave.

Politika e përjashtimit të shërbimeve shëndetësore është në përputhje me direktivën e KE-së, 2006/112/CE të Këshillit, datë 28 nëntor 2006, mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar, neni 132 DE 2006/112 CE “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes publik”. Ndërsa për barnat, vendeve anëtare u jepet e drejta e aplikimit të normës së reduktuar, përveç asaj normale. Përputhshmëria është e pjesshme.

Hidrokarburet. Shfuqizohet përjashtimi nga TVSH-ja në import për mallrat e importuara për fazat e zhvillimit dhe për furnizimet e brendshme që kontraktorët dhe nënkontraktorët bëjnë me njëri-tjetrin në fazën e zhvillimit. Bëhet fjalë për një nga lehtësirat fiskale në favor të sektorit hidrokarbur, të akorduara ndër vite me synim stimulimin e zhvillimit të këtij sektori në Shqipëri. Ky përjashtim nuk është në përputhje me direktivën e BE-së për hidrokarburet dhe ka krijuar hapësira për abuzime.

Rimbursimi i TVSH-së. Ndryshon mënyra aktuale e pagesës së tepricës kreditore të TVSH-së së rimbursueshme të tatimpaguesit, duke kaluar nga administrata tatimore, që është aktualisht, në sistemin e thesarit, si dhe zgjatet afati i kontrollit dhe aprovimit të tepricës kreditore nga 30 ditë, që është aktualisht, në 60 ditë. Ky ndryshim synon:

- Eliminimin e diskrecionit të administratës tatimore në dhënien e rimbursimeve të TVSH-së;
- Sigurimin e zbatimit të parimit kryesor të pagesës së TVSH-së të rimbursueshme “first in, first out”;

- Uljen e rasteve korruptive për plotësimin e kërkesave për rimbursim.

Zgjatja e afatit të kontrollit dhe aprovimit të tepricës kreditore nga 30 ditë, që është aktualisht, në

60 ditë, synon dhënien më shumë kohë administratës tatimore në kontrollin e kërkesave të tatimpaguesve për tepricën kreditore të TVSH-së. Ulja e pragut të TVSH-së nga 8 milionë lekë në vit në 5 milionë lekë në vit, në vitin 2010, solli rritjen e numrit të tatimpaguesve subjekt i TVSH-së, duke rritur kështu numrin e kërkesave për tepricë kreditore të TVSH-së. Administrata tatimore shpeshherë ka qenë në pamundësi të respektimit të afatit ligjor prej 30 ditësh në kontrollin e këtyre kërkesave.

Akciza

Produktet e duhanit. Rritet akciza e cigareve, e përshkallëzuar në vite, sipas progresivitet të mëposhtëm:

4500 lekë/1000 copë, më 1 janar 2014;

5500 lekë/1000 copë, më 1 janar 2015;

5500 lekë/1000 copë, më 1 janar 2016;

6000 lekë/1000 copë, më 1 janar 2017.

Sipas direktivës së BE-së, niveli minimal i akcizës së cigareve duhet të jetë 57% e çmimit të shitjes me pakicë. Niveli i akcizës në Shqipëri, përpara këtij ndryshimi ka qenë në nivelin 34% të çmimit të shitjes me pakicë.

Rritja progresive në vite adreson një kërkesë të vazhdueshme të operatorëve ekonomikë të këtij sektori për të pasur një kalendar ligjor të rritjes së akcizës së cigareve me qëllim për planet e tyre të biznesit. Më poshtë paraqitet masa e akcizës si përqindje ndaj çmimit për katër vitet e ardhshme. Ky ndryshim është në përputhje me *acquis*.

Tabelë: Akciza për katër vitet e ardhshme

Viti	Akciza si% ndaj çmimit të cigares
2014	36.1%
2015	38.3%
2016	40.6%
2017	42.1%

Burimi: Ministria e Financave

Është rritur akciza për duhanin me të dredhur në 3,000 lekë për kg nga 1,500 lekë për kg që ka qenë deri në fund të vitit 2013, me rritje të mëtejshme vjetore me 700 lekë për 3 vitet në vijim. Bëhet fjalë për një produkt me trend rritës të konsumit, si me origjinë importi, ashtu edhe prodhimi vendas. Tashmë tregtimi i duhanit me të dredhur është më i kontrollueshëm, pas vendosjes së detyrimit të pajisjes me pullë akcize. Nga ana tjetër, ka një diferencë shumë të lartë (të pajustificuar) midis akcizës që paguan ky produkt dhe akcizës së cigareve.

Pijet alkoolike. Rritet akciza për pijet alkoolike (jo birra) në 5200 lekë e akcizës për vera spumante, shampanja dhe pijet e fermentuara dhe të gazuara (W300) dhe për pijet alkoolike të ndërmjetme (I000) nga 2600 lekë që ishte një vit më parë. Nivelet e akcizës së këtyre kategorive kanë qenë të ulëta dhe rritja e tyre është bërë në koherencë me nivelin e akcizës së pijeve të tjera alkoolike.

Birra. Deri në fund të vitit 2013, taksimi i birrës në Shqipëri ka pasur një strukturë të bazuar në 4 pragje (nivele prodhimi) dhe 4 norma të ndryshme taksimi, si më poshtë.

Tabelë: Taksimi i birrës deri në vitin 2013

Birrë e bërë nga malto	
nga prodhues vendas e të huaj me sasi deri në 70 000 hektolitër në vit	1000 lekë/HL për birrat me forcë alkoolike deri në 6 për qind dhe 1200 lek forcë alkoolike mbi 6 për qind
nga prodhues vendas e të huaj me sasi nga 70 001 deri 200 000 HL në vit	1200 lekë/HL për birrat me forcë alkoolike deri në 6 për qind dhe 1440 lek forcë alkoolike mbi 6 për qind
nga prodhues vendas e të huaj me sasi nga 200 001 deri në 300 000 HL në vit	1500 lekë/HL për birrat me forcë alkoolike deri në 6 për qind dhe 1800 lek forcë alkoolike mbi 6 për qind
nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të madhe se 300 000 hektolitra në vit	3000 lekë/HL për birrat me forcë alkoolike deri në 6 për qind dhe 3600 lek forcë alkoolike mbi 6 për qind

Burimi: Ministria e Financave

Taksimi i ri i akcizës së birrës ka ndryshuar si vijon:

- nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të vogël se 200,000 HL në vit, 360 lekë/HL/gradë alkool;

- nga prodhues vendas e të huaj me sasi më të madhe se 200 000 HL në vit, 710 lekë/HL/gradë alkool.

Ristruktimi i akcizës së birrës është bërë në bazë të nenit 4 të direktivës të Këshillit Evropian, bazuar në dy kritere bazë:

- aplikimi i një pragu të vetëm prodhimi, si prag ndarës i nivelit të taksimit, për sasi prodhimi më të mëdha se 200,000 HL në vit;

- niveli i akcizës të jetë i shprehur sipas direktivës, në lekë/HL/gradë alkool;

- tarifa e reduktuar (360 lekë/HL/gradë alkooli) të mos jetë më e vogël se gjysma e tarifës bazë.

Produkte të reja me akcizë. Shtohet lista e produkteve me akcizë, me dy produkte të reja, graso me 40 lekë/kg dhe “pije energjike” me 50 lekë/litri.

Shfuqizim i disa përjashtimeve. Nga data 1 prill 2014, hiqet përjashtimi nga akciza i karburanteve të importuara për nevojat e veta nga kompanitë hidrokarbure. Arsyet e heqjes së këtij përjashtimi, që ka aktualisht sektori hidrokarbur, janë pjesë e paketës fiskale të vitit 2014 për heqjen e disa nga lehtësirave tatimore që gëzon ky sektor. Në bazë të të dhënave të administratës tatimore dhe doganore, kjo lehtësi fiskale është përdorur me abuzivizëm nga shoqëritë hidrokarbure, duke importuar lëndë djegëse pa taksa dhe duke i shitur në treg. Heqja e këtij përjashtimi është në përputhje me *acquis*.

Tatimi mbi të ardhurat personale

Nga data 1 janar 2014, tatimi mbi të ardhurat personale mbi pagën është tatim progresiv, me këto norma tatimore:

Tabelë: Norma progresive e TAP-it

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		Përqindje
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	30.000	zero për qind
30.001	130.000	+ 13 për qind të shumës mbi 30.000 lekë
130.001	Më tepër	13.000 lekë + 23 për qind të shumës mbi 130.000 lekë

Burimi: Ministria e Financave

Tatimi mbi të ardhurat nga pagat reformohet, duke zëvendësuar taksimin e sheshtë me një shkallë unike dhe me një prag përjashtimi me taksimin progresiv. Formula e propozuar për zëvendësimin e taksës së sheshtë me tatim progresiv, mban në konsideratë programin e qeverisë që vetëm 5% e të punësuarve në vend do të taten më shumë. Taksimi progresiv konsiston në:

- Sistemin e pandryshuar të taksimit të të punësuarve me pagë deri në 30 mijë lekë në muaj; ata mbeten të përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale;

- Paga 30 mijë lekë/muaji shërben si prag i parë i tatimit progresiv;

- Pragu i dytë i prezantuar në formulë është paga mujore prej 130 mijë lekësh. Të punësuarit në Shqipëri, të cilët deklarojnë pagë mbi 130 mijë lekë/muaj, përbëjnë rreth 3% të totalit të të punësuarve.

Tatimi mbi fitimin

Nga data 1 janar 2014, tatimi mbi fitimin është 15%. Norma e tatimit mbi fitimin rritet 15% nga 10% që ishte më parë. Ky ndryshim është në koherencë me formulën e taksimit progresiv në Shqipëri dhe me logjikën që individi që fiton më shumë, paguan më shumë taksa. Rritja e normës në 15% është në koherencë me normën efektive të tatimit progresiv mbi pagën. Politika tatimore që përfshin tatimin mbi të ardhurat e kompanive do të shoqërohet me masa administrative, me qëllim që të përmirësohet administrimi i subjekteve të tatimit mbi fitimin, për minimizimin e evazionit fiskal.

Kështu, së shpejti, menaxhimi i tatimpaguesve të mëdhenj do të bëhet nga kompani të veçanta auditimi, të cilat do të përllogarisin detyrimet tatimore në emër të tyre. Kjo masë synon, ndër të tjera, eliminimin e praktikës disavjeçare në Shqipëri të bizneseve shqiptare, të cilat mbajnë dy bilance, një për shtetin për të paguar taksa dhe një për vete me fitimin e tyre real tregtar.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e bizneseve të vogla

Është vendosur heqja e taksës së biznesit të vogël, si tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël. Këto dy tatime, të cilat biznesi i vogël i paguante respektivisht te njësitë e qeverisjes vendore dhe administrata tatimore qendrore, zëvendësohen me një tatim të vetëm – tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe norma tatimore është 7.5%, ndërsa për subjektet me qarkullim nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit, është vendosur një taksë fikse prej 25,000 lekësh në vit.

Aktualisht, në Shqipëri zhvillojnë aktivitetet si subjekte të biznesit të vogël rreth 60 mijë tatimpagues. Nga pikëpamja fiskale, pagesa e taksës së mëparshme të bashkitë dhe komunat dhe më pas kreditimi i saj në administratën qendrore tatimore, në funksion të tatimit të të ardhurave personale, ka rezultuar në rritje të abuzivizmit dhe nënraportimeve, duke e bërë tatimin mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël një tatim josolid në sistemin fiskal. Për këtë arsye, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në normën prej 7.5% të fitimit të tatueshëm (diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura fiskalisht) do ta konsolidojë këtë taksë, duke e pastruar nga kreditimi i taksës së biznesit të vogël, si dhe i ofron lehtësi tatimore kësaj kategorie. Nga ana e administrimit, kjo taksë do të jetë taksë vendore, por do të mbliidhet nga administrata tatimore qendrore për llogari të administratës lokale.

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2014

Bazuar në nivelin e të ardhurave buxhetore dhe në nivelin e burimeve të financimit të deficitit, shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2014, sipas ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, parashikohen në masën 456.4 miliardë lekë, ose 32.7 për qind e PBB-së.

Shpenzimet e personelit. Shpenzimet e personelit janë parashikuar në masën 74 miliardë lekë për vitin 2014 ose 5.3 për qind e PBB-së. Në këtë zë të shpenzimeve përfshihet:

- Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore në masën rreth 71.7 miliardë lekë për 86.288 punonjës buxhetorë. Ky fond është parashikuar duke marrë në konsideratë koston aktuale të pagave të punonjësve të administratës publike, si dhe shtrirjen në nivel vjetor të rritjes së miratuar në gusht 2013. Ky fond përmban, gjithashtu, edhe një kosto shtesë që vjen nga eliminimi i kufirit të sipërm të pagës për efekt të pagesës së kontributeve shëndetësore, me një efekt rreth 150 milionë lekë. Gjithashtu, në këtë fond janë parashikuar disa politika specifike sektoriale;

- Zbatimi i politikës së rritjes së pagave të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të ligjit përkatës (janar 2014), me një efekt prej 200 milionë lekësh;

- Zgjerimi i administratës së sistemit gjyqësor për funksionimin e gjykatës administrative, për të cilën është parashikuar një fond prej 60 milionë lekësh për një staf të shtuar prej 40 punonjësish;

- Buxheti 2014 nuk përmban fond për rritje të përgjithshme pagash në administratën publike. Gjithsesi, në këtë buxhet është parashikuar një fond prej 1 miliard lekësh për rritjen e pagave të Policisë së Shtetit, mbështetje kjo kundrejt një sektori tejet prioritar në kushtet aktuale, ku rendi dhe siguria janë nga elementet më thelbësore dhe njëkohësisht parakusht për rritjen ekonomike.

- Fondi i veçantë i parashikuar në masën 2 për qind të fondit të pagave, i cili do të përdoret kryesisht për ndihma të menjëhershme.

Në shpenzimet e mësipërme të personelit nuk janë marrë në konsideratë reduktimet që janë bërë në administratën publike, pasi ky është një proces në zhvillim e sipër. Rrjedhimisht, fondet që do të kursehen në përfundim të këtij procesi, do të përdoren pjesërisht për të përballuar kompensimet financiare të punonjësve që reduktohen. Pra, efektet financiare të këtij reduktimi do të ndihen në buxhet në vitin 2015.

Shpenzimet për pagesën e interesit. Shpenzimet për interesa janë bazuar në fluksin e huamarrjes së brendshme dhe të huaj, si dhe në nivelin e parashikuar të normës së interesit. Për pasojë, shpenzimet për këtë zë parashikohen në nivelin rreth 3.3 për qind të PBB-së, nga 3.2 për qind të regjistruar në aktin normativ 2013.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes. Këto shpenzime për vitin 2014 parashikohen në nivelin 35.3 miliardë lekë ose 2.5 për qind e PBB-së, nga rreth 32.2 miliardë lekë që ishin në aktin normativ 2013. Ato do të vazhdojnë të orientohen drejt rritjes së shpenzimeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sektorëve prioritarë, të tillë si: arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura. Kjo, përmes aplikimit të normave të diferencuara të rritjes së shpenzimeve për këta sektorë.

Shpenzimet për pushtetin vendor. Këto shpenzime për vitin 2014 parashikohen në nivelin 33.1 miliardë lekë ose 2.4 për qind e PBB-së, me një rritje prej afro 4.6 miliardë lekë, krahasuar me aktin normativ 2013.

Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë. Shpenzimet për në dhe PAK për vitin 2014 parashikohen në nivelin 19 miliardë lekë ose 1.4 për qind e PBB-së, e njëjtë me aktin normativ 2013. Në këtë parashikim është mbajtur parasysh politika e rritjes së diferencuar të komponentëve të këtyre shpenzimeve. Pjesa më e madhe e rritjes do të shkojë për PAK, si pasojë e indeksimit të pagesës, rritjes së numrit të përfituesve dhe përmirësimit të procedurave për përfitimin e këtij statusi. Ndërkohë që, si rezultat i përmirësimeve ligjore dhe administrative, fondi i NE-së do të reduktohet (në terma relativë). Nga ana tjetër, kompensimi për ish-të përndjekurit politikë parashikohet në masën 1.8 miliardë lekë, fond ky që do të shërbejë pjesërisht për pagesën e kështit të dytë të dëmshpërblimit, që ka nisur që prej vitit 2013. Specifikisht, për vitin 2014, është parashikuar Fondi i Kompensimit për Ushqimin, Energjinë etj. në masën 1.1 miliardë lekë, si kompensim financiar për shtresat e varfra të shoqërisë, me qëllim lehtësimin e barrës nga rritja e TVSH-së.

Fondi rezervë dhe kontigjenca. Për vitin 2014 ky zë parashikohet në masën 4.5 miliardë lekë. Ai ndahet përkatësisht në fondin rezervë të KM-së prej 1.5 miliardë lekësh dhe në fondin kontigjencë për ruajtjen e deficitit në masën 3 miliardë lekë.

Shpenzimet kapitale. Për vitin 2014 ato parashikohen në masën 67.3 miliardë lekë, ose 4.8 për qind e PBB-së. Më konkretisht, investimet me financim të brendshëm rreth 28.7 miliardë lekë, të cilat parashikohet të përdoren kryesisht për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e TVSH-së dhe kostos lokale për projektet e huaja, si edhe për një pjesë të projekteve të brendshme në vazhdim. Në këtë kontekst, në përputhje me programin e qeverisë, do të vazhdohet t'u jepet precedencë atyre projekteve të cilësuar si prioritare dhe strategjike për zhvillimin e vendit dhe të rajonit, duke u orientuar drejt sektorëve të tillë prioritarë, si: arsimi, shëndetësia, bujqësia, infrastruktura dhe zhvillimi rural. Ndërkohë, investimet me financim të huaj parashikohen rreth 38.6 miliardë lekë ose 2.8 për qind e PBB-së.

Detyrimet e prapambetura. Së fundi, është vlerësuar se një nga dobësitë e sistemit të menaxhimit financiar publik është krijimi i detyrimeve të prapambetura. Për këtë qëllim, Ministria e Financave ka ndjekur një proces intensiv të evidentimit, vlerësimit dhe auditimit të tyre. Si rezultat, kemi një raport të plotë të kompanisë "Deloitte" për detyrimet e prapambetura të buxhetit të shtetit ndaj biznesit privat vendas dhe të huaj për punime e shërbime publike, e cila kap vlerën 24.6 miliardë lekë. Sipas këtij raporti, rreth 65 për qind të këtij detyrimi apo në vlerën rreth 16 miliardë lekë, buxheti i shtetit u detyrohet projekteve të infrastrukturës, 17 për qind të tij e ka ndaj kompanive të farmaceutikës dhe pajisjeve mjekësore, 8.42 për qind ndaj ndërtimit të shkollave. Ndërkohë që, deri tani nga administrata tatimore është evidentuar dhe kontrolluar një detyrim në masën 22.8 miliardë lekë për zërat që kërkojnë rimbursim të TVSH-së, si dhe tatimitit. Një pjesë e këtyre detyrimeve, në masën 35 miliardë lekë janë përfshirë në buxhetin e shtetit për vitin 2014, duke u përcaktuar edhe burimi i financimit të tyre. Ndërkohë që procedurat dhe kriteret e shlyerjes së detyrimeve, si dhe pagesa e pjesës së mbetur (brenda një periudhe 3-

vjeçare), përcaktohen në draftstrategjinë “Për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, e cila parashikohet të miratohet nga Këshilli i Ministrave brenda muajit janar 2014.

Deficiti buxhetor. Duke marrë në konsideratë edhe paragrafin e mësipërm, deficiti buxhetor për vitin 2014 parashikohet në nivelin 6.6 për qind e PBB-së. Ai do të financohet në mënyrë të balancuar nga burimet e brendshme dhe të huaja, në masën 3.3 për qind të PBB-së.

Programimi buxhetor afatmesëm (2015 - 2017)

Vlerësimet e mëposhtme bazohen në kuadrin makroekonomik dhe fiskal, miratuar në janar 2014. Kështu, në fund të vitit 2017, shpenzimet e përgjithshme buxhetore parashikohet të arrijnë nivelin 489.9 miliardë lekë ose 28.4 për qind të PBB-së. Burimet do të përdoren kryesisht për:

- reduktimin e ndjeshëm të deficitit buxhetor në nivelin 1.3 për qind të PBB-së;
- rritjen e diferencuar të pensioneve;
- mbajtjen e një ritmi të qëndrueshëm të investimeve publike, në masën në 5.1 për qind të PBB-së.

Shpenzimet për personelin

Shpenzimet e personelit për periudhën 2015 - 2017 parashikohen të jenë në përputhje me politikën e re të qeverisë për reduktimin gradual të numrit të punonjësve të administratës publike. Kështu, në fund të kësaj periudhe 3-vjeçare, ato do të reduktohen në nivelin 4.4 për qind të PBB-së.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për periudhën 2015 - 2017 parashikohen të mbahen në nivelin konstant rreth 2.4 për qind të PBB-së. Ato do të orientohen drejt rritjes së shpenzimeve për funksionimin dhe mirëmbajtjen, duke synuar uljen në maksimum të shpenzimeve të pastra administrative, në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare.

Shpenzimet për subvencionet

Shpenzimet për subvencionet janë parashikuar bazuar në politikën ekzistuese të subvencioneve dhe mbi politikat e uljes së tyre të mëtejshme. Në mbështetje të rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare për një ulje të subvencioneve, të gjitha institucioneve u është kërkuar të ndërmarrin reforma për një menaxhim më të mirë të sektorëve përkatës dhe të përmirësimit të performancës së tyre financiare. Në periudhën 2015 - 2017, ato parashikohen të ruajnë nivelin 0.1 për qind të PBB-së.

Shpenzimet për pagesën e paaftësisë dhe ndihmën ekonomike

Gjatë të gjithë periudhës 2015 - 2017, shpenzimet për pagesën e paaftësisë dhe ndihmën ekonomike parashikohen të reduktohen lehtë në nivelin rreth 1.2 për qind të PBB-së. Kjo, kryesisht si rezultat i përmirësimeve të parashikuara në drejtim të aspektit ligjor dhe administrativ të këtyre skemave.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave

Niveli i fondit rezervë të Këshillit të Ministrave për vitin 2015 parashikohet të jetë në masën 1.5 miliardë lekë, ndërkohë që ai parashikohet të ulet gjatë dy viteve pasardhëse, në nivelin 1 miliardë lekë.

Shpenzimet për interesat

Parashikimi i shpenzimeve të interesave është bazuar në strategjinë e borxhit të Ministrisë së Financave dhe nivelet e parashikuara për financimin e brendshëm dhe të huaj për të. Për periudhën 2015 - 2017, këto shpenzime parashikohen të ruajnë nivelin mesatar rreth 3.5 për qind të PBB-së.

Shpenzimet për buxhetin lokal

Shpenzimet për buxhetin lokal për periudhën 2015 - 2017 parashikohet të reduktohen në nivelin 1.9 për qind e PBB-së, deri në fund të vitit 2017.

Shpenzimet kapitale

Shpenzimet kapitale për periudhën 2015 - 2017 parashikohen të ruajnë nivelin 5.1 për qind të PBB-së. Në priorizimin e listës së investimeve do të vazhdojnë të përzgjidhen ato të cilat janë vazhdim i projekteve të mëparshme, si edhe investimet që cilësohen strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, në përputhje edhe me programin e qeverisë dhe strategjitë sektoriale.

Detyrimet e prapambetura

Bazuar në strategjinë e re “Për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, e cila parashikohet të miratohet brenda muajit janar 2014, niveli i detyrimeve të prapambetura i parashikuar për t’u shlyer është përkatësisht 20.1 miliardë lekë më 2015-ën dhe 17.5 miliardë lekë në 2016.

3.4 Niveli i borxhit publik dhe zhvillimet e tij

Zhvillimi i borxhit publik dhe perspektivat e tij në periudhën afatmesme 2014 - 2016

Ecuria e stokut të borxhit publik

Në fund të dhjetorit të vitit 2013, borxhi publik i qeverisë qendrore vlerësohet të jetë 883,849 milionë ALL ose 65.08% i PBB-së, duke u rritur kështu me 305 pikë bazë krahasuar me fundin e vitit 2012. Realisht stoku i borxhit në raport me PBB-në e vitit të kaluar është rritur me 4.21%, ndërkohë që ulja prej 1.57% është shkaktuar prej rritjes ekonomike të vitit 2013. Borxhi i brendshëm gjatë vitit 2013 është rritur me 288 pikë përqindje si rezultat i nevojave të politikave për financimin e deficitit buxhetor, ndërkohë që borxhi i jashtëm ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel si rezultat i pakësimit të disbursimeve gjatë gjashtëmuajt të dytë të vitit 2013.

Duke marrë në konsideratë detyrimet e prapambetura në shumën 72.6 miliardë lekë, gjendja e stokut të borxhit publik vlerësohet në rreth 70.43% në raport me PBB-në.

Tabelë:

Të dhënat e borxhit publik për vitin 2013

*në milionë ALL	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Stoku i borxhit + detyrimet	595,883	682,546	715,371	772,517	827,981	956,449
Stoku i borxhit	595,883	682,546	715,371	772,517	827,981	883,849
Stoku i borxhit të brendshëm	400,456	415,028	407,372	438,582	470,358	520,786
Stoku i borxhit të jashtëm	195,427	267,518	307,999	333,935	357,622	363,063
Detyrimet e prapambetura	0	0	0	0	0	72,600
PBB	1,089,293	1,148,082	1,222,462	1,282,255	1,326,000	1,358,000
Borxhi+detyrimet/PBB	54.70%	59.45%	58.52%	60.25%	62.44%	70.43%
Borxhi/PBB	54.70%	59.45%	58.52%	60.25%	62.44%	65.08%
Borxhi i brendshëm/PBB	36.76%	36.15%	33.32%	34.20%	35.47%	38.35%
Borxhi i jashtëm/PBB	17.94%	23.30%	25.19%	26.04%	26.97%	26.74%

Burimi: Ministria e Financave

Analiza e huamarrjes

Viti 2013 ka qenë një vit mjaft dinamik për sa u përket zhvillimeve të borxhit publik të Shqipërisë dhe, gjithashtu, një sfidë për tregun e brendshëm të letrave me vlerë për sa i përket financimit me sukses të një deficitit buxhetor relativisht të lartë.

Huamarrja e brendshme për vitin 2013 u realizua në nivelin e 46.2 miliardë lekësh dhe theksohet se ky financim ishte tërësisht me instrumente afatgjata. Sipas vlerësimeve më të fundit, 109.9% e financimit është kryer me instrumente afatgjata, duke maturuar edhe instrumentet afatshkurtra në shumën prej 4.6 miliardë lekësh.

Ky financim ka mundësuar përmirësimin e ndjeshëm të treguesve të borxhit të brendshëm, si edhe të përmirësojë profilin e maturimeve. Numri i ditëve në maturim vlerësohet në 560 ditë krahasuar me 386 ditë në fund të vitit 2012, duke ulur ekspozimin ndaj riskut të refinancimit.

Gjatë vitit 2013 vlen të përmendet diversifikimi i instrumenteve dhe i burimeve të financimit. Për herë të parë është realizuar me sukses emetimi i obligacioneve 10-vjeçare (në shumën 8.2 miliardë lekë) dhe 2-vjeçare në euro.

Viti 2013 ka qenë një vit mjaft i favorshëm për sa i përket diversifikimit të mbajtësve të borxhit, ku vihet re rënia e peshës specifike të Raiffeisen Bank në nivelin 22.5% krahasuar me 29.4% një vit më parë. Ndërkohë, janë rritur peshat specifike të bankave të tjera në nivelin 40% krahasuar me 37.45% të një viti më parë dhe institucioneve financiare jobanka në nivelin 12.6% krahasuar me 6%.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013 janë ulur ndjeshëm normat e interesit si rezultat i likuiditetit të tepërt në sektorin bankar, ngurtësimit të kredive ndaj sektorit privat dhe për shkak të uljes së normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë.

Si rezultat, kostoja e borxhit është ulur dhe niveli i *yield*-it mesatar të ponderuar ka arritur 6,72% në fund të vitit 2013, duke u ulur me 110 pikë bazë krahasuar me një vit më parë.


Për sa i përket borxhit të jashtëm, gjatë vitit 2013 janë disbursuar rreth 179 milionë euro, ku pjesa më e madhe është realizuar në sektorët e transportit (71.38%), energjetikës (11.04%) dhe ujësjellës-kanalizimeve (9.16%).

Në dhjetor të vitit 2013, stoku i borxhit të jashtëm vlerësohet të jetë (*vlerësim paraprak) rreth 2,589 milionë euro, nga të cilat 224 milionë euro i përkasin borxhit të garantuar. Ndërkohë që vlerësimet për borxhin e nënshkruar, por të padisbursuar arrijnë 725.5 milionë euro dhe pritet të disbursohet sipas marrëveshjeve me kreditorët në vitet në vazhdim.

- Ashtu si edhe në vitet e mëparshme portofoli i borxhit të jashtëm vazhdon të ruaj trendin e kompozimit nga tri monedha kryesore (EURO, USD, YEN), ku peshën kryesore e mban monedha euro. Përqindja e lartë e stokut të borxhit në euro bën që portofoli të jetë më i ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit në një periudhë afatshkurtër.

Grafik:

*Borxhi i jashtëm sipas monedhave



Burimi: Ministria e Financave

Shërbimi i borxhit publik

Tabelë:

*Shërbimi i borxhit publik

Në milionë ALL	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shërbimi i borxhit gjithsej (I+II)	35,555	42,061	48,116	48,734	52,166	56,109
I. Interesa	31,307	36,301	41,604	41,121	41,497	43,335
I brendshëm	28,386	31,408	35,583	34,253	34,005	35,890
I huaj	2,921	4,893	6,021	6,868	7,492	7,445
II. Ripagesat	4,248	5,760	6,512	7,613	10,669	12,774
PBB	1,089,293	1,148,082	1,222,462	1,282,255	1,326,000	1,358,000
Interesa/PBB	2.87%	3.16%	3.40%	3.21%	3.13%	3.19%
Interesa, borxh i brendshëm/PBB	2.61%	2.74%	2.91%	2.67%	2.56%	2.64%
Interesa, borxh i jashtëm/PBB	0.27%	0.43%	0.49%	0.54%	0.57%	0.55%


Ripagesat/PBB	0.39%	0.50%	0.53%	0.59%	0.80%	0.94%
---------------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

Burimi: Ministria e Financave

Gjatë vitit 2013 shërbimi i borxhit të brendshëm ka pësuar një rritje prej 8 pikë përqindje krahasuar me vitin 2012. Kjo për arsye të rritjes së deficitit buxhetor pavarësisht normave të ulëta të interesit. Ndërkohë, për sa i përket shërbimit të borxhit të jashtëm, rritja e tij është e lidhur me kushtet e huazimit të fondeve me terma koncesionalë.

Grafik:

*Borxhi i jashtëm sipas koncesionalitetit



Burimi: Ministria e Financave

Perspektivat e borxhit në periudhën afatmesme 2014 - 2016

Nga analiza e portofolit të borxhit vihet re se ky portofol ka një risk të lartë. Kjo për arsye se huamarrja e brendshme afatshkurtër vazhdon të përbëjë një pjesë të konsiderueshme të portofolit, e cila kërkon rifinancim në një kohë relativisht të shkurtër dhe nga ana tjetër huamarrja në monedhë të huaj, e cila është rritur, karakterizohet nga risku i kursit të këmbimit. Ripagesat e borxhit të jashtëm rriten në nivele të konsiderueshme në vitin 2014 e më pas vazhdon një trend rritës 1,4%-1,6% ndaj PBB-së duke kërkuar të përdoret një pjesë e madhe e balancës buxhetore për këtë qëllim. Në këtë mënyrë, vlerësimet e riskut tregojnë rëndësinë e reduktimit të borxhit, përndryshe efektet negative financiare do të jenë të mëdha duke shkaktuar pagesa të larta të shërbimit të borxhit. Në vitin 2015 është maturimi i eurobondit dhe ripagesat arrijnë në nivelin 4,5% të PBB-së. Strategjia e menaxhimit të borxhit ka vlerësuar përsëritjen e këtij instrumenti dhe daljen në tregun ndërkombëtar për të siguruar financimin e nevojshëm dhe duke shfrytëzuar oportunitetin e këtij tregu.

Për sa i përket vitit 2014 e në vijim, analistët e kredisë parashikojnë interesa më të larta në USA dhe UK, ndërsa në zonën euro perspektiva e rritjes ekonomike është pozitive, por përsëri presioni mbi inflacionin nuk është i konsiderueshëm. Procesi *deleverage* i bankave evropiane do të vazhdojë gjatë 2014-ës dhe së bashku me reformat e tjera institucionale të BE-së përbëjnë një risk të mundshëm për likuiditetin dhe nivelin e ofertës së kredisë.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2014 - 2015 duhet të merret parasysh se parashikimet mund të ndryshojnë dhe janë fleksibël si funksion i zhvillimeve të ndryshme makroekonomike dhe strukturore. Zhvillimet e ekonomisë evropiane përcillen nëpërmjet sistemit tonë bankar dhe ndikimet e tyre janë të dukshme për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në tregun e brendshëm.

Përveç zhvillimeve pozitive të tregut të brendshëm në segmentin e titujve qeveritarë duhet mbajtur parasysh fakti i kujdesit të bankave ndaj ekspozimit në titujt afatgjatë dhe politika e tyre nga bankat mëma, shoqëruar me vlerësimet e riskut. Ndërkohë fondet e investimeve janë ende të pazhvilluara dhe qëndrueshmëria e tyre është e lidhur me zhvillimet në të gjithë ekonominë qofshin strukturore apo

institucionale.

Nga kjo pikëpamje financimi i deficitit me instrumente afatgjata përbën një sfidë që do të vijojë përgjatë vitit 2014 dhe për këtë arsye përveç strategjisë bazë është përgatitur edhe një strategji rezervë, e cila merr parasysh përdorimin e instrumenteve afatshkurtra, si edhe efektet dhe ndikimin e tyre në portofolin e borxhit dhe menaxhimin e tij.

Në një këndvështrim më të gjerë, implikimet janë në rritjen e niveleve të interesave të kërkuara për instrumentet financiare dhe do të kërkojë masa të shpejta për të siguruar nevojat e refinancimit.

Strategjia bazë

Strategjia bazë e menaxhimit të borxhit bazohet në vlerësimin e kostove të pritshme dhe karakteristikat e riskut të tyre të huamarrjes.

1. Në tregun e brendshëm kjo strategji synon sigurimin e huamarrjes së re me instrumente afatgjata, ndërkohë që realizon dhe ripërsëritjen e borxhit me instrumentet ekzistuese.

2. Huamarrja e huaj bazohet në financimet e pritshme të projekteve duke u plotësuar me sigurimin e financimit nga jashtë në përputhje me marrëveshjet e FMN-së dhe të Bankës Botërore për sa i përket shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.


Kalendari bazë i huamarrjes së brendshme për vitin 2014 bazohet: i) në emetime të reja prej 45,8 miliardë lekësh, të cilat synohet të realizohen me obligacione afatgjata; dhe ii) maturimet ekzistuese, të cilat janë rreth 374 miliardë lekë të ndara përkatësisht në bono thesari 304 miliardë lekë dhe obligacione 70 miliardë lekë që vijnë me ripërsëritjen e tyre.

Bazuar në këtë strategji financimi me instrumente afatgjata, në fund të vitit 2014 stoku i borxhit të brendshëm parashikohet të jetë rreth 546.7 miliardë lekë dhe raporti ndërmjet instrumenteve afatshkurtra dhe afatgjata do të jetë 44.8% me 52.2% në favor të instrumenteve afatgjata. Duke vijuar me të njëjtën strategji financimi edhe në vitet 2015 - 2016, parashikohet që raportet ndërmjet instrumenteve të borxhit të thellohen duke arritur 41.5% me 58.5% në favor të instrumenteve afatgjata në fund të vitit 2016.

- Më poshtë paraqiten grafikisht profilet e shlyerjes së borxhit të brendshëm.

Grafik:

*Krahasimi i profileve të maturimit në fund të çdo viti për periudhën 2013 - 2015 (në terma absolutë).



Burimi: Ministria e Financave


Në terma absolutë, si rezultat i një deficiti buxhetor të vazhdueshëm, profili i borxhit gjatë periudhës 2014 - 2015 shfaq vlera të larta të maturimeve në intervalet 314-324 miliardë lekë, duke pasqyruar një risk të lartë të përsëritjes së borxhit (rreth 22% të PBB-së).

Ndërkohë, si rezultat i menaxhimit të portofolit të borxhit dhe i rritjes së vazhdueshme të

instrumenteve afatgjata në këtë portofol kemi përmirësime në tregues relativë për sa i përket profilin të maturimeve, gjë të cilën e tregon dhe grafiku i mëposhtëm.

Grafik:

*Krahasimi i profileve të maturimit në fund të çdo viti për periudhën 2013 - 2015 (në terma relativë).



Burimi: Ministria e Financave

Në bazë të profilin të maturimeve të vitit 2014, instrumentet që maturohen brenda një viti janë rreth 56.47% krahasuar me 62.85% në vitin 2013.

- Ditët mesatare në maturim parashikohen 620-670 ditë në fund të vitit 2014, dhe pritet të ulen deri në 570-620 ditë në fundin e vitit 2016.

- Shërbimi i borxhit të brendshëm për vitin 2014 është vlerësuar rreth 36 miliardë lekë, përfshirë garancitë. Vetëm për instrumentet e borxhit të brendshëm shpenzimet për interesa janë ulur me rreth 2 miliardë lekë si rezultat i efektit në ulje të interesave dhe në veçanti të bonove të thesarit të emetuara në vitin e mëparshëm.

Ndërkohë që për vitin 2015 shërbimi i borxhit parashikohet të rritet ndjeshëm, duke kapur nivelin e 41.3 miliardë lekësh për arsye të supozimit të rritjes graduale të normave të interesit. Në nivele të larta parashikohet shërbimi i borxhit edhe për vitin 2016, duke u vlerësuar me rreth 45.4 miliardë lekë.

Strategjia konservatore

Në kushtet e mungesës së likuiditetit në treg dhe të vështirësive të sigurimit të instrumenteve afatgjata, strategjia e huamarrjes së re do të mbështetet në instrumente afatshkurtra dhe afatgjata në raportin 50% me 50%, duke bërë që treguesit të përkeqësohen ndjeshëm krahasuar me strategjinë bazë.

- Raporti ndërmjet instrumenteve afatshkurtra dhe atyre afatgjata në fund të vitit 2014 vlerësohet të jetë 49% me 51% dhe mbetet në të njëjtat nivele edhe për vitet 2015 – 2016, duke pasur diferenca të theksuara me strategjinë bazë ku përmirësimet e këtij raporti janë dukshëm në favor të instrumenteve afatgjata me 8%.

- Financimi i deficitit me këtë strategji do të kishte një impakt negativ edhe mbi jetëgjatësinë mesatare të portofolit për arsye se ditët mesatare në maturim vlerësohen në rreth 540-590 ditë për vitin 2014 dhe në vitet në vijim ulen deri në nivelin e 500 ditëve, duke e rritur në këtë mënyrë ekspozimin ndaj riskut të refinancimit, ndaj riskut të normave të interesit dhe duke përkeqësuar profilin e shlyerjes.

- Shërbimi i borxhit vlerësohet të rritet për arsye të përqendrimit në instrumente afatshkurtra dhe presionit të krijuar në treg në kushtet e përsëritjes së një borxhi të lartë me këto lloj instrumentesh. Më konkretisht, gjatë vitit 2014 shërbimi është pothuajse në të njëjtat nivele me strategjinë e bazuar në instrumente afatgjata, ndërkohë që vjen duke u rritur për vitin 2015 me 1.4 miliardë lekë dhe për vitin

2016 me 0.4 miliardë lekë. Nga pikëpamja e kostos dhe e riskut në vizion afatmesëm, kjo strategji është më e kushtueshme dhe në të njëjtën kohë mbart risqe, të cilat mund të dëmtonin qëndrueshmërinë e portofolit të borxhit.

Në këtë aspekt, vlerësojmë se: i) risku i rifinancimit të një stoku të borxhit prej 370 miliardë lekësh, i cili maturohet gjatë vitit 2014; ii) shtesa e deficitit buxhetor; si edhe iii) volatiliteti i normave të interesit që mbart kjo strategji janë tregues tepër sensitivë, të cilët mund të rrezikojnë shlyerjen e borxhit. Prandaj sa më sipër, ne rekomandojmë strategjinë bazë me instrumente afatgjata në mbështetje të deficitit buxhetor dhe zhvillimit të tregut.

- Një tjetër risk potencial i borxhit publik gjatë viteve të ardhshme është edhe risku i kursit të këmbimit, ndaj të cilit borxhi publik dhe në veçanti borxhi i jashtëm është i ekspozuar për vetë faktin e përbërjes së portofolit të tij.

Një luhatje në kursin e këmbimit EUR/ALL do të jepte ndikim mbi rritjen e nivelit të borxhit.

Sipas skenarit bazë, supozojmë që kursi i këmbimit EUR/ALL do të jetë sa kursi mesatar i tri viteve të fundit plus 4 devijime standarde për vitin 2014 (142.16) dhe plus 5 devijime standarde për vitin 2015 (142.64) e në vijim. Bazuar në supozimet e mësipërme, themi se stoku i borxhit në raport me PBB-në nën ndikimin e efektit të kursit të këmbimit rritet deri në 27 pikë bazë për vitin 2014 (3.8 miliardë lekë) dhe deri në 35 pikë bazë për vitet në vijim (5.6 miliardë lekë).

Objektivat e strategjisë:

- Sigurimi i huamarrjes së re për financimin e brendshëm me instrumente afatgjata;
- Ditët mesatare në maturim vlerësohen në marzhin 620-670 ditë;
- Sigurimi i financimit të huaj nëpërmjet realizimit të projekteve të zhvillimit të lidhura me kreditorët dhe plotësuar me financimin e FMN-së dhe Bankës Botërore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Implikimet buxhetore të “reformave kryesore strukturore”:

- Që prej muajit shtator 2013, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 474, datë 16.6.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike ndërmorën rishikimin e të gjitha strukturave organizative të ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore. Qëllimi i kësaj reforme ishte për ta bërë administratën publike më eficiente dhe efektive duke ridimensionuar çdo element të hierarkisë organizative dhe duke eliminuar postet dhe funksionet që dalin të tepërta. Më konkretisht për ecurinë e kësaj reforme, referojuni seksionit 3.3 më sipër.

- Skema e ndihmës ekonomike (siç përmendet në seksionin 3.3 më sipër), do të jetë subjekt i një reforme ligjore dhe administrative, e cila synon reduktimin e nivelit të “gabimeve”, forcimin e mekanizmave të alokimit të fondeve dhe përzgjedhjes së përfituesve, dhënies së incentivave për të investuar në kapitalin njerëzor përmes ofrimit të një pagese sociale shtesë të lidhur me regjistrimin dhe frekuentimin në shkollë për familjet që kanë fëmijë në moshë shkollore; krijimin e një regjistri të unifikuar të përfituesve nga programet e asistencës sociale dhe ndryshimit të formulave të indeksimit për programin e pagesave të paaftësisë.

- Duke nisur nga viti 2010, me qëllim nxitjen e zhvillimit në nivel lokal dhe rajonal, politikat buxhetore qendrore janë harmonizuar me ato vendore. Kjo, duke pasur parasysh se zhvillimi ekonomik i komunave, bashkive dhe qarqeve nuk është një problem lokalisht i izoluar, por përkundrazi ai lidhet ngushtë me zhvillimin ekonomik mbarëkombëtar. Në këtë kontekst, lindi nevoja e integritetit në nivel rajonal të politikave sektoriale të qeverisjes qendrore. Për këtë qëllim, politikat buxhetore u orientuan drejt “Zhvillimit të rajoneve”, gjë që për vetë qarqet shërben si një ushtrim paraprak për përmirësimin e aftësive të tyre, në drejtim të aplikimit për financime dhe investime strukturore nga BE-ja. Ky fond është pjesë e buxhetit të shtetit për vitin 2014, në funksion, gjithashtu, të promovimit të reformës për ndarjen e re territoriale.

3.5 Qëndrueshmëria e financave publike


Ecuria e treguesve të performancës financiare të sistemit të pensioneve

Për sa i përket qëndrueshmërisë financiare të sistemit dhe ndikimit të tij në buxhetet familjare, me

interes është shqyrtimi i ecurisë në vite i disa treguesve analitikë të sistemit, si: norma e varësisë, shkalla e mbulimit, norma e zëvendësimit etj.

Përfitimet nga pensionet janë rritur me ritme të shpejta falë politikave të qeverisë për rikuperimin e efekteve gërryese të inflacionit, përmirësimit të jetës së pensionistëve, dhe reduktimit të varfërisë. Politikat e pensioneve kanë synuar një rritje më të lartë për pensionet e ulëta, si dhe barazimin e pensioneve të fshatit me ato të qytetit, për të gjithë ata fermerë që kanë kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore nga viti 1994 dhe në vazhdim. Krahas indeksimit të përvitshëm të pensioneve, nga qeveria janë zbatuar edhe politikat e rritjes së të ardhurave për pensionistët me të ardhura minimale nëpërmjet vendosjes së një kompensimi të financuar nga buxheti i shtetit. Pensioni minimal dhe të ardhurat minimale në qytet dhe në fshat, të krahasuara me rritjen e indeksit mesatar të çmimeve për vitet 2001-2012 jepen në grafikët e mëposhtëm:

Grafik: Rritja e pensionit minimal dhe e të ardhurave minimale 2001 - 2012



Burimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Shkalla e mbulimit, që shpreh raportin e numrit të kontribuesve ndaj forcave të punës, rezulton me rënie përkatësisht në periudhën 2012 - 2014. Ky tregues dëshmon për evazionin kontributiv në skemën e sigurimeve shoqërore, i cili vazhdon të jetë një problem shqetësues.

Norma e varësisë, që shpreh raportin e përfituesve ndaj kontribuesve të skemës së sigurimeve shoqërore, është 1.2 për vitin 2012. Ndonëse herë pas here ka përmirësime përsëri duhet pranuar se ende sistemi i sigurimeve shoqërore nuk ka arritur të dalë nga niveli kritik.

Norma e zëvendësimit, e cila shpreh raportin midis pensionit dhe pagës, për vitin 2012 për pensionet urbane arriti 36.5%, ndërsa për pensionet rurale 41.6%. Duke llogaritur këtë raport me të ardhurat e pensionistëve, norma e zëvendësimit përkatësisht për pensionet urbane është 40.7% dhe për pensionet rurale 45%.

Megjithëse një sërë treguesish të sistemit evidentohen mjaft të përmirësuar, tashmë që gjendemi në vitin kur reforma e rritjes graduale të moshës së daljes në pension ka përfunduar, përsëri konstatohet një deficit i lartë i degës së pensioneve, i cili arrin në 1.52% të PBB-së dhe me tendencë përkeqësimi.

Të ardhurat nga kontributet

Një ndër prioritetet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore ka qenë dhe mbetet realizimi i të ardhurave në fushën e kontributeve dhe rritja e numrit të kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore.

Realizimi i të ardhurave në fondin e sigurimeve shoqërore, për vitin 2014 është programuar për sigurimet shoqërore të detyrueshme dhe suplementare, me 3,326,500 milionë lekë.

Për sektorin e të vetëpunësuarve në bujqësi

Të ardhurat e programuara nga pagesat e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi për vitin 2014 janë 2,786,000 milionë lekë.

Në skemën e sigurimit shoqëror në zonat rurale, gjatë vitit 2013, janë vënë re disa fenomene negative, të cilat influencuan në mosrealizimin e të ardhurave të programuara të këtij viti, si:

- personat me moshë të re, në zonat rurale, janë më pak të interesuar për sigurimin e tyre;
- të gjithë ata që kanë plotësuar 35 vjet vjetërsi në punë nuk po e vazhdojnë sigurimin e tyre.

Për sektorin e sigurimit vullnetar

Të ardhurat e programuara nga pagesat e kontributeve të personave të siguruar vullnetarisht, për vitin 2014 janë programuar 410,500 milionë lekë.

Gjatë vitit 2013, në funksion të sigurimit vullnetar, është bërë një publicitet i vazhdueshëm, si brenda ashtu dhe jashtë vendit, veçanërisht për emigrantët në Itali. Në këtë kuadër, ka vazhduar bashkëpunimi me disa Patronate në Itali, si: "INAS CISL", "ACAI", "ACLI", "ENAS-UGL", në drejtim të përfshirjes së emigrantëve shqiptarë në skemën e sigurimit vullnetar dhe konfirmimin e periudhave kontributive.

Sistemi i sigurimeve shëndetësore

Shpenzimet e skemës për shërbimet shëndetësore zënë rreth 2.4% të PBB-së. Për një qëndrueshmëri financiare prioritet ka sigurimi i të ardhurave të skemës që vijnë nga kontributet dhe buxheti i shtetit.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore zënë sot 0.54% të PBB-së, ndërsa për vitin 2014 janë parashikuar në masën 0.62%. Kjo rritje do të jetë rezultat i zbatimit të ligjit të ri për FSDKSH-në, në të cilin është parashikuar që masa e kontributeve të aplikohet mbi pagën bruto. Kjo do të ndikojë në vendosjen e një sistemi progresiv të pagesës së kontributeve. Heqja e taveve për kontribute të sigurimeve shëndetësore, ka ndikim më shumë për punonjësit me rroga të larta. Vendosja e kësaj takse bëhet në zbatim të parimit të solidaritetit për të përmirësuar shërbimin shëndetësor.

Nga prilli 2014, 73 mijë të vetëpunësuar në Shqipëri do të paguajnë më pak kontribute shëndetësore. Ata do të paguajnë kontributet shëndetësore në masën 3.4% të dyfishit të pagës minimale, nga 7% e pagës minimale që paguajnë aktualisht, ndërsa për të punësuarit do të hiqet taveni i llogaritjes së kontributeve shëndetësore me pesëfishin e pagës minimale. Të punësuarit do të paguajnë 1.7% të pagës nominale. Nga kjo masë buxheti i shtetit përfiton 900 milionë lekë, kurse nga heqja e TVSH-së për barnat 10% efekti parashikohet 1 milion lekë.

Të ardhurat nga kontributet për vitin 2014 parashikohen 8 619 000 mijë lekë me një rritje prej 16.3% krahasuar me faktin 2012. Kjo rritje parashikohet të sjellë një ulje të kontributit të buxhetit të shtetit për popullsinë joaktive, i cili parashikohet në 8 625 000 mijë lekë, ose 8% më pak krahasuar me programimin 2012.

Në sigurimin e qëndrueshëm të të ardhurave të skemës, e rëndësishme është pagesa e kontributeve, shmangia e evazionit, si edhe ulja e papunësisë në vend. Po ashtu edhe shmangia e pagesave nën dorë duke i formalizuar ato në formën e bashkëpagesave do të jetë burim tjetër të ardhurash për fondin.

3.6 Cilësia e financave publike dhe karakteristikat institucionale

Forcimi dhe institucionalizimi i marrëdhënieve ndërqeveritare fiskale

Reforma e decentralizimit fiskal ka pasur efekte pozitive, në rritjen e të ardhurave vendore në përgjithësi, si dhe në rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat kundrejt transfertës së pakushtëzuar në buxhetin e shtetit. Reforma e decentralizimit në përgjithësi dhe e decentralizimit fiskal në veçanti, ka ndryshuar dukshëm strukturën e burimeve të të ardhurave të pushtetit vendor. Në vitin 2002, që është viti i fundit i skemës së vjetër të financimit të pushtetit vendor, kjo strukturë ishte 76 me 24 për qind në favor të burimeve që vinin nga buxheti i shtetit. Pas këtij viti, me prezantimin e një pakete fiskale për rritjen e autonomisë fiskale të pushtetit vendor, kjo strukturë ka pësuar ndryshime të mëdha. Të ardhurat që financonin pushtetin vendor për ushtrimin e funksioneve të veta, u siguruan në masën mbi 50 për qind nga taksat dhe tarifatat vendore. Edhe buxheti i vitit 2014 ka për qëllim për të mbajtur këtë tendencë, në favor të rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. Autonomia financiare e pushtetit vendor është rritur ndjeshëm nga viti në vit, duke pasur parasysh se në vitin 1996 pushteti vendor ka pasur të drejtë të vendosë për vetëm 1 për qind të buxhetit të tij, ndërsa në vitin 2014 kjo autonomi do të jetë mbi 75 për qind.

Në vitin 2014, tatimi mbi biznesin e vogël do të hiqet si taksë vendore, por efektet e saj në buxhetin vendor do të kompensohen përmes tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe transfertës së pakushtëzuar. Në kuadër të decentralizimit dhe fuqizimit të autonomisë financiare të pushtetit vendor, niveli i taksës së ndërtesave që përdoren për aktivitete biznesi, është rritur. Në vitin 2014, kjo mënyrë do të rrisë të ardhurat vendore në 1.1 miliardë lekë më shumë se ato të vitit 2013. Nga

përvoja e deritanishme mund të thuhet se transferta e pakushtëzuar është rritur nga viti në vit. Ndërkohë që në shumë vende të rajonit dhe më gjerë, nën ndikimin e krizës ekonomike, janë zvogëluar fondet për pushtetin vendor në vitin 2014, vërehet një hap cilësor në lidhje me rritjen e madhësisë së transfertës së pakushtëzuar në krahasim me vitin 2013. Përcaktimi i madhësisë së transfertës së pakushtëzuar mbështetet në: funksionet që i janë transferuar njësive të qeverisjes vendore, si dhe në volumin e taksave dhe tarifave vendore. Objektivi i qeverisë për vitin 2014 është vazhdimi i konsolidimit dhe rritjes së të ardhurave vendore për të garantuar qëndrueshmërinë e reformës së decentralizimit, përshpejtimi i procesit të reformës së decentralizimit në fushat kyçe. Një problem i rëndësishëm i decentralizimit është reforma e ndarjes së re territoriale, si edhe përmirësimi i performancës në menaxhimin e aseteve vendore si një mjet i rëndësishëm për të rritur të ardhurat dhe rritjen e investimeve për infrastrukturën lokale. Transferimi i aseteve në pronësi të pushtetit vendor, ofron mundësi të mëdha për të rritur të ardhurat, me anë të përdorimit të tyre nga ana e pushtetit vendor, apo nga palët e treta, si dhe përmes kolateralit të zmadhuar për të marrë kredi për financimin e investimeve publike. Nëpërmjet përdorimit të mekanizmave financiarë për shpërndarjen e subvencioneve, do të ndikohet rritja e performancës e të menaxhimit të aksioneve të përbashkëta, furnizimit me ujë dhe kanalizimeve sipas njësive të qeverisjes vendore. Reforma e decentralizimit fiskal do të përqendrohet në qartësimin e marrëdhënieve fiskale ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Kjo do të realizohet nëpërmjet bërjes së ligjit për financat vendore, i cili: do të përcaktojë procedurat e zbatimit të buxhetit vendor, skemën e financimit të transfertave të pakushtëzuara për qeveritë vendore, do të mundësojë rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë. Gjatë vitit 2014, qeveria do të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me donatorët për të ndihmuar pushtetin vendor në drejtim të decentralizimit fiskal dhe modernizimin e financave vendore.

Fondet vendore: Në bazë të ligjit nr. 9869, datë 4.2.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”, njësitë e qeverisjes vendore kanë filluar për të aplikuar dhe për të marrë kredi. Me këtë ligj, qeveria është përgjegjëse për:

- koordinimin e politikave të borxhit kombëtar dhe vendor (në mënyrë të tillë që qeveria qendrore të ruajë kontrollin e natyrës dhe zgjerimin e detyrimeve fiskale vendore);
- sigurimin e një huamarrje vendore të kujdesshme (në drejtim të administrimit të rrezikut, në kontekstin e financave publike);
- sistemin e garancive për huamarrjen vendore;
- monitorimin dhe mekanizmat e kontrollit.

Në mënyrë që të konsolidohen financat publike gjatë vitit 2014 dhe në vazhdim, përpjekjet e qeverisë do të fokusohen në identifikimin e problemeve në lidhje me nevojën për një kuadër rregullator për financat vendore, e cila do të synojë të përcaktojë procedurën për hartimin dhe zbatimin e skemës së financimit të transfertës së pakushtëzuar për buxhetin vendor, çështje të kontabilitetit, si dhe të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke ndihmuar njësitë vendore që duan të marrë hua, transparenca etj. Ky proces do të jetë subjekt i diskutimeve me grupe të ndryshme interesi.

Zhvillimet në fushën e harmonizimit financiar

Aktivitete gjatë vitit 2013

- Hartimi i akteve nënligjore në plotësim të kuadrit ligjor për MFK-në, si për shembull:
- urdhri i ministrit të Financave nr. 5759, datë 10.4.2013 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike”;
- urdhri i ministrit të Financave nr. 33, datë 11.7.2013 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”;
- udhëzimi i ministrit të Financave, datë 24 dhjetor 2014 “Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2013”.

- Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pranë Ministrisë së Financave, u fokusua në implementimin e projektit pilot “Mbështetje për Ministrinë e Financave të Shqipërisë për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të fondeve publike” të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARSH).

- U përgatit dhe u paraqit në Këshillin e Ministrave dhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit brenda muajit maj 2013 “Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik

në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2012”.

- Caktimi i nëpunësve autorizues dhe zbatues në njësitë e qeverisjes së përgjithshme sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2012 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” është monitoruar në vazhdimësi nga NJQH/MFK-ja.

- Në kuadër të implementimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe akteve të tjera të nxjerra në zbatim të tij, NJQH/MFK-ja organizoi seminare informuese dhe trajnuese me titullarët dhe menaxherët e tjerë të njërive të qeverisjes vendore.

Aktivitetet për periudhën në vazhdim (viti 2014) do të konsistojnë në:

- Fillimin e projektit të binjakëzimit 2-vjeçar për “Implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe inspektimit financiar publik në Shqipëri”;

- Rishikimin e bazës ligjore të financave publike;

- Seminare ndërgjegjësimi në vazhdimësi;

- Monitorimi i caktimit të nëpunësve zbatues në vazhdimësi (drejtuesit e financës);

- Trajnime dhe seminare për menaxherët, drejtuesit e financës dhe specialistët në lidhje me menaxhimin e riskut dhe gjurmët e auditit në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike.

Zhvillimet në fushën e menaxhimit të thesarit

Pritshmëritë e ardhshme të thesarit janë:

- Fuqizimi i procesit të parashikimit të parasë dhe të menaxhimit të likuiditetit;

- Përmirësimi i përgjithshëm i disponueshmërisë, cilësisë, integritetit dhe besueshmërisë së informacionit mbi të ardhurat e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme, i nevojshëm për kryerjen e parashikimeve të parasë dhe analiza të trendit, që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të një procesi modern të parashikimit të mjeteve monetare;

- Përmirësimi i përgjithshëm i transparencës, rëndësisë, cilësisë dhe afateve kohore të ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar duke regjistruar transaksionet në burim;

- Nxitja e një shkallë më të lartë të zbatimit të kontroleve të brendshme mbi të ardhurat publike dhe shpenzimet, në të gjithë spektrin e ministrive të linjës, njësive shpenzuese, bashkive, komunave dhe organeve të tjera lokale publike administrative (institucione buxhetore);

- Konsolidimi i të gjitha arkëtimit të të ardhurave në Bankën Qendrore. Fuqizimi i menaxhimit të shpenzimeve publike, duke përfshirë kontrollin e menaxhimit të kontratave shumëvjeçare për vitet e ardhshme në sistemin informativ financiar të qeverisë;

- Marrja e masave për të parandaluar krijimin e detyrimeve të papaguara gjatë procesit të ekzekutimit të buxhetit.

Avantazhet nga perspektiva e menaxhimit të financave publike:

- Mundësi për të përmirësuar flukset e punës dhe ato procedurale;

- Forcimi dhe integrimi i menaxhimit të financave publike;

- Optimizimi i mëtejshëm i proceseve të mbledhjes dhe i administrimit të të ardhurave nga qeveria shqiptare;

- Angazhim më i madh i burimeve njerëzore për të forcuar mbikëqyrjen e ekzekutimit të buxhetit;

- Ripërcakton rolin e thesarit, nga mbajtës i kontabilitetit në kryeadministrator të procesit të ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar;

- Lidhja e fortë me iniciativa të tjera kyçe të qeverisë, si për shembull, kontrolli financiar i investimeve publike;

- Më shumë instrumente për vlerësimin e performancës në lidhje me procesin e ekzekutimit të buxhetit.

Zhvillimet institucionale dhe reformat strukturore të ndërmarra në administratën doganore

- Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet administratës doganore shqiptare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Taksave Indirekte të Francës, në fushën e asistencës së ndërsjellë për çështjet doganore.

- Është realizuar shkëmbimi i informacionit me vendet fqinje përmes Sistemit të Shkëmbimit Elektronik Sistematik të të Dhënave (SEED), faza II.

Gjatë tremujorit të parë 2013 janë nënshkruar një sërë marrëveshesh ndërinstitucionale:

- Memorandum bashkëpunimi nr. 390 prot., datë 10.1.2013 “Për autorizimin e lëshimit të dokumentit doganor ndërkombëtar ATA dhe mbi zbatimin e dispozitave të Konventës për Lejimin e Përkohshëm, bërë në Stamboll më 26 qershor 1990” ndërmjet Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- Memorandum mirëkuptimi nr. 1150/2 prot., datë 4.2.2013 “Për shkëmbim informacioni” ndërmjet Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- Me suportin e UNDOC-it, në bashkëpunim me Policinë është realizuar ngritja e një zyre/ekipi të përbashkët për kontrollin e kontejnerëve në Portin e Durrësit, për të cilën është bërë dhe një ceremoni inaugurimi në shkurt të 2013-ës.

- Është në proces zhvillimi një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike (ANEA) me objektiv ngritjen e një skeme reagimi kombëtar ndaj alarmeve të radioaktivitetit në PKK dhe blerjen e pajisjeve detektuese fikse dhe portable. Në këtë projekt dogana bashkëpunon edhe me Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi, Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Policinë e Kufirit etj.

- Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave, është organizuar një seminar i përbashkët mbi bashkëpunimin e institucioneve të zbatimit të ligjit (Tiranë, 11-12 mars 2013).

- Është implementuar Moduli i Pagesave Elektronike në Sistemin Asycuda World.

- Administrata Doganore Shqiptare është pjesë e grupit ndërinstitucional të punës, në kuadër të iniciativës së CBRN-së, Centres of Excellences, për uljen e risqeve dhe kërcënimeve që lidhen me pajisjet dhe materialet kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare”. Përfshirja e doganës në iniciativën e CBRN-së, financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga UNICRI-ja dhe JRC-ja, lidhet me objektivat strategjike të PKZMSA-së për Doganën, që kanë të bëjnë me përmirësimin e rolit të saj mbrojtës dhe të sigurisë, si dhe me thellimin e bashkëpunimit institucional për këtë qëllim. Në këtë kuadër ka një angazhim, shkëmbim dhe bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera të përfshira, të tilla si: Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Mjedisit, METE, Ministria e Shëndetësisë, Agjencia Kombëtare Bërthamore etj.

- Projekti i binjakëzimit “Mbështetje për administratën doganore shqiptare” (AL2011/IB/FI/01)

- Në kuadër të projektit të binjakëzimit “Mbështetje për administratën doganore shqiptare” (AL2011/IB/FI/01), i cili ka për qëllim të ndihmojë doganat shqiptare, në përputhje me *acquis* të BE-së, konkretisht:

- Të përmirësojë performancën e ADSH-së me rritjen e kapaciteteve në analizën dhe menaxhimin e riskut, në bashkëpunim të ngushtë me DARM (Drejtoria e Analizës së Riskut dhe Monitorimit);

- Përmirësimi i kapaciteteve për zbatimin efikas të kontrollit të paszhdoganimit, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Kontrollit të Paszhdoganimit;

- Zhvillimi i kapaciteteve për zbatimin efikas IPR, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale;

- Përafrimi i plotë i laboratorit doganor me praktikat dhe standardet më të mira të BE-së, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Laboratorit Doganor;

- Si rrjedhojë, rezultatet për t’u arritur janë implimentimi i modeleve më të mira menaxhuese dhe operacionale në sektorët doganorë të përmendur më lart sipas Blueprinteve të BE-së dhe standardet e sigurisë të OBD-së; rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore; shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit dhe i njohurive, në të gjithë sektorët përfshi dhe laboratorin, për të përmirësuar standardet operative dhe zbatimin e politikave që synojnë arritjen e një cilësie më të lartë të shërbimeve dhe procedurave doganore.

- Me qëllim lehtësimin e tregtisë/tranzitit Shqipëri-Kosovë është në proces negociimi draftmarrëveshja “Mbi bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke për kryerjen e procedurave të përbashkëta doganore në portet detare të Republikës së Shqipërisë”.

- Gjatë periudhës shtator - nëntor 2013 është bashkëpunuar me Policinë e Shtetit bazuar në dokumentet ligjore ekzistuese dhe marrëveshjet e përbashkëta. Grupi ndërinstitucional i punës për draftimin e strategjisë për menaxhimin e integruar të kufijve ka filluar punën dhe takimi i parë është mbajtur më 14.11.2013.

4. Objektivat e reformave strukturore

4.1 Pengesat për rritjen ekonomike dhe agjenda e reformave strukturore

- Pozicioni aktual i financave publike përbën një pengesë për arritjen e një rritje ekonomike në potencial e të qëndrueshme në kohë. Nga njëra anë niveli i lartë i borxhit publik zbeh besueshmërinë e agjentëve ekonomikë për një stabilitet të qëndrueshëm ekonomik, ndërsa nga ana tjetër nevoja imediate për t'u angazhuar në një konsolidim fiskal ushtron presione mbi rritjen afatshkurtër të ekonomisë, e cila tashmë është tejte e dobët.

- Niveli i lartë i kredive me probleme, i akumuluar në portofolat e sistemit bankar, i agravuar në një masë të konsiderueshme edhe prej stokut të akumuluar të detyrimeve të prapambetura të qeverisë ndaj sektorit privat, vijon të jetë një prej pengesave më të mëdha sa i takon ngërçit në ndërmjetësimin financiar të kapitaleve në mënyrë eficiente dhe efektive midis agjentëve të ndryshëm të ekonomisë. Si rrjedhojë, kreditimi për ekonominë, tashmë i kontraktuar, mban ekonominë ndjeshëm nën potencialin e saj.

- Nevoja për konsolidimin e financave publike dhe njëkohësisht shlyerja sa më e shpejtë e detyrimeve të prapambetura të akumuluar të qeverisë ndaj sektorit privat do të jetë një prej prioritetëve të qeverisë shqiptare gjatë tri viteve në vijim. Materializimi i këtij prioriteti do të ndihmohet nëpërmjet angazhimit në një program stabilizimi me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

- Tregu i punës në Shqipëri është thellësisht i dëmtuar nga një informalitet i theksuar në të gjithë sektorët, sidomos në bujqësi, ndërtim dhe shërbime. Ky problem do të adresohet nëpërmjet masave të marra për reduktimin e ekonomisë informate, si rritja e inspektimeve nga Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP), rritja e kontroleve nga Njësia Task-Forcë e hetimit tatimor dhe nga rritja e përdorimit të pajisjeve fiskale.

- Ndryshime të shpeshta të kuadrit ligjor dhe të paketave fiskale sjellin çorientim dhe hezitim për investime nga ana e biznesit. Një nga problematikat e ngritura edhe nga shoqatat e transportit ishte ai i ndalimit për një kohë të gjatë në dogana. Për këtë arsye do të adaptohet direktiva evropiane "On cross-border mergers".

- Problem i mprehtë për biznesin e vogël e të mesëm ka qenë ai i mungesës së kredidhënies për shkak të stepjes së sektorit bankar. Ky limit ngadalëson investimet e reja dhe shpeshherë edhe vetë aktivitetin e zakonshëm të ndërmarrjeve. Plani trevjeçar synon shfrytëzimin e plotë të skemës së financimit të SME-ve bashkë me qeverinë italiane. Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) do të jetë një nga kreditorët e ndërmarrjeve të vogla në sektorin financiar. Fondi i "ekonomisë kreative" do të jetë në dispozicion të sektorit të artizanatit.

- Probleme të tjera burojnë nga një histori shumëvjeçare arbitrariteti nga administrata tatimore dhe nga një informatizim i ulët. Mungesa e koordinimit të administratës publike në raport me biznesin dhe mospërdorimi i një serveri qendror detyron një biznes të përmbushë tri herë të njëjtin dokumentacion për tatimet, ISSH-ja dhe drejtoritë në vartësi të ministrive të linjës, kosto, të cilat mund të eliminohen nëpërmjet një koordinimi më të mirë dhe një sistemi informatik më efektiv.

- Sistemi i drejtësisë është i ngadaltë dhe perceptohet si i korruptuar. Shpeshherë jepen vendime haptazi antiligjore, si për shembull, dhënia e së drejtës kredimarrësit që nuk shlyen borxhin. Veç efekteve të tjera ky element inkurajon edhe rritjen e kredive me probleme. Hapja e Gjykatës Administrative ka përfaqësuar një hap pozitiv drejt përsheptimit procedural. Ligjet mbi të drejtat e pronësisë janë konfliktuale dhe dokumentet e vërtetimit të pronësisë jo gjithmonë merren parasysh nga autoritetet edhe kur janë plotësisht të vlefshme.

- Arsimi i lartë në Shqipëri është shumë pak i lidhur me biznesin dhe produkti i tyre, burimet njerëzore, nuk janë gjithmonë në lartësitë e pozicioneve të kërkuara.

- Infrastruktura rrugore në Shqipëri, ndonëse është përmirësuar vitet e fundit, është ende me standarde të pjesshme ndërkombëtare. Një pjesë e konsiderueshme e akteve rrugore kombëtare, të cilat kanë filluar të ndërtohen prej një kohe relativisht të gjatë, janë ende të papërfunduara. Tejzgjatja e punimeve ka shkaktuar degradim të investimeve dhe kosto për ekonominë.

4.2 Fushat kryesore të reformave strukturore

4.2.1 Tregjet e produkteve dhe të kapitalit

Politikat e ndërmarra për zhvillimin e sektorit privat

Objektivi kryesor i politikës së qeverisë për zhvillimin e sektorit privat ka konsistuar në

reformimin tërësor të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e biznesit duke synuar me përparësi përmirësimin e klimës së biznesit, reduktimin e barrierave administrative, si dhe implementimin e Small Business Act, SBA. Politikat kryesore të ndërmarra për zhvillimin e sektorit privat, kanë konsistuar në sa më poshtë:

- Zbatimi i Strategjisë së Inovacionit të Biznesit dhe Teknologjisë;
- Reduktimi i kostos dhe kohës së regjistrimit të një biznesi të ri;
- Thjeshtimi i procedurave të licencimit.

Përmirësimi i skemave të financimit të biznesit

Për përmirësimin e klimës së financimit, në fushën e politikave të SME-ve janë marrë disa masa në lidhje me skemat e garantimit të kredive.

- Zbatimi i skemës së kredisë për SME-të nga programi italo-shqiptar: Që prej fillimit zyrtar të programit në janar 2009, linja e kredisë për SME-të ka qenë mjaft e suksesshme.

- Fondi Evropian për Evropën Juglindore (EFSE) është një nga kreditorët më të mëdhenj të mikrondërmarrjeve, ose ndërmarrjeve të vogla në sektorin financiar.

- Rritja e kapaciteteve të sipërmarrëse në sektorin artizanal nëpërmjet zbatimit të “Fondi i Ekonomisë Kreative (Artizanatit)”.

- Me VKM-në nr. 667, datë 28.9.2011, është miratuar krijimi i Fondit të Inovacionit, për periudhën 2011 - 2014 me një vlerë prej 40 milionë lekësh për 3 vite.

- Rritja e konkurrueshmërisë së SME-ve nëpërmjet zbatimit të programit për Fondin e Konkurrueshmërisë.

- Programi i Konkurrueshmërisë dhe Novacionit (CIP) për SME-të: Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin komunitar për konkurrueshmërinë dhe novacionet (Competitiveness and Innovation Programme-CIP), për periudhën 2007 - 2013, është miratuar me vendim të Parlamentit Europian nr. 1639/2006/EC.

- Aktivitete për projektin komunitar CIP-EIP: Shqipëria merr pjesë në programin e rrjetit të grave evropiane ambasadore dhe në programin e European Network of Mentors for Women Entrepreneurs.

Ekonomia informale

Është bërë progres në masat për reduktimin e ekonomisë informale. Tri drejtimet kryesore lidhur me luftën kundër informalitetit janë:

- rritja e inspektiveve nga Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP);
- rritja e kontrolleve nga Njësia e Zbatimi të Taks-Forcës në Drejtorinë e Hetimit Tatimor;
- rritja e përdorimit të pajisjeve fiskale.

Drejtimet kryesore për zhvillimin e sektorit privat për periudhën 2014 - 2016

- miratimi i strategjisë së biznesit dhe investimeve për periudhën 2014 - 2020;
- adaptimi i direktivës 2005/56/EC “On cross-border mergers”;
- adaptimi i direktivës 2011/7/EC “Për luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare”;
- forcimi dhe zgjerimi i rolit të gruas në sipërmarrjen private;
- mbështetja e biznesit social dhe rritja e përgjegjshmërisë sociale të korporatave;
- mbështetja për industrinë kreative;
- përmirësimi i kreditimit të SME-ve, zgjerimi i skemave të garantimit të kredive;
- implementimi i programi 3-vjeçar italian për mbështetjen e SME-ve nëpërmjet linjës së butë të kredisë dhe fondit të garantimit të kredive;

- zbatimi i programeve financiare të Fondit të Konkurrueshmërisë dhe Fondit të Garantimit të Kredive për Eksport (FK-së dhe FGKE-së);

- implementimi i fondit të novacionit dhe fondit të ekonomisë kreative;
- forcimi i dialogut me biznesin;
- mbështetja e shoqatave të biznesit dhe kompanive eksportuese që operojnë në bazë sektori dhe produkte;

- zbatimi i Strategjisë së Inovacionit dhe Teknologjisë së Biznesit dhe planit të veprimit 2011 - 2016.

Planifikimi i privatizimeve për periudhën 2014 - 2016

Privatizimi në sektorët jostrategjikë. Për vitin 2014 është planifikuar privatizimi i të gjitha aseteve dhe aksioneve shtetërore të shoqërive në sektorët jostrategjikë. Vlera e përgjithshme e këtyre aseteve dhe aksioneve shtetërore është përlogaritur në një vlerë prej 5 milionë eurosh. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes po shqyrton të gjithë dokumentacion me qëllim përfshirjen e të gjitha ndërmarrjeve në procesin e privatizimit ose të likuidimit.

Privatizimi në sektorët strategjikë. Privatizimi i paketës së mbetur të “Albtelekom” sh.a.: Shitja e paketës së zotëruar nga shteti është planifikuar për vitin 2014. Paketa e mbetur prej 16,7683661 për qind të aksioneve, është vlerësuar me një vlerë prej 2 500 milionë lekësh ose 18 milionë eurosh.

- Privatizimi i paketës së mbetur në ARMO sh.a.: shitja e paketës shtetërore është planifikuar të realizohet gjatë vitit 2015. Në ARMO sh.a. shteti zotëron rreth 14,9 për qind të aksioneve me një vlerë të përlogaritur në rreth 22 milionë euro.

- Privatizimi i pjesës së mbetur në OSSH sh.a.: Shoqëria është privatizuar në vitin 2009. Janë shitur 76% e aksioneve dhe aktualisht shteti zotëron në këtë shoqëri 24% të aksioneve. Pjesa e mbetur e aksioneve prej 24% dhe me një vlerë të përlogaritur në rreth 32 milionë euro është planifikuar të shitet gjatë vitit 2016.

- Privatizimi i “Albpetrol” sh.a.: Gjatë periudhës 2015 - 2016 është planifikuar shitja 100 për qind e paketës shtetërore të zotëruar nga shteti. Kapitali i regjistruar i kompanisë “Albpetrol” sh.a. vlerësohet në rreth 95 milionë euro.

Ndihma shtetërore në sektorin e ndërmarrjeve

Shuma totale e ndihmave shtetërore të dhëna në Shqipëri për periudhën 2007 - 2012 është 83.523,75 milionë lekë (631 milionë €). Ndihma shtetërore për vitin 2012, duke përfshirë të gjithë sektorët, arrin në vlerën 21.480,77 milionë lekë (154,49 milionë €), që përfaqësojnë 1,6 për qind të PBB-së të Shqipërisë, krahasuar me 1.26 për qind në vitin 2011, duke shënuar një rritje me 27 për qind. Rritja e vlerës së ndihmës totale për vitin 2012, në krahasim me vitin 2011, në shumën prej 4.935,5 milionë lekësh ka ardhur për shkak të një rritje të ndjeshme të ndihmës për kërkim dhe zhvillimin dhe energji. Ndërkohë, më pak ndihmë është dhënë për shërbimet publike, transportin publik, punësimin, trajnimin dhe minierat.

Prioritet 2014 - 2016 sa i takon ndihmës shtetërore për sektorin e ndërmarrjeve do të jenë:

- zbatimi i legjislacionit të ndihmës shtetërore;
- sigurimi i pavarësisë dhe forcimi i kapacitete administrative të Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore;
- rritja e ndërgjegjësimit të dhënësve të ndihmës për procedurën e njoftimit të ndihmës shtetërore;
- sigurimi i transparencës në përdorimin e fondeve publike nëpërmjet kontrollit të skemave dhe ndihmave individuale nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore dhe të pasqyruara në raportet vjetore të ndihmave shtetërore, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
- rishikimi e legjislacionit të ndihmës shtetërore.

Reformat në sektorin e energjisë

Liberalizimi i tregut të energjisë, futja e operatorëve privatë

Gjatë vitit 2014 pritet të miratohet ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike. Me miratimin e këtij ligji hapet rruga për liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë, me synimin që brenda 1 janarit 2015 të arrihet një hapje e plotë e tregut, në përputhje me objektivat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Në përputhje me skenarin e parashikuar të miratimit të ligjit të ri të sektorit të energjisë elektrike, parashikohet edhe përgatitja e modelit të ri të tregut të energjisë elektrike, i cili do të jetë në përputhje me orientimet që do të japë ligji i ri i sektorit të energjisë elektrike.

Në kuadër të liberalizimit të tregut të prodhimit të energjisë dhe të futjes së operatorëve privatë në tregun e prodhimit, gjatë vitit 2013 janë lidhur 47 kontrata të reja për ndërtimin e 112 HEC-ve me vlerë të përgjithshme rreth 454,1 milionë euro. Deri tani janë nënshkruar 168 kontrata koncesioni për ndërtimin e 441 hidrocentraleve, me fuqi të instaluar në total prej 2,012 MW, me vlerë të përgjithshme të investimit në rreth 2.615 miliardë euro. Gjithsej janë në shfrytëzim (prodhim) 74 hidrocentrale. Gjatë vitit 2014 pritet të hyjnë në prodhim rreth 17 hidrocentrale. Me vënien në shfrytëzim të këtyre objekteve parashikohet të garantohet siguria e furnizimit me energji elektrike të tregut të brendshëm dhe një pjesë e

energjisë së prodhuar të shitet në tregun rajonal.

Në kuadër të hapjes së tregut, janë bërë investime të konsiderueshme për rritjen e kapaciteteve të rrjetave të transmetimit dhe interkonjeksionit. Gjatë vitit 2013 është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit Shqipëri - Kosovë dhe është nënshkruar marrëveshja e financimit me KfW.

Paralelisht, gjatë 2014-ës do të punohet për nënshkrimin e marrëveshjes së ndërtimit të linjës së interkonjeksionit me FYROM, dhe do të punohet për identifikimin e burimit të financimit. Paralelisht me fuqizimin e kapaciteteve të interkonjeksionit po punohet edhe për fuqizimin e sistemit kombëtar të transmetimit, nëpërmjet investimeve në fuqizimin e linjave ekzistuese dhe ndërtimin e linjave të reja, duke rritur kapacitetet transmetuese e duke rritur stabilitetin e furnizimit në vend. Këtu mund të përmendim projektin e unazës së jugut, linjën 220 kV Tirana 2 - Rrashbull dhe ajo Elbasan - Fier.

Sfidat, prioritetet 2014 - 2016

Liberalizimi i tregut të energjisë, investimet e konsiderueshme për zhvillimin e infrastrukturës së sistemeve të transmetimit dhe interkonjeksionit të energjisë elektrike, si dhe furnizimi i pandërprerë i konsumatorëve me energji elektrike, janë disa nga arritjet më kryesore për këtë sektor. Ndryshimet ligjore të bëra gjatë viteve të mëparshme kanë qenë në përputhje të plotë me rregullat e Bashkimit Evropian, duke i hapur rrugën zhvillimit të konkurrencës në tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe eliminimit të situatës monopol në këtë treg. Rezultat i drejtpërdrejtë i politikave ka qenë një furnizim i pandërprerë i konsumatorëve me energji elektrike. Gjatë viteve 2009 - 2013 të vetmet ndërprerje energjie kanë qenë ato për shkak të defekteve në rrjet, të mospagesës nga konsumatorët apo remonteve të paralajmëruara.

Sfidat kryesore për periudhën 2014 - 2016 dhe në vazhdim lidhen me përmirësimin e strukturës së furnizimit me burime primare energjetike, rritjen e kapacitetit gjenerues të vendit, zvogëlimin e humbjeve në rrjet, rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të shkëmbimit të energjisë me vendet e rajonit, lidhja e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit, liberalizimi i plotë i tregut të energjisë elektrike etj. Prioritetet për periudhën 2014 - 2016, janë pjesë e prioritetëve afatgjatë të qeverisë për zhvillimin e sektorit të energjisë, dhe lidhen me zbatimin e programeve dhe projekteve të mëposhtme.

Ndërtimi i hidrocentraleve të mëdha, të mesme dhe të vogla: investimet pritet të përmirësojnë ndjeshëm si bilancin e prodhimit dhe të shkëmbimit të energjisë, ashtu dhe të ardhurat në buxhet. Investimet kryesore lidhen me: ndërtimin e HEC-ve në lumin Devoll (280 MW), në lumin Osum (152 MW), në lumin Vjosë (350 MW), në lumin Drin/Skavicë (200 MW). Me ndërtimin e këtyre impianteve Shqipëria plotëson kërkesat e tregut të brendshëm dhe mund të kthehet në eksportues neto të energjisë. Masat e ndërmarra për implementimin me sukses të projekteve të mësipërme lidhen me krijimin e lehtësirave fiskale dhe procedurale, përfshirë skema për lehtësimin e kreditimit të HEC-ve të vogla.

Lidhja e Shqipërisë me rrjetin rajonal të gazit natyror: synohet që deri në vitin 2025 rreth 15 për qind e konsumit total të energjisë të mbulohet përmes konsumit të gazit natyror. Qeveria shqiptare po punon intensivisht për realizimin e projektit TAP dhe IAP. Konkretisht, në datën 5 prill 2013, u nënshkruan dy marrëveshjet për projektin TAP: “Marrëveshja me qeverinë e vendit pritës, midis Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, ose e quajtur ndryshe HGA, si dhe “Marrëveshja midis Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me Projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, të cilat janë ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, më 15 prill 2013 (ligji nr. 116/2013, datë 15.4.2013). Projekti TAP financohet nga disa aksionarë, të cilët që nga 30.7.2013 janë: BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (16%), Total (10%), E.ON (9%) dhe Axpo (5%)). Po kështu, Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) ka miratuar vendimin nr. 2, datë 20.12.2012 “Për përcaktimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) si çështje të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”, është miratuar edhe plani kombëtar sektorial me vendimin nr. 1, datë 4.7.2013 të KKT-së dhe vazhdon procedura për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse.

Ndërtimi i projektit pritet të fillojë në vitin 2015, me një kohëzgjatje të ndërtimit 4-5 vjet. Sipas vlerësimeve paraprake, projekti pritet të ketë një kontribut prej rreth 420 milionë eurosh në GDP për

periudhën 2015 - 2019, gjatë ndërtimit parashikohet të hapen rreth 4,200 vende pune (së bashku me efektet shtesë në ekonomi parashikohen 10-12,000 vende pune), kontributi neto në buxhetin e shtetit gjatë viteve të operimit parashikohet në rreth 40-50 milionë euro/vit. Masat e ndërmarra dhe në vijim, lidhen me ndjekjen e praktikave ligjore dhe administrative për realizimin e projektit.

Lidhur me projektin, IAP është në fazën përfundimtare kur palët (qeveria e Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë) do të shprehen për projektin e fizibilitetit. Është duke punuar për studimin e ndikimit në mjedis dhe modelin e tregut që do të ndiqet në procesin e implementimit të këtij projekti. Ky projekt do të lidhet me projektin TAP në zonën e Fierit dhe do të vazhdojë në veri në drejtim të Kroacisë.

Zhvillimi i rrjetit të brendshëm të transmetimit dhe të interkonjeksionit të energjisë elektrike. Skema e investimeve është konceptuar për të përballuar kërkesat në rritje të konsumatorëve për energji elektrike, fillimisht për të importuar dhe më pas për të eksportuar tepicën e energjisë. Përparësi për periudhën 2014 - 2016 është ndërtimi i linjës së interkonjeksionit me Kosovën, për të cilën janë siguruar burimet financiare, si dhe përfundimi i studimit të fizibilitetit dhe mobilizimi i burimeve për projektin e interkonjeksionit me FYROM. Në sistemin e transmetimit janë identifikuar rreth 20 projekte, nga të cilat shtatë projekte janë konsideruar si prioritare, dhe për të cilat po kryhen studimet e fizibilitetit dhe pritjet të fillojnë brenda periudhës së programit.

Eficienca e energjisë. Në tërësinë e masave për rritjen e sigurisë së furnizimit dhe të funksionimit të tregut, do të veçohim edhe masat për promovimin e gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (panelet diellore, impiantet e erës etj.), rritjen e eficiencës së energjisë (9% deri në vitin 2018) përmes zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, miratimit të kuadrit ligjor për eficiencën e energjisë dhe të kodit të banesave, sigurimin e instrumenteve mbështetëse financiare për eficiencën e energjisë, përfshirë axhustimin e tarifave të energjisë elektrike, duke synuar mbulimin e kostove të prodhimit dhe shërbimit, por edhe duke mbrojtur shtresat në nevojë nga efektet e rritjes së çmimeve.

Kostot përkatëse të masave të parashikuara për mbështetjen e sektorit të energjisë janë parashikuar në mënyrë të detajuar në programin buxhetor afatmesëm 2014 - 2016. Ndërkohë, projektet që zbatohen në fushën e prodhimit të energjisë, përfshirë edhe në fushën e shpërndarjes, realizohen nga sektori privat dhe praktikisht nuk paraqesin ndonjë kosto relevante për buxhetin e shtetit.

Zhvillimi i industrisë së minierave. Për periudhën 2014 – 2016, referuar indikacioneve të strategjisë për zhvillimin e minierave, si prioritet do të jetë përmirësimi i produktivitetit dhe i konkurrencës, internacionalizimi i produkteve minerare për përdorim racional të burimeve financiare; njerëzore dhe natyrore; rritja e eksporteve; rritja e shkallës së përqendrimit të subjekteve minerare që punojnë për materiale ndërtimi; rritja e gamës së mineraleve që shfrytëzohen për të siguruar të ardhura më të mëdha nga sektori mineral.

Reforma në sektorin financiar

Në veprimtarinë e sistemit financiar, rreziku i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i kreditit përfaqëson rreziqet kryesore, posaçërisht për sektorin bankar. Rënia e cilësisë së kredisë gjatë vitit 2012, u shoqërua me ngadalësim të ndjeshëm të ritmit të kredidhënies. Duke qenë se këto dy prirje përforcojnë njëra-tjetrën, Banka e Shqipërisë e ka konsideruar të rëndësishme ndërmarrjen e disa masave për të nxitur bankat drejt kreditimit dhe angazhimit në ristrukturime më të hershme të kredisë (këto masa janë në fuqi që prej muajit maj 2013). Më konkretisht, për të nxitur kredidhënien, ndryshimet rregullative parashikojnë:

a) heqjen e kërkesave për kapital për rritjen vjetore të stokut të kredisë për ekonominë, nëse ajo është midis 4%-10%;

b) rritjen e kërkesave për kapital për shtesën e investimeve të sektorit bankar me institucionet financiare jorezidente;

c) uljen e përgjithshme me 5 pikë përqindje të kërkesës rregullative për nivelin e raportit minimal të likuiditetit në total, për lekun dhe për valutën, në krahasim me nivelin ekzistues sipas profilit të rrezikut të bankave. Megjithatë, vazhdon të mbetet në fuqi një përqasje rregullative më e kujdesshme për bankat

greke.

Për të adresuar dukurinë e rritjes së kredive me probleme, ndryshimet rregullative mundësojnë:

a) ristrukturimin e kredisë që në fazën kur ajo kategorizohet si kredi e rregullt, por kur kredimarrësi nis të shfaqë problemet e para në pagesën e kredisë. Qëllimi është që, me kushtet e reja të kredisë pas ristrukturimit, të ruhet aftësia paguese e kredimarrësit dhe cilësia e kredisë. Kjo kredi do të vijojë të klasifikohet si kredi e rregullt (në dy klasat e para të kategorizimit), por do të kërkojë një normë provigjionimi më të lartë, prej 10%;

b) uljen në 6 muaj nga 9 muaj (derisa kredimarrësi të ketë paguar tri këste të kredisë) të periudhës kohore në të cilën kreditë e riskstrukturuara mund të kthehen në kredi standarde.

Ndryshimi i kërkesave për kapital lidhur me rritjen vjetore të stokut të kredisë dhe të fluksit të investimeve të sektorit bankar me subjektet jorezidente, janë me natyrë kundërciklike, të përkohshme dhe do të shtrijnë efektin e tyre për periudhën 2013 - 2014. Nëse Banka e Shqipërisë nuk vendos ndryshe me një vendim të posaçëm, këto ndryshime do të shfuqizohen me përfundimin e periudhës së sipërpërmendur, dhe bankat duhet të sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullativ ekzistues deri në qershor 2015. Ky mekanizëm vlerësohet i rëndësishëm për të ruajtur te bankat kërkesën për një kreditim të kujdesshëm dhe veprimtari të mirëkapitalizuar.

Rritja e stokut të kredive me probleme ka nxjerrë nevojën për një proces të fshirjes së kredive të humbura. Megjithatë, ky proces, si dhe volumi i kredive të humbura, të fshira nga bilancet e bankave kanë qenë modeste për shkak të përcaktimit të paqartë të borxhit të keq nga ana e legjislacionit tatimor në fuqi, nuk parashikonte zbritjen nga shpenzimet për qëllime fiskale për këto shuma. Banka e Shqipërisë, ka propozuar disa ndryshime në aktet nënligjore, për një përkufizim më të saktë të borxhit të keq, propozim, i cili pas negociatave është marrë në konsideratë nga ministri i Financave dhe ndryshimi është reflektuar më 24 maj 2013.

Më tej, në bashkëpunim me Bankën Botërore, me anë të projektit FinSAC (Financial Sector Adjustment Credit) janë bërë përpjekje për vendosjen e një kuadri të zgjidhjes së kredive me probleme.

Banka e Shqipërisë ka vazhduar të konsolidojë punën për rishikimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës në përputhje me standardet e Komitetit të Bazelit, me synim përafrimin e mëtejshëm të tij me Acquis Communautaire. Gjatë periudhës raportuese, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi rregulloret e mëposhtme:

- Rregullorja “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”;
- Rregullorja “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”;
- Rregullorja “Mbi instrumentet e pagesave elektronike”.

Rishikimi tërësor i tri rregulloreve të sipërpërmendura është bërë kryesisht në funksion të kërkesave për institucionet e parasë elektronike, aktivitetit të parasë elektronike, në përputhje me direktivën e BE-së 2009/110/EC “Mbi sipërmarrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të institucioneve të parasë elektronike” dhe direktivave të amenduara 2005/60/EC, 2006/48/EC dhe direktivës së shfuqizuar 2000/46/EC.

- Udhëzimi “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”, përafron pjesërisht direktivën evropiane 2006/48/EC mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe direktivën 2006/49/EC mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërive të investimit dhe institucioneve të kreditit.

- Rregullorja “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”, përafron më tej kuadrin rregullativ me direktivën evropiane 2006/48/EC mbi veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe direktivën 2006/49/EC mbi mjaftueshmërinë e kapitalit të shoqërive të investimit dhe institucioneve të kreditit dhe akordin e kapitalit Basel II.

Detaje të projektit të zbatimit të Basel II

Lidhur me shtyllën 1, kërkesat e reja për kapital dhe tabelat e raportimit COREP, aktualisht janë hartuar dhe janë gati për diskutim dhe përdorim nga bankat. Versioni i fundit i COREP-it i është paraqitur industrisë bankare gjatë muajit shtator 2013 dhe po diskutohet gjatë këtij tremujori me grupin *ad-hoc* të Shoqatës Shqiptare të Bankave (SHSHB). Duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2014 dhe deri në fundvit, bankat do të raportojnë paralelisht me kërkesat aktuale edhe kërkesat e rregullores së re. Kjo

periudhë do të shërbejë për t'i dhënë kohë bankave për sqarime dhe zgjidhje të çdo problemi të mundshëm apo shqetësimi që mund të evidentohet gjatë periudhës së raportimit paralel.

Ndërkohë, ka filluar puna për zbatimin e shtyllës 2 dhe procesi pritët të përfundojë gjatë vitit 2014 dhe 2015.

Në lidhje me kërkesat e shtyllës 3 - disiplina e tregut, Banka e Shqipërisë ka parashikuar rishikimin dhe përditësimin e rregullores aktuale nr. 60, datë 29.8.2008 “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, duke filluar në tremujorin e dytë të 2014-ës. Këto ndryshime do të ndiqen nga një periudhë testimi raportuese nga ana e bankave për dy tremujorët e fundit të vitit 2014 (ndryshimet janë parashikuar të hyjnë në fuqi në vitin 2015).

Rregulloret në proces:

- Rregullorja nr. 31, datë 30.4.2008 “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave” është duke u rishikuar dhe do të zëvendësohet me një rregullore të re - draftprojekti ka përfunduar dhe është dërguar për konsultim me industrinë bankare dhe pritët të miratohet, nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, në fillim të vitit 2014. Rregulloret e reja të propozuara synojnë përafrimin me rregullat dhe konceptet e rregullores së re të Bankës së Shqipërisë mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe regjimit e ri të BE-së për ekspozimet e mëdha (rregullorja “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit” - pjesa III/ekspozimet e mëdha).

- Udhëzimi nr. 57, datë 1999/5/5 “Për kapitalin rregullator”, do të rishikohet dhe do të përditësohet në përputhje me Basel II dhe rregullat e Basel III për kapitalin rregullator. Projekti i ri pritët të përfundojë dhe të miratohet në qershor 2014.

- Sipas rekomandimeve të FSAP-it, Banka e Shqipërisë, është duke planifikuar gjatë vitit 2014, rishikimin dhe përditësimin e këtyre rregulloreve ekzistuese:

- Rregullorja nr. 1, datë 17.1.2013 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” në kuadër të lehtësimit të kriterëve të licencimit për shoqëritë e administrimit të aseteve (shitblerja e kredive), e cila parashikohet të përfundojë brenda muajit mars 2014.

- Rregullorja nr. 14, datë 11.3.2009 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë” (kriteret për pjesëmarrjen influencuese mbi 33% dhe 50%), e cila parashikohet të përfundojë në dhjetor 2014.

Përmirësim i bashkëpunimit për stabilitetin financiar

Përveç përmirësimeve në strukturën rregullatore të tregut financiar, organizimi i kuadrit të stabilitetit financiar është zhvilluar më tej. Ruajtja e stabilitetit financiar është një përgjegjësi e përbashkët në mes të Bankës së Shqipërisë (BSH), Ministrisë së Financave (MF), Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD). Për të forcuar koordinimin e çështjeve që ndërlidhen me stabilitetin financiar, institucionet e përmendura më sipër kanë nënshkruar një marrëveshje për të koordinuar veprimet e tyre nën një komitet të veçantë në stabilitetin financiar - Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar (janar 2012). Të gjitha këto autoritete kanë role të ndryshme në punën me stabilitetin financiar.

Komiteti mbledhet të paktën katër herë në vit për konsultimin dhe shkëmbimin e informacionit mbi vlerësimet e rreziqeve që mund të kërcënojnë sistemin financiar në tërësi, dhe për të diskutuar masat e duhura parandaluese. Një deklaratë për shtyp botohet më pas në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë.

4.2.2 Tregu i punës

Politikat shtetërore të punësimit, do të vazhdojnë të përfshijnë, si masa për nxitjen e punësimit (politikat aktive), ashtu dhe sigurimin e mbështetjes me të ardhura (politikat pasive). Politikat aktive të tregut të punës përfshijnë shërbimet e punësimit, programet e krijimit të vendeve të reja të punës dhe programet e formimit profesional.

Programet e nxitjes së punësimit janë zbatuar edhe në vitin 2013 dhe do të jenë të pranishme në Shqipëri në vitet në vazhdim. Për vitin 2013 fondi për programet e nxitjes së punësimit ka qenë 90 milionë lekë dhe janë zbatuar programet ekzistuese gjithsej 6 programe me 72 projekte dhe 844 punëkërkues të papunë të përfshirë.

Formimi profesional. Objektivi vjetor për vitin 2013, në lidhje me numrin e të trajnuarve në

drejtoritë rajonale të formimit profesional publik ishte 8500 persona. Për periudhën janar – nëntor 2013 janë regjistruar gjithsej 8255 persona dhe janë certifikuar 7935 persona, nga të cilët 3343 janë femra. Nga totali i të certifikuarve janë punësuar mbas mbarimit të një kursi 380 persona. Gjithashtu, është realizuar gjatë kësaj periudhe trajnimi i 1561 të burgosurve.

Programi i pagesës së papunësisë përbën një ndër programet e para të aplikuara në zyrat e punësimit. Ky program është pjesë e politikave të tregut të punës, i cili siguron mbështetjen me të ardhura të të papunëve në kohën e daljes së tyre si të tillë. Objektivat e tij kryesore janë:

- të kompensojë të ardhurat për të papunët;
- t'u japë mbështetje aktive përfituesve të pagesës së papunësisë, në mënyrë që të rikthehen në punë.

Inspektorati i Punës. Gjatë vitit 2013, ka filluar puna për kompletimin e kuadrit ligjor të sigurisë dhe shëndetit, si në kuadër të implementimit të ligjit 10238 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe konkretisht neni 42, pika 3, ku çdo institucion përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, do të nxjerrë rregulloret përkatëse, sipas fushës së veprimtarisë, të miratuara me vendime të Këshillit të Ministrave, ashtu dhe në kuadër të implementimit të ligjit “Për disa ndryshime në Kodin e Punës”. Paketa do të përfundojë në vitin 2014.

Plani për periudhën 2014 – 2016, tregu i punës

Me kontributin dhe asistencën e projektit IPA 2010 “Zhvillimi i burimeve njerëzore”, është duke u punuar për hartimin e strategjive në fushat e punësimit dhe të trajnimit. Konkretisht janë hartuar dy drafte, për strategjinë ndërsektoriale të punësimit dhe për strategjinë e arsimit dhe të formimit profesional dhe të nxënies gjatë gjithë jetës.

Në këtë kuadër, po me kontributin e projektit të mësipërm po punohet tashmë për hartimin e një dokumenti të përbashkët strategjik për punësimin dhe arsimin e formimit profesional. Në këtë strategji do të përcaktohen masa konkrete për drejtimin e zhvillimit të sistemit të arsimit, formimit profesional dhe punësimit. Gjithashtu, në strategji do të parashikohen masa konkrete për përfshirjen e grupeve në nevojë sidomos për t’iu përgjigjur nivelit të ulët të punësimit të grave, nëpërmjet formimit profesional, programeve të nxitjes së punësimit, papunësisë së lartë të të rinjve. Strategjia parashikohet të përfundojë në mars 2014.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2014 - 2020 është e mbështetur në qëllimin gjithëpërfshirës të Strategjisë Evropiane 2020, për një punësim në rritje të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës dhe i bazuar në: “Mundësi më të mëdha dhe punë më të mirë për të gjitha gratë dhe burrat”. Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë do të jetë nxitja e punësimit cilësor dhe mundësi për arsim dhe formim profesional për gratë dhe burrat shqiptarë. Kjo do të arrihet nëpërmjet politikave aktive koherente dhe të bashkërenduara që në të njëjtën kohë i adresohen kërkesës dhe ofertës për punësim dhe boshllëkut të përfshirjes sociale. Strategjia e punësimit dhe aftësive 2014 - 2020 do të fokusohet në katër prioritetet strategjike, si më poshtë:

- futjen e njerëzve në punë përmes masave përkatëse punësimi;
- ofrim cilësor të arsimit dhe formimit profesional për të rinjtë dhe të rriturit. Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- nxitjes e përfshirjes së njerëzve të pafavorizuar. Kjo do të arrihet nëpërmjet:
- forcimit të administrimit të tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.

Po me mbështetjen e projektit IPA 2010 është duke u zhvilluar modeli pilot i zyrës së punësimit Tiranë me modelin e ri të shërbimeve të punësimit. Kjo bëhet për të rritur eficiencën e shërbimeve të punësimit në tregun e punës.

Fondet për programet e nxitjes së punësimit janë trefishuar për vitin 2014. Në këtë kuadër po rishikohet baza ligjore e këtyre programeve për t’i bërë ato sa më eficiente dhe transparente. Gjithashtu, do të hartohen dhe programe të reja të lidhura këto me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, çirakërinë etj.

Në kuadër të përgatitjeve për Fondin Social Evropian kanë filluar konsultimet për hartimin e fondit kombëtar të punësimit dhe për këtë është ngritur një grup pune nga ekspertë të MMSR-së dhe MAS-së me mbështetjen e projektit IPA 2010.

Sigurimet shoqërore

Skema e sigurimeve shoqërore po ballafaqohet me disa probleme, si:

- komprimimi i pensioneve, duke bërë që pensionet mesatare të jenë shumë afër pensioneve minimale;
- norma e zëvendësimit e lartë për pensionet minimale dhe shumë e ulët për pensionet mesatare dhe maksimale;
- niveli i lartë i subvencionimit nga buxheti i shtetit për mbështetjen e skemës së fermerëve;
- në përgjithësi masa e ulët e pensioneve dhe rritje në vazhdimësi të transfertave buxhetore për të përballuar shpenzimet në rritje të skemës së pensioneve.

Qeveria parashikon të fillojë përgatitjen për reformën në pensione, me qëllim përmirësimin e aftësisë vetëfinancuese të skemës dhe zhvillimin e incentivave për pjesëmarrje më të gjerë të kontribuesve në skemë.

Pas një analize të gjatë të problemeve të sistemit të pensioneve në bashkëpunim me aktorët politikë, Bankën Botërore, FMN-në dhe grupet e interesit, po punohet që në muajt në vazhdim të draftohet projektforma. Reformimi i sistemit të pensioneve vjen si një domosdoshmëri e zhvillimeve të ardhshme social-ekonomike dhe e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Objektivat kryesorë financiarë janë:

- forcimi i qëndrueshmërisë së skemës së sigurimeve shoqërore;
- përmirësimin thelbësor të administrimit të sistemit të përfitimeve;
- rritjen e cilësisë së administrimit të fondeve;
- administrimin e pagesave;
- evidentimin dhe marrjen e masave për minimizimin e risqeve dhe forcimin e kontrollit të përdorimit të fondeve.

Parashikohet që gjatë vitit 2014 do të organizohet puna në grupe teknike dhe pjesëmarrja e të gjitha grupeve të interesit për përgatitjen e strategjisë afatgjatë të pensioneve, si dhe përgatitjen e akteve ligjore të nevojshme.

Ndërkohë është parashikuar që pensionet të rriten vetëm në nivelin e inflacionit, ndërsa parametrat e sistemit të përmirësohen me objektivin për një lidhje më të mirë të masës së kontributit me përfitimin, përmirësimin e koeficientit të varësisë dhe atë të zëvendësimit, si dhe përmirësimin e gjendjes financiare të skemës.

4.2.3. Reforma administrative

Reforma funksionale-strukture

Gjatë vitit 2013 reforma funksionale-strukture, ka pasur si synime kryesore:

- Përshtatjen e strukturave dhe të organikave të institucioneve të administratës publike, me misionin, funksionet, kompetencat dhe aktivitetet që ato duhet të kryejnë;

- Fillimin e punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të analizës funksionale të institucioneve të administratës shtetërore.

Në këndvështrim të sa më sipër, gjatë vitit 2013 janë kryer aktivitetet si vijon:

- Me qëllimin e realizimit edhe të një prej objektivave kryesorë të qeverisë së re, atë të qeverisjes eficiente dhe transparente, menjëherë me ardhjen në detyrë, qeveria filloi punën për hartimin dhe miratimin e strukturave të 16 ministrive.

Puna u fokusua në:

- analizën e funksioneve të çdo ministrie të mëparshme;
- eliminimin e hallkave të tepërta në menaxhim;
- forcimin e fushave prioritare.

Përveç sa më sipër, me ndërtimin e strukturave të ministrive të reja u prezantuan edhe disa risi për të siguruar një qeveri të qëndrueshme dhe me mundësi përparimtare, e konkretisht:

- u forcua dimensionin i integritetit evropian dhe kapacitetet e çdo ministrie në këtë drejtim dhe mbi

të gjitha, u forcua Ministria e Integritetit, përmes një rritjeje me 20% të personelit;

- planifikimi strategjik/menaxhimi u përcaktua si një funksion kryesor në çdo ministri duke përfshirë qasjen e financimit me rezultate;

- u krijua një rrjet për luftën kundër korrupsionit, duke përcaktuar nga një koordinator për antikorruptionin në nivel zëvendësministri në çdo ministri, rrjet i cili drejtohet nga Koordinatori Kombëtar Antikorruption, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore;

- u përshtat koncepti i “njësisë së jetësimit të prioritetëve” nga Britania e Madhe, duke krijuar një rrjet të njësisë së jetësimit të prioritetëve, me qëllim orientimin e punës të menaxhimit të performancës dhe rezultatet. “Njësia e jetësimit të prioritetëve” e krijuar në çdo ministri udhëhiqet nga një zëvendësministër. Të gjithë nëpunësit e këtyre njësive do të mbështeten dhe trajnohen nga njësia e jetësimit të prioritetëve në Kryeministri;

- u krijua një rrjet “Chief Information Officer” me qëllim hartimin e planeve strategjike në drejtim të teknologjisë, i cili udhëhiqet nga Koordinatori Kombëtar, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Si rezultat:

- mbas miratimit të strukturave të 16 ministrive të linjës, u reduktua numri i përgjithshëm i punonjësve me 15%;

- shkurtime më të mëdha u bënë në ministrinë më të mëdha të mëparshme me një përqindje mesatare rreth 30% (Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes);

- u rrit, nëpërmjet rialokimit, numri i punonjësve të dedikuar për fushat prioritare me rreth 14% (si rezultat i krijimit të ministrive të reja apo i rritjes së numrit të punonjësve të Ministrisë së Integritetit Evropian);

- në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Gjatë muajve tetor - nëntor u miratuan vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e fushave të veprimtarisë shtetërore nën përgjegjësinë e çdo ministrie linje dhe ministrave të shtetit.

Në vijim, në kuadër të reformës strukturore shtetërore dhe me qëllim frytshmërinë, uljen e kostove të shërbimit, rritjen e besimit të publikut dhe qëndrueshmërinë e institucioneve publike, me urdhrin nr. 167, datë 8.10.2013 të Kryeministrit është ngritur “Komiteti Ndërminstros për Reformën Strukturore të Shtetit”, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij ministrat e shtetit dhe zëvendësministrat që mbulojnë fushat përkatëse.

Ky komitetet është përgjegjës për:

- rishqyrtimin/vlerësimin e strukturës aktuale institucionale dhe administrative, nga një pikëpamje kushtetuese, ligjore dhe faktike;

- pranimin dhe vlerësimin e sugjerimeve dhe ideve nga subjekte të lidhura ose të interesuara për reformën;

- identifikimin e nevojave dhe propozimin e amendamenteve të përshtatshme reformuese;

- përgatitjen e raporteve rekomanduese për Këshillin e Ministrave mbi iniciativat e ndërruara.

Deri tani Komiteti ka përgatitur një material mbi parimet që duhen ndjekur dhe standardet e nevojshme për krijimin e strukturave të varësisë, si më poshtë:

- eliminimin e mbivendosjeve ndërmjet institucioneve të varësisë, aty ku është e mundur;

- qartësimin e varësisë së institucionit nga Ministria, aty ku është e mundur;

- marrjen në konsideratë të strukturës gjeografike të secilit institucion të varësisë (kombëtar ose rajonal);

- propozimin e përmirësimeve mbi efektshmërinë dhe eliminimin e menaxhimit dhe/ose shërbimeve mbështetëse të panevojshme;

- forcimin e prioritetëve të institucioneve të varësisë;

- implementimin e disa risive në secilin institucion të varësisë (p.sh. funksionimin e planifikimit strategjik, marrjen e një këshilltari për teknologjinë);

- propozimin e institucioneve të reja në përputhje me prioritetet e vendosura;
- garantimin e përmbushjes së qëllimeve të çdo institucioni të varësisë (disa mund të shkrihen/mbyllen-ndryshime ligjore mund të nevojiten për të bërë të mundur këto ndryshime).

Për të vënë në jetë rekomandimet e Komitetit Ndërmintor për Reformën Strukturore të Shtetit, si dhe për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 90/2012, gjatë vitit 2014, do të vijohet me hartimin e legjislacionit përkatës në këtë drejtim.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, 2014 - 2020

Duke filluar nga muaji tetor i vitit 2012 deri në maj të vitit 2013, u hartua dhe konsultua drafti i parë i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike, 2014 - 2020, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet (konsultime me: grupin këshillimor, përfaqësues të ministrave të linjës dhe institucioneve të pavarura, me qëllimin diskutimin dhe dhënien e kontributeve të tyre në këtë dokument).

Objektivat afatgjatë të draftit si më sipër synojnë: i) forcimin e kapaciteteve të administratës publike për të zhvilluar politika efektive dhe koherente për të realizuar qëllimet publike; ii) sisteme më efektive të menaxhimit; iii) struktura organizative të përmirësuar, të orientuara ndaj një kulture shërbimi; dhe iv) përdorimin transparent dhe plotësisht të përgjegjshëm të burimeve.

Objektivat afatmesëm të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2014 - 2020 përfshijnë:

- zbatimin e një sistemi menaxhimi eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore për administratën publike, si dhe monitorimin e këtij sistemi menaxhimi;
- përmirësimin e performancës dhe zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike, përfshirë nxitjen e programeve të të mësuarit të vazhdueshëm dhe ofrimin e trajnimeve afatshkurtra dhe atyre afatgjata;
- përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen publikut, nëpërmjet fuqizimit të strukturave ekzistuese dhe ngritjes së strukturave të reja;
- rritjen e përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë, nëpërmjet delegimit të vendimmarrjes sa më pranë pozicionit të ngarkuar për ushtrimin e funksionit;
- marrjen e vendimeve të mirinformuara për politikat e burimeve njerëzore dhe pagat në administratën publike, nëpërmjet përdorimit të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ).

Operacionalizimi konkret i Strategjisë do të kryhet nëpërmjet një qasjeje me faza. Dy plane të veçanta të veprimit do të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme:

- Plan i Veprimit 2014 - 2016 (objektivat afatmesëm) do të përqendrohet në: i) zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil; ii) reformën strukturore institucionale; iii) përfundimin e databazës së burimeve njerëzore, si dhe; iv) përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të shërbimit civil me standardet evropiane.

- Plan i Veprimit 2017-2020 (objektivat afatgjatë) do të përgatitet në gjysmën e dytë të vitit 2016. Avancimi i procesit të zhvillimit të vendit drejt integritetit evropian kërkon standarde gjithnjë e më të larta të administratës publike për të plotësuar kriteret e hapësirës administrative evropiane dhe për të zbatuar legjislacionin evropian. Ky plan veprimi do të bazohet në një vlerësim të zbatimit të objektivave të periudhës së mëparshme dhe rivlerësim të prioritetëve dhe do të përfshijë aktivitete të reja në fushat kryesore të reformës administrative, përfshirë përmirësime në fushat ku progresi nuk ka qenë i mjaftueshëm.

Reforma në shërbimin civil

Reforma në menaxhimin e burimeve njerëzore, me synimin e krijimit të një administrate profesionale, të mbështetur në merita, të depolitizuar dhe të aftë të përballojë sfidat, mbetet një ndër prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare.

Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim ishte miratimi i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i cili mbështetet në disa shtylla të rëndësishme:

Krijon Trupën e Drejtuesve të Lartë të Shërbimit Civil. Në këtë rast, kjo trupë do të ketë një

regjim juridik të posaçëm punësimi dhe instrumentet përkatëse të menaxhimit.

Rekrutimi në grup. Kandidatët për pozicionet e “nivelit hyrës” në shërbimin civil do të zgjidhen nëpërmjet një konkursi kombëtar vjetor, me synim krijimin e një apo më shumë grupeve me kandidatë, të cilët plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe të posaçme, për t’u emëruar në pozicione me kërkesa dhe përgjegjësi të ngjashme, ose të krahasueshme në një ministri apo institucionet e tjera.

Zhvillimi i karrierës dhe ngritja në detyrë. Mekanizmat e zhvillimit të karrierës janë lëvizja paralele (brenda së njëjtës kategori) dhe ngritja në detyrë (në një kategori më të lartë). Lëvizja paralele do të kryhet nëpërmjet një procedure me konkurrim të brendshëm të bazuar në pozicionin (konkurrim për një pozicion të caktuar) me qëllim përzgjedhjen e kandidatit më të mirë të mundshëm brenda shërbimit civil. Ngritja në detyrë do të bazohet në një konkurrim të hapur, të organizuar për një ose disa pozicione të caktuara dhe ky konkurrim do të mbështetet në një sistem preferencial bonusi për nëpunësit civilë ekzistues.

Lëvizshmëria. Ligji parashikon rotacionin dhe transferimin si instrumente të lëvizshmërisë dhe pasurimit të karrierës.

Duke qenë se ky ligj është konceptuar si një ligj i përgjithshëm, që përcakton parimet dhe vendos standardet e përgjithshme të menaxhimit, si dhe përgjegjësitë përkatëse, që ai të jetë i zbatueshëm, duhet të shoqërohet me aktet nënligjore të parashikuara për t’u miratuar.

Duke e konsideruar zbatimin e ligjit të ri të nëpunësit civil si një ndër prioritetet e saj, nga qeveria janë ndërmarrë hapat e nevojshëm për të hartuar të gjitha aktet nënligjore. Në këtë mënyrë, ligji i ri i shërbimit civil do të fillojë të zbatohet, në respektim të parimeve dhe standardeve të miratuara në të.

Në këtë proces, qeveria shqiptare (ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Departamenti i Administratës Publike) po mbështeten; mbështetja do të vijojë edhe gjatë vitit të ardhshëm nga SIGMA (institucioni, i cili në mënyrë të vazhdueshme ka asistuar qeverinë shqiptare në fushën e reformave në administratën publike).

Aktualisht, janë hartuar dhe janë në fazën e konsultimit, të gjitha (10 gjithsej) aktet nënligjore në zbatim të ligjit të ri për nëpunësin civil.

Më tej, gjatë muajit janar 2014, këto akte do të dërgohen për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, e më pas, puna do të vijojë me trajnimin e të gjithë nëpunësve të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatim e këtij legjislacioni, si dhe me zbatimin e tij.

4.2.4. Reforma në fusha të tjera

Reformat në sektorin e turizmit, zhvillimin e territorit dhe strehimin social

Rishikimi i legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit

Rishikimi i legjislacionit të planifikimit qëndron në bazë të programit të qeverisë për zhvillimin urban, rural dhe rajonal. Nevoja për rishikim të këtij legjislacioni lidhet edhe me faktin se legjislacioni i planifikimit, i miratuar në vitin 2009 dhe që ka hyrë në fuqi në vitin 2011, ka pësuar një sërë ndryshimesh, shpeshherë drastike, të cilat kanë dëmtuar strukturën, konsistencën dhe konceptet parimore të tij.

Për të korrigjuar këto probleme të ligjit dhe të akteve nënligjore, do të ndërmerret një proces i hapur dhe transparent, ku palët/grupet e interesit do të diskutojnë për problemet dhe vështirësitë që hasin me zbatimin e legjislacionit të planifikimit dhe do të propozojnë përmirësime të tij. Kjo mendohet të kryhet gjatë vitit 2014.

Reforma institucionale dhe ligjore në fushën e turizmit

Me synim sigurimin e instrumenteve të duhura që orientojnë turizmin shqiptar drejt zhvillimit të qëndrueshëm, konkurrues, krijimin e një hapësire të rregulluar ligjore, si dhe praninë e investitorëve potencialë, është i domosdoshëm edhe rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e turizmit. Zhvillimi kaotik i industrisë së turizmit, shpesh me rregulla të mangëta dhe pa institucione kontrolli, ka krijuar problematika që i shtohen papjekurisë dhe fazës fillestare të zhvillimit të kësaj industrie.

Me ndryshimet ligjore do t’i jepet zgjidhje:

- kategorizimit të aktorëve të tregut turistik për tërësinë e produkteve;
- klasifikimit të strukturave akomoduese dhe shërbimit sipas standardeve ndërkombëtare, sistemit të inspektimit dhe kontrollit administrativ;

- ngritjes së sistemit të mbledhjes dhe të vlerësimit të të dhënave statistikore;
- eliminimit të barrierave të biznesit dhe nxitjes së investimeve;
- përcaktimit dhe zhvillimit ligjor të zonave me përparësi turizmin; si dhe
- do të mbështetet ligjërisht bashkëpunimi i sektorëve publikë e privatë.

Kjo mendohet të kryhet gjatë vitit 2014.

Ristrukturimi i programit të kreditimit të lehtësuar

Reforma në sektorin e strehimit social do të përfshijë edhe ristrukturimin e programit të kreditimit të lehtësuar. Në këtë program synohet të ndërpritet komponenti që mbështet funksionarët politikë dhe të ushtrohet kontroll mbi mënyrën e përfitimit; të zgjerohet partneriteti duke përfshirë ndërtuesit, me qëllim uljen e kostove; mbështetjen e familjeve dhe të individëve që blejnë banesë për herë të parë. Kjo mendohet të kryhet gjatë vitit 2014.

Reforma në shërbimet shëndetësore

Aktualisht, financimet e shërbimeve shëndetësore janë të fragmentuara nga disa burime. Kjo problematikë në financimin e shërbimeve shëndetësore, ka bërë që financimi të mos jetë i lidhur me aktivitetet e kryera nga shërbimet shëndetësore dhe performancën e tyre, veçanërisht kjo e theksuar për shërbimet spitalore. Problemi i financimit të fragmentuar është një nga problemet që ka sjellë për pasojë mungesën e theksuar të barnave dhe të materialeve mjekësore në spitale.

Transformimi i sistemit aktual do të bëhet gradualisht, duke kaluar nga sistemi aktual miks kontributiv në taksimin e përgjithshëm, të cilin e aplikojnë shumë vende të zhvilluara në Evropë, e më gjerë. Rritja e qëndrueshme e të ardhurave të buxhetit do të sjellë dhe më shumë financime për shërbimet shëndetësore.

Ligji i ri parashikon një fuqizim të rolit të Fondit. Parimi kryesor mbi të cilin është ndërtuar skema e sigurimeve shëndetësore është parimi i solidaritetit. Skema synon në mbulimin e popullsisë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor të financuara nga sektori publik dhe privat.

Reformat në fushën e rimbursimit të barnave:

- Për vitin 2014 do të hiqet TVSH-ja për barnat në masën 10%, me një efekt prej 1 milion lekësh. Kjo do të sjellë si pasojë uljen me 10% të çmimit të barnave në vend dhe domosdoshmërisht uljen me 10% të çmimit të barnave në listën e rimbursimit;

- Barnat e listës do të përzgjidhen sipas disa prioritetëve;

- Negociata me kompanitë për çmimet;

- Rritja e barnave xhenerike në listën e barnave të rimbursueshme, si në shërbimin parësor, ashtu edhe atë spitalor.

Reforma në fushën e drejtësisë

Përmirësimi i veprimtarisë së A M Falimentit, përmes ndryshimit të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentin”, ndryshimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 197, datë 13.4.2007 “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorëve të falimentit, përfundimit të draftakteve nënligjore, trajnimit paraprak dhe organizimit të provimit, mbi procedurat e licencimit të 10 administratorëve”.

Reforma në fushën e bujqësisë

Shqipëria vazhdon të mbështesë ristrukturimin e bujqësisë nëpërmjet përmirësimit të ambientit të biznesit, zhvillimit të infrastrukturës dhe mbështetjes me investime. Në vitin 2013, qeveria e Shqipërisë akordoi 7.6 milionë euro për mbështetjen me investime për bujqësinë nëpërmjet skemave kombëtare.

Mbështetja nga qeveria në mënyrë të qëndrueshme e këtij sektori ka pasur një impakt pozitiv në rritjen e konkurrueshmërisë së aktiviteteve bujqësore. Rritja në sektorin e bujqësisë ka ardhur kryesisht nëpërmjet rritjes së produktivitetit.